

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

PROGRAMI I STUDIMIT:



**MSC NË DREJTËSI NË PROFILET:
E DREJTË PENALE
E DREJTË NDËRKOMBËTARE**

KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR



**KOLEGJI
UNIVERSITAR
BEDËR**




RAPORT I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM PERIODIK
Për programin e studimit Master i shkencave në Drejtësi në profilet:
E Drejtë penale; E Drejtë ndërkombëtare
Kolegji Universitar Bedër

JANAR 2019

Tiranë, Shqipëri

HYRJE	4
RRETH PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM DHE PROGRAMIT TË STUDIMIT	5
➤ RRETH PROGRAMIT MASTER I SHKENCAVE NË DREJTËSI NË PROFILIN: A. E DREJTË PENALE.....	6
➤ RRETH PROGRAMIT MASTER I SHKENCAVE NË DREJTËSI NË PROFILIN: B. E DREJTË NDËRKOMBËTARE	8
RRETH PROCESIT TË AKREDITIMIT	10
GRUPI I VLERESIMIT TE BRENDSHEM (GVB)	10
ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË	12
PROGRAMI I STUDIMEVE, ADMINISTRIMI NË SHËRBIM TË MISIONIT TË NJËSISË	13
1- MISIONI DHE OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT	13
2- STRUKTURA AKADEMIKE E FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE DHE DEPARTAMENTIT TË DREJTËSISË	18
3- PERSONELI AKADEMIK DHE MBËSHETËS PËR PROGRAMIN E STUDIMIT MSC NË DREJTËSI NË PROFILET: A. E DREJTË PENALE; B. E DREJTË NDËRKOMBËTARE	34
PROCEDURA E APLIKIMIT DHE E MARRJES NË PUNË TË STAFIT AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË.....	35
4- INFRASTRUKTURA NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT, LOGJISTIKA DHE SHËRBIME TË TJERA NDAJ KOMUNITETIT	49
5- FINANCIMI DHE MENAXHIMI I BURIMEVE FINANCIARE	54
6- SISTEMI I BRENDSHËM I SIGURIMIT TË CILËSISË	58
POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE	66
7- PROGRAMI I STUDIMIT, ORGANIZIMI I TIJ	66
8- MËSIMDHËNIA	91
9- STUDENTËT.....	94
POLITIKA E KËRKIMIT SHKENCOR	105
10- KËRKIMI SHKENCOR.....	105
A. PUBLIKIMET E STAFIT PËR VITET 2013-2018	108
B. KONFERENCAT KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE, PJESMARRJA NË KOMPETICIONE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE, BROWNBAG SEMINARS IN LAW, DEBATET STUDENTORE SI DHE AKTIVITETE SOCIALE PËR VITET 2013-2018	115
11- BASHKËPUNIMI KOMBËTAR, NDËRKOMBËTAR DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	141
ANALIZA SWOT	147
I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË.....	147
II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVB SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, ËEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).....	147



LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat	25
Tabela 2: Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) të Departamenteve	26
Tabela 3: Komiteti Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit	32
Tabela 4: Cilësia e personelit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për programin e studimit	36
Tabela 5: Të dhënat e personelit akademik për programin e studimit sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre.....	39
Tabela 6: Të dhëna sipas moshës i stafit PAE dhe PA.....	40
Tabela 7: Të dhëna sipas moshës i personelit PAK.....	41
Tabela 8: Mjediset e fakulteteve dhe IAL	50
Tabela 9: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 6 vitet e fundit	54
Tabela 10: Të dhëna për anëtarët e NJBSC.....	59
Tabela 11: Plani mësimor për programin “Master i shkencave” në Drejtësi, profili: <i>E Drejtë Penale</i>	68
Tabela 12: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F) “Master i shkencave” në Drejtësi, profili: <i>E Drejtë Penale</i>	70
Tabela 13: Plani mësimor për programin “Master i shkencave” në Drejtësi, profili: <i>E Drejtë Ndërkombëtare</i>	71
Tabela 14: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F) për programin “Master i shkencave” në Drejtësi, profili: <i>E Drejtë Ndërkombëtare</i>	73
Tabela 15: Ndryshimet në planin mësimor për programin programin “Master i shkencave” në Drejtësi, profili: <i>E Drejtë Ndërkombëtare</i> dhe <i>E Drejtë Penale</i>	74
Tabela 16: Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës.....	75
Tabela 17: Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies.....	92
Tabela 18: Format e kontrollit të njohurive.....	92
Tabela 19: Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.	93
Tabela 20: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve.....	97
Tabela 21: Të dhëna për punësimin e studentëve.....	99
Tabela 22: Të dhëna për kërkimin shkencor	108
Tabela 23: Publikimet e Stafit Akademik 2013 – Dhjetor 2018	108
Tabela 24: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar.....	141
Tabela 25: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese.....	142



RAPORT I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM PERIODIK

Për programin e studimit “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. e Drejtë penale; b. e Drejtë ndërkombëtare

HYRJE

Kolegji Universitar “Bedër” (KUB) u çel me kërkesë të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë (KMSH) dhe vendimin nr.286, datë 6.4.2011 të Këshillit të Ministrave, me anë të të cilit u miratua dhënia e licencës për ushtrimin e aktivitetit si institucion i arsimit të lartë.¹ KUB është një institucion në fushën e arsimit të lartë, i cili funksionon si organizatë jofitimprurëse. Akreditimi i parë institucional në vitin 2013² nga APAAL dhe rikonfirmimi i këtij vlerësimi nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë dhe ASCAL në vitin 2017³, si edhe i të gjitha programeve të studimit që ofrohen është një tregues i rëndësishëm i cilësisë dhe standardeve të Kolegjit Universitar “Bedër”.

KUB synon përshtur rritjen e cilësisë akademike dhe institucionale, e cila i ka përcaktuar vizionin e funksionimit, që nuk synon masivitetin, por cilësinë. Kapaciteti studentor maksimal afatmesëm i parashikuar i kolegjit universitar është 1250-1500 studentë në të gjitha programet, për nivelet e studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë (bachelor, master). KUB ka vendosur si synim të tij krijimin dhe konsolidimin e një profili ndërkombëtar. Në këtë këndvështrim, gjatë shtatë viteve të aktivitetit të tij, institucioni ka mundur pranimin e studentëve nga trevat shqipfolëse në rajon dhe në diasporë, nga disa vende të Evropës dhe më gjerë. Harta e shteteve nga ku kanë ardhur studentët është zgjeruar vazhdimisht përgjatë shtatë viteve duke kapur shifrën 16 (gjashtëmbëdhjetë). Përbërja e personelit akademik, pasqyron gjithashtu profilin ndërkombëtar të kolegjit, i cili përforcohet me bashkëpunimet e vendosura nëpërmjet marrëveshjeve me universitete dhe kompani në disa vende të botës.

KUB operon mbi baza jofitimprurëse dhe mbështet studentët e suksesshëm, të cilët duan të vazhdojnë studimet e larta pranë tij. Gjatë 6 viteve të fundit të aktivitetit të tij në Kolegjin Universitar “Bedër” kanë studiuar dhe vazhdojnë studimet 780 studentë që përfitojnë zbritje nga tarifat e studimit.⁴ KUB, që nga fillimi i aktivitetit akademik ka organizuar konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, seminare të hapura, veprimtari kualifikuese e nxitëse, duke dhënë një kontribut në shkencë dhe shoqëri. Për përmbushjen e misionit të tij, KUB ofron programe studimesh në përputhje të plotë me të gjithë komponentët e strategjisë për zhvillimin e institucionit. Programet e ofruara janë si më poshtë:

“Bachelor” në:

1. Drejtësi;
2. Shkenca komunikimi;
3. Marrëdhënie publike dhe komunikim marketingu;
4. Shkenca islame;

¹ Evidenca nr. 1 - Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për licencimin e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër)

² Evidenca nr. 15 - Urdhër nr 223, datë 4.06.2013 “Për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit”

³ Evidenca nr. 16 - Vendimi nr 101, datë 10/11/2017 “Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë “Kolegji Universitar Bedër”

⁴ Koment: Lista në lidhje me studentët që kanë përfitur zbritje mund të gjendet në zyrën e finances si dhe në zyrën e secretaries mësimore

5. Gjuhë dhe letërsi turke;
6. Gjuhë dhe letërsi angleze;
7. Arsimit parashkollor dhe fillor;
8. Psikologji këshillimi dhe pedagogji;
9. Teknologji informacioni dhe komunikimi.

“Master i shkencave” në:

10. Drejtësi. Profilet: *E drejtë penale* dhe *E drejtë ndërkombëtare*;
11. Shkenca komunikimi. Profilet: *Marrëdhënie publike* dhe *Gazetari*;
12. Shkenca moderne islame;
13. Shkenca themelore islame;
14. Psikologji këshillimi dhe pedagogji;
15. Gjuhë dhe letërsi turke;
16. Gjuhë dhe letërsi angleze.

“Master Profesional” në:


17. Mësuesi, gjuhë angleze për arsimin e mesëm;
18. Mësuesi, gjuhë turke për arsimin e mesëm.

Programet e studimit në të dyja ciklet organizohen në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara nga Karta e Bolonjës dhe legjislacioni shqiptar për arsimin e lartë. Aktivitetet me bazë kërkimore janë një kriter i rëndësishëm për profesionalizmin që karakterizon punën brenda KUB. Mbështetur në një filozofi të qartë mbi nivelin e arsimit që ofron, si pjesë e një fondacioni arsimor dhe me status jofitimprurës, liria akademike dhe autonomia e kolegjit ndihmojnë për të realizuar idetë e planifikuara, por nga ana tjetër, të gjitha këto janë të shoqëruara me përgjegjësi për vendimet e ndërmarra. Hapja ndaj ideve të reja, bashkëpunimi mes njerëzve, organizatave dhe fushave kërkimore, si dhe qasja me në qendër zhvillimin e vlerave humane kontribuojnë në ndryshime pozitive në kolegji dhe botën rreth tij.

RRETH PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM DHE PROGRAMIT TË STUDIMIT

Departamenti i Drejtësisë është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Humane. Departamenti i Drejtësisë operon si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e shkencave juridike, në përputhje me Ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë kuadër, departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare të departamentit.

Programi i studimit “Master i shkencave” në Drejtësi, Profili e *Drejtë Penale* dhe Profili e *Drejtë Ndërkombëtare* është projektuar t’u ofrojë një horizont intelektual dhe profesional studentëve duke parashtruar një shumëllojshmëri konceptuale dhe perspektive në fushën e shkencave juridike. Programi “Master i shkencave” në Drejtësi synon t’u ofrojë mundësi studentëve të thellojnë njohuritë dhe të specializohen në fushën e së drejtës kryesisht në fushën e së drejtës penale dhe ndërkombëtare duke u njohur me nocionet juridike penale dhe ndërkombëtare. Gjatë këtyre dy viteve studentët do të thellojnë njohuritë e marra gjatë ciklit të



mëparshëm duke synuar përgatitjen e juristëve të kualifikuar për të punuar në organet e drejtësisë. Programi synon të nxisë studentët të thellohen në punën kërkimore, shkencore dhe angazhimin e tyre si personel akademik.

Departamenti i Drejtësisë parashtron arsim për të gjithë ata studentë që janë të interesuar, të ndërtojnë karrierën e tyre profesionale dhe akademike në fusha të ndryshme të së drejtës, si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat.

Departamenti ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në Drejtësi, konkretisht:

- “Bachelor” në Drejtësi
- “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. *E Drejtë penale*; b. *E Drejtë ndërkombëtare*

➤ **Rreth Programit “Master i shkencave” në Drejtësi në profilin: a. *E Drejtë penale***

Programi “Master i shkencave” në Drejtësi, profili *E drejtë penale* përfshin fushën juridiko-penale, i cili ka për qëllim arsimimin akademik dhe trajnimin profesional të studentëve dhe të formojë njohuri specifike të pasqyruara në drejtëm të zhvillimeve dhe të përmirësimit të legjislacionit penal. Ky program studimi përgatit specialistë të aftë për të organizuar, planifikuar dhe drejtuar veprime procedurale që duhet të kryhen nga subjektet e procedimit penal gjatë veprimtarisë hetimore, gjyqësore dhe të ekzekutimit të vendimeve, të lidhura me respektimin e të drejtave të njeriut në luftën kundër krimit dhe dhënien e drejtësisë në fushën e së drejtës penale. Kjo do të ndikojë edhe në rritjen e garancive për një proces të rregullt ligjor.

Misioni


Misioni i Departamentit të Drejtësisë është përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e drejtësisë, që do të mund t’i shërbejnë institucioneve publike, private dhe të biznesit, si në nivel lokal ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Filozofia jonë mbështetet në vlerat universale të së drejtës, etikën profesionale, zhvillimin e aftësive praktike, me qëllim vendosjen në jetë të projekteve që i shërbejnë individëve dhe shoqërisë në tërësi.

Vizioni

Paraqitja para studentëve programe të kompletuara me të gjitha njohuritë e nevojshme për një përgatitje sa më të plotë akademike dhe profesionale në fushën e drejtësisë, duke u mbështetur në baza të etikës profesionale, për të zhvilluar mendimin kritik tek studentet dhe për t’i bërë ata të kuptojnë rëndësinë e rolit të tyre në shoqëri.

Objektivat e programit “Master i shkencave” në Drejtësi, profili *E drejtë penale*

1. Përvetësimi i koncepteve bazë juridike penale dhe përdorimi i tyre me efikasitet
2. Njohja me institutet e së drejtës penale në Shqipëri dhe në Evropë si dhe dallimet që kanë sistemet e ndryshme penale ligjore
3. Familjarizimi i studentëve me përgjegjësinë etike dhe profesionale
4. Njohja me kushtet sociale, ekonomike, historike, politike dhe filozofike që kanë ndikuar në sistemin e drejtësisë penale në Shqipëri si dhe njohja e faktorëve dhe vlerave që kanë ndikuar në formësimin e së drejtës penale



5. Njohja me faktin që ligji (e drejta) bazohet në sisteme te ndryshme vlerash të cilat janë vazhdimisht në ndryshim
6. Integrimi i teorikes, praktikës dhe politikave te ndryshme në mënyrë qe studentët të kuptojnë mënyrën e funksionimit të ligjit
7. Njohja e studentëve me faktin që e drejta është vetëm një pjesë e sistemit të dijës dhe ofrimi i mundësive për të përvetësuar njohuri nga disiplina të ndryshme në mënyrë që të jenë të aftë për tu përshtatur me tregun e punës
8. Ndërgjegjësimi i studentëve për te kontribuar për komunitetin
9. Të kuptuarit dhe ndërgjegjësimi me të mësuarit gjatë gjithë jetës në mënyrë që ti përshtaten tregut të punës
10. Zhvillim i bashkëpunimit me të gjitha institucionet që janë të kyçura në mënyrën e funksionimit të sistemit juridik të vendit duke i përfshirë këtu si organet shtetërore ashtu edhe departamenteve tjera juridike në vend
11. Dhënia e kontributit në zhvillimit e sistemit juridik penal në Republikën e Shqipërisë
12. Përcjellja e trendëve në fushën e shkencës dhe praktikës së jurisprudencës penale
13. Përgatitje e kuadrove në fushat e ndryshme të jurisprudencës penale në Shqipëri

Rezultatet e Programit: “Master i shkencave” në Drejtësi , profili *E drejtë penale*


Të diplomuarit në e ciklit të dytë të studimeve, “Master i shkencave” në Drejtësi: profili *E drejtë penale* do të jenë në gjendje të:



- a) Kuptojnë parimet fundamentale të sistemeve te drejtësisë penale dhe ndryshimet ndërmjet tyre
- b) Kuptojnë konceptet dhe terminologjinë ligjore ne fushën substantivë dhe procedurale të ligjit penal
- c) Bëjnë kërkime shkencore-juridike ne fushën penale-juridike
- d) Angazhohen në analiza ligjore nëpërmjet rasteve të ndryshme ligjore
- e) Kuptojnë, historikun, qëllimin, strukturën, rregullat dhe përgjegjësitë e subjekteve juridike penale
- f) Zhvillojnë mendimin kritik nëpërmjet leximit dhe analizimit të materialeve ligjore
- g) Kuptojnë ndryshimin ndërmjet së drejtës procedurale dhe asaj substanciale
- h) Demonstronjë aftësi solide ne parimet e së drejtës si dhe në zbatueshmerinë e ligji
- i) Kenë njohuri mbi mënyrën e investigimit të krimit dhe te pajisen me njohuri rreth raportit mjeko ligjor te hartuar nga institucione qe merren me investigimin e krimit
- j) Zbatojnë ligjin me profesionalizëm dhe etike duke respektuar integritetin personal
- k) Kuptojnë ligjin si profesion publik dhe rëndësinë e ofrimit të shërbimeve ndaj komunitetit
- l) Kuptojnë klasifikimin e krimeve dhe rrezikshmërinë e tyre
- m) Krahasojnë ligjin penal të Shqipërisë me atë të vendeve Evropian
- n) Kuptojë dhe analizojë rolin e oficerit te policisë gjyqësore, avokatit dhe prokurorit ne procesin penal

Mundësitë e punësimit

Programet e studimit të ofruara nga ana e Departamentit të Drejtësisë janë në përputhje të plotë qoftë me kërkesat aktuale të tregut të punës, ashtu edhe me zhvillimet e pritshme të ekonomisë shqiptare si një ekonomi në zhvillim, e cila synon integrimin në tregun unik evropian. Kurrikulat bashkëkohore synojnë të përgatisin:

- jurist/specialist në institucionet e administratës publike (qendrore/vendore)



- jurist\specialist në institucione nderkombëtare
- jurist\specialist\konsulent ligjor në sektorin privat
- asistent avokat\asistent noter si dhe kualifikim për pjesmarje në provimin e avokatisë
- asistent kërkimor\mësimor pranë IAL
- avokat, noter
- prokurorë, gjyqtarë

➤ **Rreth Programit “Master i shkencave” në Drejtësi në profilin: b. E Drejtë Ndërkombëtare**

Programi “Master i shkencave” në Drejtësi, profili *E drejtë ndërkombëtare* ka si objektiv parësor përgatitjen e juristëve të ardhshëm, me një bagazh të gjerë në të drejtën ndërkombëtare, në mënyrë që të përmbushë nevojat e tregut të punës me individë të kualifikuar në fushën respektive. Duke patur parasysh përpjekjet e mëdha për integrimin e Shqipërisë në strukturat perëndimore kërkesat e tregut të punës për individë të kualifikuar konsiderohen të larta.

Misioni

Misioni i Departamentit të Drejtësisë është përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e drejtësisë, që do të mund t’i shërbejnë institucioneve publike, private dhe të biznesit, si në nivel lokal ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Filozofia jonë mbështetet në vlerat universale të së drejtës, etikën profesionale, zhvillimin e aftësive praktike, me qëllim vendosjen në jetë të projekteve që i shërbejnë individëve dhe shoqërisë në tërësi.

Vizioni

Paraqitja para studentëve programe të kompletuara me të gjitha njohuritë e nevojshme për një përgatitje sa më të plotë akademike dhe profesionale në fushën e drejtësisë, duke u mbështetur në baza të etikës profesionale, për të zhvilluar mendimin kritik tek studentet dhe për t’i bërë ata të kuptojnë rëndësinë e rolit të tyre në shoqëri.

Objektivat e programit të studimit “Master i shkencave” në Drejtësi: profili E Drejtë Ndërkombëtare:

1. Përvetësimi i koncepteve bazë juridike ndërkombëtare dhe përdorimi i tyre me efikasitet
2. Integrimi i teorikës, praktikës dhe politikave të ndryshme në mënyrë që studentët të kuptojnë mënyrën e funksionimit të ligjit ndërkombëtar
3. Njohja e studentëve me faktin që e drejta është vetëm një pjesë e sistemit të dijes dhe ofrimi i mundësive për të përvetësuar njohuri nga disiplina të ndryshme në mënyrë që të jenë të aftë për tu përshtatur me tregun e punës
4. Ndërgjegjësimi i studentëve për të kontribuar për komunitetin
5. Të kuptuarit dhe ndërgjegjësimi me të mësuarit gjatë gjithë jetës në mënyrë që të përshtaten tregut të punës
6. Zhvillim i bashkëpunimit me të gjitha institucionet që janë të kyçura në mënyrën e funksionimit të sistemit juridik të vendit duke i përfshirë këtu si organet shtetërore ashtu edhe departamenteve tjera juridike në vend.
7. Përejllja e trendëve në fushën e shkencës dhe praktikës së jurisprudencës ndërkombëtare.



8. Përgatitje e kuadrove në fushat e ndryshme të jurisprudencës ndërkombëtare në Shqipëri, rajon dhe më gjerë etj
9. Përgatitja e kuadrove në fushën e së drejtës ndërkombëtare dhe evropiane

Të diplomuarit në e ciklit të dytë të studimeve, Master i Shkencave në Drejtësi: profili drejtë ndërkombëtare do të jenë në gjendje të:


- a) Kuptojnë konceptet dhe terminologjinë ligjore në fushën ndërkombëtare të ligjit
- b) Demonstrjnë mundësinë që të identifikojnë and kuptojnë konceptet e substantivë të ligjit, teoritë ligjore dhe procedurat sipas ligjit ndërkombëtar
- c) Bëjnë kërkime shkencore juridike ne fusha të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare
- d) Angazhohen në analiza të ndryshme ligjore të së drejtës ndërkombëtare
- e) Zhvillojnë mendimin kritik në leximin dhe analizimin e materialeve ligjore
- f) Demonstrjnë aftësi solide ne parimet e së drejtës ndërkombëtare si dhe zbatueshmëria e ligjit
- g) Kuptojnë mënyrën e organizimit dhe funksionimit e organizatave ndërkombëtare dhe roli i tyre
- h) Analizojë në mënyrë kritike çështjet dhe ngjarjet e rëndësishme në të drejtën Ndërkombëtare
- i) Përvetësojnë aftësi për t'iu përshtat tregut të punës në fusha të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare

Mundësitë e punësimit

Programet e studimit të ofruara nga ana e Departamentit të Drejtësisë janë në përputhje të plotë qoftë me kërkesat aktuale të tregut të punës, ashtu edhe me zhvillimet e pritshme të ekonomisë shqiptare si një ekonomi në zhvillim, e cila synon integrimin në tregun unik europian.

Kurrikulat bashkëkohore synojnë të përgatisin:

- jurist\specialist në institucionet e administratës publike (qendrore/vendore)
- jurist\specialist në institucione nderkombëtare
- jurist\specialist\konsulent ligjor në sektorin privat
- asistent avokat\asistent noter si dhe kualifikim për pjesmarje në provimin e avokatisë
- asistent kërkimor\mësimor pranë IAL
- avokat, noter





RRETH PROCESIT TË AKREDITIMIT

Në mbështetje të nenit 103 dhe të nenit 104 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, statutit të Kolegjit Universitar “Bedër”, si dhe urdhrorit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin institucional të institucioneve të arsimit të lartë”, nën përgjegjësinë e titullarit të njësisë dhe me vendim të Senatit Akademik, u ngrit Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) për programin “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. *E Drejtë Penale*; b. *E Drejtë Ndërkombëtare*.⁵

Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB janë marrë parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes të anëtarëve të grupit. Grupi është ngritur qëllimisht për misionin e vlerësimit të brendshëm (grup ad-hoc). GVB-ja ka në përbërjen e tij 5 antarë sipas një strukturë organizative (drejtuesi, sekretari etj.). Ai përfshinë edhe përfaqësues të studentëve, si dhe është ngritur duke marrë parasysh edhe shpërndarjen e detyrave të secili anëtar.

Ky proces rivlerësimi i jashtëm për programin e studimit “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. *E Drejtë Penale*; b. *E Drejtë Ndërkombëtare* vjen pas një përvoje akreditimi të vitit 2013, të cilin njësia bazë e kaloi me sukses dhe u akreditua për 6 vite. Jo vetëm kaq, por KUB ka ngritur që në fillimet e tij edhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), si njësi e përhershme për të kontrolluar dhe për të garantuar përmbushjen e standardeve në këtë drejtim. Një tjetër aspekt me rëndësi ka qenë dhe marrja e certifikatës së cilësisë ISO 9001:2008.⁶ Një proces tjetër me rëndësi për ruajtjen e cilësisë së brendshme ka filluar të ndiqet rregullisht nga viti 2012, ku çdo njësi bazë dhe kryesore e KUB, çdo fundviti akademik, dorëzon në Rektorat raportin vjetor, i cili në vetvete është një model i vlerësimit të brendshëm të njësive.⁷

Raporti i vetëvlerësimit u diskutua në njësi, nga ku dolën mendime dhe sugjerime të cilat plotësuan hartimin e raportit përfundimtar.

GRUPI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM (GVB)

Përbërja e GVB:

1. Dr. Nertil Bërdufi - Kryetar
2. Dr. Ferdinand Xhaferaj – Anëtar
3. Dr. Bojana Hajdini - Anëtare
4. Msc. Ermira Shkreta - Sekretare
5. Ermelinda Gjeci – Përfaqësuese e studentëve

Shënim: Grupi i vlerësimit të brendshëm ngrihet nën përgjegjësinë e titullarit të njësisë, pasi ky i fundit merr mendimin e organit vendimmarrës përkatës. Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB duhen patur parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes të anëtarëve të grupit, përfaqësimin në grup të sa më shumë opinioneve të njësisë duke evituar në maksimum përfshirjen në të, të personave konfliktualë ose koniunkturalë. Grupi, si rregull ka në përbërje të tij 3-5 punonjës të njësisë. Grupi ngrihet qëllimisht për misionin e vlerësimit (grup ad hoc). Ai përcakton një strukturë organizative (drejtuesi, sekretari etj.) dhe një shpërndarje të detyrave. Është e domosdoshme që në GVB të përfshihen dhe përfaqësues të studentëve.

⁵ Evidenca nr. 24 – Vendimi i Senatit Akademik mbi Ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm

⁶ Evidenca nr. 44 – ISO Certifikatë 9001:2008

⁷ Evidenca nr. 34 - Modeli i raportit vjetor i dorëzuar në Rektorat nga departamenti




I. PARIMET E PUNËS SË GVB

- Vlerësimi i Cilësisë duhet të karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.
- Zhvillimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) në Njësitë e IAL.
- Të realizojë Vlerësimin e Brendshëm me synimin që të krijohet një tablo e qartë dhe transparente e Njësisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të institucioneve e programeve.
- Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, personelet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.
- Të shërbejë kryesisht për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë si pjesë e tyre e brendshme dhe e qëndrueshme.
- Vlerësimi të bëhet i mbështetur në dokumenta, procedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.

II. ETAPAT E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM NGA IAL

1. Kërkesë për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm të programit nga ana e Kolegjit Universitar “Bedër”
2. Pranimi i kërkesës dhe njoftimi për trajnimin e grupit të punës mbi sistemin e menaxhimit të ASCAL
3. Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm me propozim të Këshillit të Departamentit dhe miratim të Senatit Akademik me vendimin nr. 3, datë 26.11.2018⁸
4. Trajnimi i GVB nga stafi i ASCAL-it; për këtë vihen në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e secilit.
5. Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzimeve përkatëse të ASCAL-it.
6. Përgatitja e dosjes së vetëvlerësimit.
7. Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), sipas kërkesave e udhëzimeve në këtë udhëzues dhe pas konsultimit të përmbajtjes së tij me personelin e institucionit.
8. Dorëzimi në ASCAL i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm bashkë me të gjithë dokumentacionin mbështetës.

⁸ Evidenca nr. 24 - Vendimi i Senatit Akademik mbi ngritjen e grupit të vlerësimit të brendshëm


ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- 1) Të krijohen mundësitë për të arrituruar në nivelin e kërkuar të përqindjes së stafit të brendshëm dhe kuafikimi i një pjese të tij në krahasim me atë të jashtëm
- 2) Të rritet numri i titujve dhe botimeve bashkëkohore në bibliotekën e Institucionit
- 3) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin e parë, Institucioni dhe Departamenti ka rritur numrin e profesorëve dhe lektorëve me kohë të plotë posaçërisht në programet e studimit të ciklit të dytë. Lektorët e pranuar rishtazi janë me kualifikim të përcaktuar në profilet e studimeve "Master" që departamenti ofron. Aktualisht në Departamentin e Drejtësisë janë të punësuar me kohë të plotë 9 anëtarë, prej të cilëve 1 mban titullin akademik Prof. Dr., 3 janë me gradën shkencore Dr., 2 janë në përfundim të doktoraturës dhe 3 janë "Master i shkencave". Gjatë kësaj periudhe, personeli akademik është trajnuar si brenda institucionit në garantimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Gjithashtu, varësisht fushës së studimit, personeli akademik ka kryer specializime në universitete perëndimore.
- b) Për rekomandimin e dytë, Institucioni në bashkëpunim me Departamentin kanë filluar me zbatimin e projektit për pasurimin e bibliotekës. Biblioteka ka një kapacitet të mjaftueshëm me nëndarje të posaçme për programet e studimit që departamenti ynë ofron. Projekti për pasurimin e bibliotës përfshin edhe ofrimin e literaturës online, me një vëllim shumë të gjerë të titujve dhe botimeve në gjuhën angleze. Ky projekt ka filluar me përfshirjen e EBSCOhost (librari online), e cila përmban një database mbarëbotërore me titujt dhe botimet më të rëndësishme globale. Aktualisht në bibliotekën klasike të KUB ka mbi 36.000 tituj shtu dhe në librarinë *online* EBSCOhost të saj, nga mundësohen 45.000 libra si dhe mbi 5.000 revista shkencore.
- c) Për rekomandimin e tretë, Institucioni dhe Departamenti ka marrë të gjitha masat e nevojshme, duke shfrytëzuar edhe marrëveshjet ndërinstitucionale me British Council për t'u siguruar që studentët e ciklit të dytë të kenë njohuri të kënaqshme të gjuhës angleze si në fazën paraprake të pranueshmërisë në programin e studimit, ashtu edhe në përfundim të studimeve. Mbrojtja e gjuhës angleze është kusht për diplomimin e studentëve të këtij niveli dhe aktualisht me ndryshimet ligjore është kusht për t'u pranuar në këtë cikël studimesh.



PROGRAMI I STUDIMEVE, ADMINISTRIMI NË SHËRBIM TË MISIONIT TË NJËSISË

1- Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit, mësimdhënia dhe kërkimi shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektiveve dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për programin e studimit (historiku, numri i punonjësve në vite, numri i studentëve në vite, vendi i Programit të studimit në kuadrin kombëtar e ndërkombëtar.

Fakulteti i Shkencave Humane në Kolegjin Universitar “Bedër” është i angazhuar për nxitjen e mendimit kritik intelektual dhe synon një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në Shqipëri, rajon dhe më gjerë. Misioni i tij është përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e shkencave islame, të komunikimit, të drejtësisë, dhe të disiplinave të ndërlidhura me to, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale dhe mbështetjen e kërkimi shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut, zhvillimin e teknologjisë së komunikimit e medias si dhe zhvillimin e mbarë shoqërisë. Njohuritë e niveli bashkëkohor, të përditësuara për secilën nga fushat e sipërpërmendura, i pajisin studentët me njohuri të cilat u japin mundësinë të vijonë studimet në disiplinat e shkencave humane, brenda dhe jashtë vendit.

Departamenti i Drejtësisë në KUB është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Humane. Në përputhje me Ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Departamenti i Drejtësisë vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinat juridike. Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij, për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit. Departamenti i Drejtësisë parashtron arsim për të gjithë ata studentë që janë të interesuar, të ndërtojnë karrierën e tyre profesionale dhe akademike në fusha të ndryshme të së drejtës, si në publik ashtu dhe në atë privat. Programi “Master i Shkencave” në Drejtësi është projektuar t’u ofrojë një horizont intelektual dhe profesional studentëve duke parashtruar një shumëllojshmëri konceptuale dhe perspektive në këtë fushë.

Misioni

Misioni i Departamentit të Drejtësisë është përgatitja e studentëve të kualifikuar në fushën e drejtësisë, që do të mund t’u shërbejnë institucioneve publike, private dhe të biznesit, si në nivel lokal ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Filozofia jonë mbështetet në vlerat universale të së drejtës, etikën profesionale, zhvillimin e aftësive praktike, me qëllim vendosjen në jetë të projekteve që i shërbejnë individëve dhe shoqërisë në tërësi.

Realizimi i misionit

Misioni i Departamentit të Drejtësisë për programin “Master i Shkencave” në Drejtësi është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të Kolegjit Universitar “Bedër”, me standardet ndërkombëtare, si edhe me veçantitë dhe risitë që synon të sjellë ky institucion në vendin tonë dhe më gjerë. Në funksion të realizimit të misionit dhe të rolit që



institucionet e arsimit të lartë në tërësinë e tyre duhet të luajnë në aktivitetin e tyre, Departamenti i Drejtësisë kryen aktivitete të shumëllojshme në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Ky departament organizon në mënyrë të përvitshme konferenca ndërkombëtare dhe/ose workshope në fushën e drejtësisë, me tema të përzgjedhura në përputhje me prirjen dhe interesat kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këto konferenca dhe/ose workshope marrin pjesë studietë rinj, akademik, personalitete të ndryshëm nga universitete vendase si dhe nga universitetet nga vende të ndryshme të botës. Departamenti i Drejtësisë u kushtoi një rëndësi të veçantë aktiviteteve jashtëkurrikulare të studentëve. Ky departament merr pjesë çdo vit në dy konkurse të rëndësishëm ndërkombëtare përkatësisht JESSUP dhe ICC Moot Court në Hagë, gjithashtu dhe në Gjyqin Simulues të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, i cili organizohet në Tiranë, ku studentët në mënyrë të vazhdueshmë përmirësojnë formimin e tyre.

Departamenti i Drejtësisë i ka kushtuar një rëndësi të veçantë pjesëmarrjes në konkurse të simulimit gjyqësor organizuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të shkrimit ligjor dhe aftësisë komunikuese. Konkursët në të cilët Departamenti i Drejtësisë merr pjesë janë si më poshtë:

— Konkursi i simulimit gjyqësor të së Drejtës Ndërkombëtare Filip C. Jessup, i njohur edhe si Jessup është konkursi më i madh dhe më prestigjioz në botë, duke tërhequr pjesëmarrës nga mbi 680 Universitete në më shumë se 100 vende në vitet e fundit. Konkursi është një simulim i një mosmarrëveshjeje imagjinare ndërmjet shteteve përpara Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Ky konkurs është i organizuar nga Shoqata e Studentëve të së Drejtës Ndërkombëtare dhe zhvillohet në Washington DC, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. <<https://www.ilsa.org/about-jessup/>>

— Konkursi i simulimit gjyqësor të Gjykatës Ndërkombëtare Penale organizohet nga Qendra Grotius për Studime Ligjore Ndërkombëtare në Universitetin e Leidenit dhe Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve. Ky konkurs zhvillohet në Hagë, Hollandë dhe mirëpret universitete nga e gjithëbota, për një shkallë të madhe të debatit, duke simuluar punimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve. Konkursi përfshin bashkëpunimin me gjyqtarë nga gjykata ndërkombëtare, profesorë të së drejtës ndërkombëtare (penale) dhe profesionistë të tjerë ligjorë. Ky rrjet e bën konkursin një simulim real të seancave që zhvillohen në Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve. Çështjet e konkursit i drejtohen çështjeve themelore të së Drejtës Penale Ndërkombëtare si procedurale ashtu dhe substanciale. <<http://icjmoot.com/>>

— Konkursi ‘Gjyq simulues i GJEDNJ’ organizuar nga Qendra Evropiane në bashkëpunim me Civil Right Defenders (CRD) në Tiranë. Qëllimi i këtij gjyqi simulues është promovimi i standardeve, lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri, si një pjesë e pandarë e konsolidimit të shtetit të së drejtës dhe numrit gjithnjë e në rritje të rasteve të dërguara nga qytetarët shqiptarë në GJEDNJ. Studentët përgatiten për një rast hipotetik duke thëlluar në praktikë njohuritë në fushën e të drejtave të njeriut, veçanërisht të atyre që garantohen nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe njohjen më mirë të jurisprudencës së Gjykatës të Strasburgut. <<http://www.euro-centre.eu/moot-court-gjednj/>>

Gjithashtu aktivitetet ekstra-kurrikulare inkurajojnë zhvillimin e leksioneve të hapura, në të cilat ftohen figura të njohura të fushës së drejtësisë në Shqipëri, për t’u dhënë mundësi studentëve që njohuritë e tyre t’i vënë në praktikë, vizitat në institucionet gjyqësore dhe në gjyqin e improvizuar. Brownbag Seminars in Law është një cikël leksionesh të hapura ku çdo muaj klubi studentor *Beder Law Academy* ka një të ftuar, specialist i një fushe specifike në drejtësi. Aftësimi i studentëve për tregun e punës është filozofia në të cilën mbështete Departamenti i Drejtësisë. Për këtë qëllim përveç aktiviteteve të përmendura më lart, një rëndësi




e madhe i kushtohet dhe praktikave profesionale në institucione të ndryshme të fushës së drejtësisë.

Objektivat dhe kompetencat profesionale të programit

Në ndryshim me konceptin tradicional të edukimit në fushën e drejtësisë si edukim ekskluzivisht juridik, filozofia jonë është ndërthurja e programit të departamentit të drejtësisë me programin mësimor të Kolegjit Universita “Bedër”. Në këtë mënyrë, synohet që të zgjerohen dijet e studentit jo vetëm në lëndë juridike, por edhe në lëndë ose koncepte ndihmesë të shkencave sociale, të cilat i aftësojnë juristët në të menduarit në mënyrë analitike, arsyetimin ligjore dhe të gjykuarit më mirë. Programet akademike në këtë departament u kushtojnë një rëndësi të veçantë lëndëve themelore për formimin profesional. Programet u mundësojnë studentëve formim të përgjithshëm juridik, si edhe mundësin për t’u profilizuar, çfarë i paraprin një specializimi që ata mund të marrin në të ardhmen. Ky program u ofron mundësi studentëve të përgatiten për pjesëmarrje aktive dhe efektive si profesionistë në këshilli me ligjore, mbrojtje dhe vendimmarrje, si edhe në sfera të tjera profesionale në fushën penale, publike apo civile. Studentët inkurajohen të studiojnë drejtësinë dhe institucionet ligjore si pjesë integrale e sistemeve shoqërore.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5. Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6. Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programet e studimit të ofruara nga ana e Kolegjit Universitar “Bedër” janë në përputhje të plotë qoftë me kërkesat aktuale të tregut të punës, ashtu edhe me zhvillimet e pritshme të ekonomisë shqiptare si një ekonomi në zhvillim, e cila synon integrimin në tregun unik europian.</p> <p>Kurrikulat bashkëkohore të Kolegjit Universitar “Bedër” synojnë të përgatisin:</p> <p>I. Jurist\specialist në institucionet e administratës publike (qendrore/vendore); jurist\specialist në institucione ndërkombëtare; jurist\specialist\konsulent ligjor në sektorin privat; asistent avokat\asistent noter si dhe kualifikim për pjesëmarrje në provimin e avokatisë; asistent kërkimor\mësimor pranë IAL.</p> <p>Pas diplomimit, studentët mund të vazhdojnë studimet e tyre të Doktoraturës, ose studimet pasuniversitare në Shqipëri ose jashtë vendit. Ata gjithashtu mund të bëhen asistent-lektorë në universitete, koordinatorë konferencash, projektsh etj. Ky program pajis studentët me aftësi dhe njohuri të ndryshme, ku ndër të tjera u mundëson atyre lehtësi në marrëdhëniet personale dhe ndërpersonale. Programi “Master i shkencave” (MSc) në Drejtësi me dy profilet e tij është hartuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe parashikimet e Kartës së Bolonjës. Që në çeljen e tij, ai është hapur varësisht një analize dhe studimi tregu të zhvilluar nga një grup ekspertësh nga KUB. Ky studim tregu u përditësua në vitin 2016, me një raport edhe më të detajuar. Programet janë hartuar duke vlerësuar dhe mbajtur pasur parasysh nevojat dhe kërkesat e tregut të punës sipas rezultateve të studimeve përkatëse.</p> <p>Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare për arsimin e lartë. Politikat zhvillimore të departamentit hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës. Në këtë kuadër, programet e drejtësisë përmbajnë lëndë, të cilat formojnë studentët lidhur me funksionimin e ekonomisë kombëtare e ndërkombëtare si dhe politikat ekonomike që kontribuojnë në zhvillimin e vendit.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Kriteri 1: Si një departament i bazuar në preferenca profesionale, politikat zhvillimore të departamentit hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës. Në këtë kuadër, drejtësia paraqitet si një ndër më prioritarët dhe me hapësirë të mjaftueshme për punësimin e të diplomuarve sidomos në momentet aktuale ku i gjithë sektori i drejtësisë po kalon në një reforme të thellë.</p> <p>Në përmbushje të misionit të tij, KUB ofron programe studimi në përputhje të plotë me të gjithë komponentët e strategjisë për</p>



	<p>zhvillimin e institucionit. Plani strategjik i institucionit është planifikuar, duke marrë parasysh tri elemente të rëndësishme, një ndër të cilët është mësimdhënia, e parashikuar kjo në mënyrë të detjuar. Në përmbushje të këtij kriteri, KUB ofron informacion të detajuar për të gjithë kandidatët e interesuar për të vazhduar studimet në këtë institucion, si edhe për studentët që vijojnë studimet në të.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1. Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2. Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit “Master i shkencave” në drejtësi me profil <i>E Drejtë penale/ ndërkombëtare</i> është në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, e vërtetuar kjo edhe nga vlerësimi maksimal që ai mori në procesin e akreditimit të parë në vitin 2013 nga APAL. Ky program studimi bazohet në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulën e programit Master. Programi i studimit të ciklit të dytë i pajis studentët me njohuritë më të avancuara për metoda e parime shkencore të përgjithshme.</p> <p>Në hartimin e programit të studimit, është marrë parasysh që emërtimi i programit të studimit të jetë në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Më konkretisht, programi “Master i shkencave” në Drejtësi përkon me nivelin 7 në kornizën shqiptare të kualifikimit.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2. Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Kriteri 1: Siç vërtetohet edhe në “Plani Strategjik i KUB”, Institucioni ka hartuar një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve.⁹</p> <p>Kriteri 2: KUB ka hartuar një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Pas përfundimit të raportit të hartuar, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) diskutoi në mënyrë të hollësishme përputhshmërinë me kërkesat e përfshira në kriteret e përcaktuar, si dhe bazuar në dosjen e kurikulave të Programit të studimit “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. <i>E Drejtë Penale</i>; b. <i>E Drejtë Ndërkombëtare</i> në KUB. GVB konstaton se Departamenti i Drejtësisë në KUB është kompetent dhe zhvillon një brez studentësh që i nevojitet tregut të punës, programet janë të hartuara në përputhshmëri me planin strategjik të KUB, i hartuar në nivel institucional për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe mësimdhënies. Programi i studimit “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. <i>E Drejtë Penale</i>; b. <i>E Drejtë Ndërkombëtare</i> në Departamentin e Drejtësisë është në përputhshmëri të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me Kartën e Bolonjës, dhe me kornizat bazë shqiptare të kualifikimit. GVB konstaton se programi në fjalë i përmbush plotësisht kriteret e kërkuara, gjithashtu programi në fjalë do të fuqizojë pozitën e KUB, si një institucion i konsoliduar kërkimor shkencor me influencë në vend, dhe do të kontribuojë në zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës sociale në vend.</p>	

⁹ Evidenca nr. 22 - Plani strategjik i Kolegjit Universitar “Bedër” 2018-2023





2- Struktura akademike e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Departamentit të Drejtësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Strukturat akademike të Fakultetit, ndarja në Departamente, të dhëna për ndarjen e personelit në këto njësi bazë, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE), Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), koordinimi i mësimdhënies me njësi të tjera.

Tregues të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit (organigrama)

STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE



Kolegji Universitar “Bedër” dhe Fakulteti i Shkencave Humane

KUB organizohet në 2 fakultete: Fakulteti i Shkencave Humane dhe Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit. Ai ka në përbërje të tij 6 njësi bazë departamente, dy qendra kërkimore zhvillimore, si edhe njësitë ndihmëse administrative, sipas organigramës së miratuar.¹⁰¹¹ Njësitë e lartpërmendura operojnë në bazë të parimit të autonomisë brenda kompetencave të tyre. Fakulteti është njësi kryesore e KUB i cili bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura. Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme, në përfundim të cilave përfitohet diplomë. Organet dhe autoritetet drejtuese të Fakultetit të Shkencave Humane janë: Dekanati, Dekani, zëvendësdekani, administratori i Fakultetit si dhe njësitë bazë të tij (Departamentet).

DEKANATI

Dekanatet e Kolegjit Universitar “Bedër” janë organe kolegjiale ekzekutive të njërive kryesore përkatëse. Dekanati përbëhet nga:

- dekani;
- zëvendësdekani;
- përgjegjësit e njësisë bazë;
- administratori i njësisë kryesore;

¹⁰ Evidenca nr. 19 - Organigrama e institucionit.

¹¹ Koment: Së fundmi Senati Akademik me vendimin nr.4, dhe nr. 2 datë 15.11.2018 ka miratuar ndryshimet në organigramën dhe statutin e institucionit, të cilët i janë përcjellur në MASR për miratim.

Funksionet dhe detyrat e tjera të dekanatit

Funksionet e dekanatit janë si më poshtë:


- a) harton planin disavjeçar të zhvillimit të njësisë kryesore;
- b) harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Rektorat dhe Senat;
- c) propozon kriteret për shpërndarjen e burimeve materiale dhe njerëzore akademike të njësisë kryesore;
- d) harton dhe propozon projektbuxhetin për njësinë kryesore;
- e) paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
- f) zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik.
- g) Funksionet e tjera të Dekanatit përcaktohen në rregulloren e tij si dhe në rregulloret e tjera të institucionit.


Mbledhjet dhe vendimmarrja e dekanatit

1. Dekanati mblidhet si rregull jo më pak se një herë në muaj. Në raste të nevojshme dekanati mund të mblidhet në çdo kohë, me kusht që të lihet kohë e mjaftueshme për shqyrtimin e materialeve që lidhen me çështjet për diskutim.
2. Mbledhja thirret nga dekani, kryesisht, apo me kërkesën e secilit prej anëtarëve të dekanatit.
3. Mbledhja konsiderohet e vlefshme, nëse marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
4. Mbledhja nuk mund të zhvillohet dhe duhet të shtyhet, në rastet kur, edhe pse është plotësuar numri i anëtarëve të nevojshëm, nuk është prezent anëtari, i cili ka lidhje të drejtpërdrejta me çështjen për të cilën do të merret vendim.
5. Si rregull, dekanati merr vendime njëzëri. Kur kjo nuk është e mundur, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rastet kur nuk mund të arrihet shumica, vota e dekanit është përcaktuese.
6. Procesverbali, i mbajtur në mbledhjen e dekanatit, përbën dokumentin bazë për pasqyrimin e vendimmarrjes.
7. Vendimet e marra nga dekanati, materializohen në formën e urdhrave të nxjerra nga dekani i njësisë kryesore.

DEKANI

Dekani është autoriteti drejtues në një fakultet të Kolegjit, i cili e përfaqëson atë dhe vepron në emër dhe për llogari të tij. Dekani është personel akademik i kategorisë "Profesor".



Funksionet dhe kompetencat e dekanit

Dekani ka këto funksione:

- a. Drejton dhe përfaqëson fakultetin;
- b. Është anëtar i Senatit;
- c. Ushtron kontrollin e ligjshmërisë mbi autoritetet drejtuese, brenda fakultetit.
- d. Nënshkruan diploma për përfundimin e programeve të studimit, që janë organizuar në Kolegjin Universitar “Bedër” dhe nuk mund ta delegojë këtë kompetencë.

Dekani ushtron edhe këto kompetenca:

- a. Propozon emrin e zëvendësdekanit për miratim në dekanat dhe e emëron atë pas miratimit;
- b. Propozon drejtuesit e njësive bazë të fakultetit përkatës;
- c. Emëron përgjegjësit e grupeve mësimore lëndore dhe ndërlëndore mbi propozimin e titullarit të njësisë bazë;
18	International Intellectual Property Law and Infringements	Bojana Hajdini	Dr.	Drejtësi	4	PAE
19	Master Thesis	Ferdinand Xhaferaj	Dr.	Drejtësi	4	PAE
20	The Law of Treaties	Ferdinand Xhaferaj/ Gentian Skara	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAE
22	International Human Rights Law	Idlir Peçi/ Gentian Skara	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAK/PAE
23	Public International Law	Ferdinand Gjana/ Bledar Maksuti	Prof. Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAK
24	Private International Law	Irvin Faniko/ Laurela Muça	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAK/PAE
25	International Investment Law	Nertil Bërdufi/ Gentjan Skara	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAE
26	E Drejta Penale Ndërkombëtare	Bojana Hajdini	Dr.	Drejtësi	4	PAE
27	Tema Specifike në Drejtësi	Ferdinand Gjana/ Ferdinand Xhaferaj	Prof. Dr./ Dr.	Drejtësi	4	PAE/PAE
28	E Drejta Penale Evropiane	Altin Shegani/ Nertil Bërdufi	Prof. Dr./ Dr.	Drejtësi	4	PAK/PAE
29	Kriminologji – Penologji e Avancuar	Nertil Bërdufi	Dr.	Drejtësi	4	PAE
30	E Drejta Penale Ndërkombëtare	Bojana Hajdini	Dr.	Drejtësi	4	PAE
31	Organizatet dhe institucionet ndërkombëtare	Ferdinand Xhaferaj	Dr.	Drejtësi	4	PAE
32	Master Thesis	Ferdinand Gjana	Prof. Dr.	Drejtësi	2	PAE
33	Master Thesis	Ferdinand Xhaferaj	Dr.	Drejtësi	2	PAE
34	Master Thesis	Nertil Bërdufi	Dr.	Drejtësi	2	PAE
35	Master Thesis	Bojana Hajdini	Dr.	Drejtësi	2	PAE

Viti akademik 2017-2018						
Lënda /Moduli		Pedagogu/Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Ngarkesa mësimore (orë)	Statusi PAE apo PAK
1	E Drejtë Penale, Pjesa e Posaçme e Avancuar	Altin Shegani/ Ermira Bushi	Prof. Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAK/PAE
2	Procedurë Penale e Avancuar me Praktikë Gjyqësore	Nertil Bërdufi/ Adnan Xholi	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAK
3	Krimi Financiar dhe Kibernetik	Nertil Bërdufi	Dr.	Drejtësi	4	PAE
4	Metoda Kërkimore	Ferdinand Xhaferaj/ Gentian Skara	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAE
5	European Union Law	Ferdinand Xhaferaj/ Gentian Skara	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAE
6	Politikat Penale	Bojana Hajdini	Dr.	Drejtësi	4	PAE
7	Kriminalistikë	Nertil Bërdufi/ Mimoza Haxhihyseni	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAK
8	Criminal Psychology	Evisa Kambellari	Prof. Assoc. Dr.	Drejtësi	4	PAK
9	Selected Topics in Law and Security	Xhavit Shala/ Aranit Qinami	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAK/PAE
10	E Drejtë Penale e Krahasuar	Nertil Bërdufi	Dr.	Drejtësi	4	PAE
11	Master Thesis	Nertil Bërdufi	Dr.	Drejtësi	2	PAE
12	Metoda Kërkimore	Ferdinand Xhaferaj/ Gentian Skara	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAE
13	History and Theory of International Law	Arjan Lame/ Ermira Shkreta	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAK/PAE
14	European Union Law	Ferdinand Xhaferaj/ Gentian Skara	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAE
15	International Organizations and Institutions	Ferdinand Xhaferaj	Dr.	Drejtësi	4	PAE
16	Legal Regulation of International Security	Ferdinand Gjana	Prof. Dr.	Drejtësi	4	PAE
17	International Relations and Legal Settlements of Disputes	Isa Erbaş	Dr.	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	4	PAE
18	International Litigation and Arbitration	Ferdinand Gjana/ Laurela Muça	Prof. Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAE
19	International Intellectual Property Law and Infringements	Bojana Hajdini	Dr.	Drejtësi	4	PAE
21	Legal Regulation of International Security	Ferdinand Gjana	Prof. Dr.	Drejtësi	4	PAE
22	International Human Rights Law	Ferdinand Gjana/ Bledar Uku	Prof. Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAE
23	Public International Law	Ferdinand Gjana/ Bledar Maksuti	Prof. Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAK
24	Private International Law	Saimir Shatku/ Laurela Muça	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAK/PAE



25	International Investment Law	Ferdinand Xhaferaj/ Gentjan Skara	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAE
26	E Drejta Penale Ndërkombëtare	Bojana Hajdini	Dr.	Drejtësi	4	PAE
27	Tema Specifike në Drejtësi	Ferdinand Gjana/ Ferdinand Xhaferaj	Prof. Dr./ Dr.	Drejtësi	4	PAE/PAE
28	E Drejta Penale Evropiane	Nertil Bërdufi	Dr.	Drejtësi	4	PAE
29	Kriminologji – Penologji e Avancuar	Nertil Bërdufi/ Ermira Bushi	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAE
30	E Drejta Penale Ndërkombëtare	Bojana Hajdini	Dr.	Drejtësi	4	PAE
31	Organizatet dhe institucionet ndërkombëtare	Ferdinand Xhaferaj	Dr.	Drejtësi	4	PAE
32	Master Thesis	Ferdinand Gjana	Prof. Dr.	Drejtësi	2	PAE
33	Master Thesis	Ferdinand Xhaferaj	Dr.	Drejtësi	2	PAE
34	Master Thesis	Nertil Bërdufi	Dr.	Drejtësi	2	PAE
35	Master Thesis	Bojana Hajdini	Dr.	Drejtësi	2	PAE

Viti akademik 2018-2019						
	Lënda /Moduli	Pedagogu/Pedagogët përgjegjës	Titulli/gradat kualifikimi	Departamenti	Ngarkesa mësimore (orë)	Statusi PAE apo PAK
1	E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme e Avancuar	Altin Shegani/ Nertil Bërdufi	Prof. Dr./ Dr.	Drejtësi	4	PAK/PAE
2	Procedurë Penale e Avancuar me Praktikë Gjyqësore	Ferdinand Gjana/ Adnan Xholi	Prof. Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAK
3	Krimi Financiar dhe Kibernetik	Nertil Bërdufi	Dr.	Drejtësi	4	PAE
4	Metoda Kërkimore	Ferdinand Xhaferaj	Dr.	Drejtësi	4	PAE
5	Politikat Penale	Bojana Hajdini	Dr.	Drejtësi	4	PAE
6	Kriminalistikë	Bojana Hajdini/ Mimoza Haxhihyseni	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAK
7	Criminal Psychology	Nertil Bërdufi	Dr.	Drejtësi	4	PAE
8	Selected Topics in Law and Security	Xhavit Shala/Ermira Bushi	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAK/PAE
9	E Drejtë Penale e Krahasuar	Nertil Bërdufi	Dr.	Drejtësi	4	PAE
10	International Relations and Legal Settlements of Disputes	Ferdinand Gjana	Prof. Dr.	Drejtësi	4	PAE
11	International Litigation and Arbitration	Saimir Shatku/ Gentjan Skara	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAK/PAE
12	International Intellectual Property Law and Infringements	Bojana Hajdini	Dr.	Drejtësi	4	PAE
13	Viktimologji	Arjan Lame/ Ermira Shkreta	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAK/PAE
14	The Law of Treaties	Ferdinand Xhaferaj/ Gentjan Skara	Dr./ Msc.	Drejtësi	4	PAE/PAE
15	Master Thesis	Ferdinand Gjana	Prof. Dr.	Drejtësi	2	PAE
16	Master Thesis	Nertil Bërdufi	Dr.	Drejtësi	2	PAE
17	Master Thesis	Bojana Hajdini	Dr.	Drejtësi	2	PAE

Syllabuset për çdo lëndë, nëse janë të pasqyruara këto elementë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetësimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

 Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset janë të organizuara në përputhje të plotë me udhëzimet e nxjerra nga minsitria përgjegjëse për arsimin në RSH. Ato janë të ndara në disa nëndarje kryesore ku përfshihet emri i lëndës, grupi, ECTS, orët, pedagogu titullar dhe asistenti, përshkrimi i lëndës, objektivat kryesore, programi i Lëndës së bashku me literaturën përkatëse, rezultatet e lëndës dhe kompetencat, mënyra e vlerësimit të lëndës si dhe ngarkesa ECTS (Në bazë të ngarkesës së studentit). Mënyra e organizimit dhe ndarjes së syllabuseve u mundëson pedagogëve liri akademike për përcaktimin e temave dhe organizimin e lëndës. Në fillim të çdo viti akademik, njësia bazë nxit përditësimin dhe rishikimin e syllabuseve. Syllabuset janë transparente në sistemin BIS si dhe në websitin e KUB duke u ofruar studentëve mundësi për të kontrolluar gjithashtu edhe syllabuset ndër vite.

 Dokumentacioni përkatës⁵⁷⁵⁸

⁵⁷ Evidenca nr. 39 - Lista e plotë e syllabuseve të programit Master i Shkencave në Drejtësi me profile: E drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare


⁵⁸ Evidenca nr. 40 – Cv e stafit akademik






Emri i Lëndës : Kriminalistikë							
Kodi	Tipi i lëndës	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 533	C	3	4	0	0	4.00	6
Lektori dhe orari i konsultimeve			Bojana Hajdini, PhD				
Asistenti dhe orari i konsultimeve			Mimoza Haxhihyseni, MA				
Gjuha e kursit			Shqip				
Nivell i lëndës			Master				
Përshkrimi			Shkenca e kriminalistikës merret me studimin dhe përpunimin, në bazë të ligjit penal dhe procedural penal, të metodave e mjeteve teknike, taktike dhe të rekomandimeve metodike për kërkimin, gjetjen, fiksimin, kqyrjen dhe vlerësimin e provave me qëllim zbulimin, hetimim, gjykimin dhe parandalimin e veprave penale				
Objektivat			Të njohë studentin me detyrat, objektin dhe sistemin e kriminalistikës, se çfarë vendi përshin ajo në sistemin e shkencave juridike penale, se cilat janë bazat metodologjike të kriminalistikës dhe mbi parimet kryesore që udhëheqin shkencën e kriminalistikës. Kqyrjen e Vendit të Ngjarjes, si veprim hetimor me anë të së cilit organi procedues percepton drejtpërdrejt mjedisin ku ka ndodhur ngjarja, zbulon, mbledh e fikson gjurmë e prova materiale dhe sqaron rrethana që kanë rëndësi për çështjen. Të pajisë studentin me njohuri të plota mbi : Kërkimin, fiksimin, paketimin, administrimin dhe ruajtjen e provave me natyrë biologjike në vendin e ngjarjes, në funksion të Analizës së ADN-së dhe Metodikat e marrjes së këtyre provave dhe kampioneve model krahasimi.				
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Shkenca kriminalistike dhe roli i saj :Detyra, objekti dhe sistemi i kriminalistikës. Vendi i kriminalistikës në sistemin e shkencave juridike penale Bazat metodologjike të kriminalistikës. Parimet e kriminalistikës						
2	Identifikimi kriminalistik. Kuptimi i identifikimit kriminalistik. Bazat shkencore të identifikimit kriminalistik henjat identifikuese. Përkatesia grupore dhe identifikimi kriminalistik. Objektet e identifikimit kriminalistik						
3	Kqyrja e vendit të ngjarjes:Kuptimi dhe detyrat e kqyrjes së vendit të ngjarjes. Përgatitja për kqyrjen e vendit të ngjarjes. Metodatat taktike te kqyrjes se vendit te ngjarjes. Ngritja dhe verifikimi i versjoneve hetimore në kqyrjen e vendit të ngjarjes. Mjetet teknike kriminalistike për kërkimin dhe zbulimin e provës						
4	Kqyrja e vendit të ngjarjes në vrasje dhe përdhunime: Nocioni juridik i vrasjes.Veçoritë e kqyrjes së vendit të ngjarjes në vrasje. Rëndësia e versioneve hetimore dhe verifikimi i tyre.						
5	Zbulimi i gjurmëve të duarve në vendin e ngjarjes. Sistemi i gjurmëve papilare. Metodatat kimike të zbulimit të gjurmëve të duarve						
6	Daktiloskopia si shkencë dhe rëndësia e saj. Informatizimi i gjurmëve të duarve. Ndërtimi i figurës papilare, karakteristikat e përgjithshme dhe ato të veçanta. Mekanizmi i formimit të gjurmëve të duarve. Ekzaminimi i gjurmëve të duarve – identifikimi. Kartoteka daktiloskopike dhe funksionet e saj						
7	Traseologjia. Mekanizmi i formimit të gjurmëve traseologjike dhe klasifikimi i tyre. Rregullat e përgjithshme të zbulimit, të fiksimit dhe të marrjes së gjurmëve traseologjik						
8	Provim Gjysmëfinal						
9	Balistika kriminalistike. Llojet e armëve të zjarrit. Metodatat e zbulimit, fiksimit të armëve, predhës dhe gjurmëve të tjera. Armët e ftohta pa teh. Metodatat e zbulimit, fiksimit dhe ekzaminimit të armëve të ftohta.						
10	Ekzaminimi kriminalistik i dokumentave - Provë materiale. Rëndësia dhe llojet e ekzaminimit kriminalistik të dokumentave. Metodatat e falsifikimit të pjesshëm. Ekzaminimi i teksteve të mbuluara me njolla ,të djegura dhe të grisura- Falsifikimi i dokumentave me anë të kompjuterit. Prova meteriale. Çështje që shtrohen për zgjidhje prej organit procedues kur kryhet ekzaminimi i dokumentave.						

11	Shkencat ligjore. Njohuri të përgjithshme mbi AND, rëndësia e saj identifikuese. Metodat e zbulimit, marrjes dhe ekzaminimit të materialeve që përmbajnë ADN. Kimia ligjore. Përdorimi i analizave kimike në kriminalistikë		
12	Taktika kriminalistike. Kuptimi dhe detyrat e kqyrjes së vendit të ngjarjes. Përgatitja për kqyrjen e vendit të ngjarjes. Ngritja dhe verifikimi i versioneve hetimore. Metodat kriminalistike për fiksimin e rezultateve të kqyrjes së vendit të ngjarjes.		
13	Kontrolli. Përgatitja për kontrollin		
14	Taktika e pyetjes. Kuptimi dhe rëndësia e pyetjes. Bazat psikologjike në pyetje dhe metodat taktike. Taktika e pyetjes së dëshmitarit		
15	Metodat Kriminalistike. Njohuri të përgjithshme		
16	Provim Final		
Parakushtet			
Literatura	<ul style="list-style-type: none"> • Begeja, Skënder. Kriminalistika. Tiranë 2004 • Begeja, Skënder. Mandro, Ilir. Kqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri. Tiranë: Ilir, 2002 • Ikonomi, Vladimir. Metoda moderne në ekspertimin kriminalistik. Tiranë: Geer, 2006 • Mandro, Ilir. Ciraku, Agim. Metodika e hetimit të ngjarjeve automobilistike. Tiranë: Pegi, 2003 • Mandro, Ilir. Në labirinthe e balistikës kriminalistike. Tiranë: 2004 • Sallavaci. O. Identifikimi i personit në bazë të AND-së, Tiranë 2004 		
Referenca të tjera	<ul style="list-style-type: none"> • Mandro, Ilir. Identifikimi i armëve me anë të shenjave karakteristike në gëzhgjë. Revista Tribuna Juridike, Nr. 32, 2001 • Mandro, Ilir. Njohuri për kriminalistikën. Tiranë: Emal, 2011 		
Punë laboratoril	0		
Përdorimi i komp.	0		
Të tjera	0		
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat			
1	Pas përfundimit me sukses të këtij kursi pjesëmarrësit do të kenë një formim të përgjithshëm të ekspertit kriminalist të vendit të ngjarjes		
2	Studentet do të mund të kryejnë në të ardhmen dhe detyren e ekspertit kriminalist në vendet përkatëse të punës		
Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme			
	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kulze	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laboratoril	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	30	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		70	
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		30	
Total		100	
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)










Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)			
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)			
Detyra			
Gjysmë finale			
Provimi final			
Të tjera			
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6
ECTS			6

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1. Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2. Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Kriteri 1: Studimet organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi zhvillohet në përputhje me programin e licensuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Kriteri 2: Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program “Master i shkencave” në Drejtësi me kohë të plotë është 60 kredite. Kjo vërtetohet edhe nga programet e licencuara nga MASR dhe të shprehura në kurrikulën e programit, si edhe në Statutin e KUB.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3. Programet e studimeve “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5. Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p>	<p>Kriteri 2: Sipas rregullores mbi studimet e ciklit të dytë programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave”, i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional.</p> <p>Kriteri 3: Siç u përmend edhe më sipër, programet e studimeve “Master i shkencave” të ofruara nga departamenti i Drejtësisë synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve. Kjo shprehet si në Rregulloren e Studimeve të Ciklit të Dytë, ashtu edhe në objektivat e programit mësimor.</p> <p>Kriteri 4: KUB, nuk përfshin programe studimi të ciklit të dytë të integruara në fushat e mjekësisë, stomatologjisë, farmacisë, veterinarisë, arkitekturës.</p> <p>Kriteri 5: Siç vihet re edhe në kurrikulat e programit, bashkëngjitur me këtë raport, programet e studimit të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij. Ato shprehen qartë në syllabuset e çdo lënde.</p>

Kriteri 6. Programet e studimeve “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;

Kriteri 7. Programet e studimeve “Master profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteri 6: Programi “Master i shkencave” në Drejtësi dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoraturës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve për pranimin në ciklin e tretë të studimeve. Ky program studimi përfshin jo vetëm lëndë me karakter profesional, por edhe me karakter kërkimor-shkencor, si metodat kërkimore, apo teza, e cila është e barazvlefshme me 30 ECTS dhe zë një semestër akademik.

Kriteri 7: Departamenti i Drejtësisë në Kolegjin Universitar “Bedër” nuk përfshin në programe studimi të ciklit të dytë “Masterin profesional”.

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

Kriteri 1. Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;

Kriteri 2. Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.

Kriteri 1: E vërtetuar kjo në kurrikulë dhe në syllabuset e lëndëve përkatëse, vihet re se përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato.

Kriteri 2: Metodatat e vlerësimit shprehen qartazi në syllabuset e çdo lënde, ndërkohë që çdo pedagog është i lirë të organizojë vlerësimin në përqindje të ndryshme të këtyre zërave. Zërat e vlerësimit të përcaktuara janë: gjysmëfinale, kuize, projekte, projekte semestrale, pjesëmarrje në mësim dhe provimi final.

Secili pedagog i prezanton studentëve që në javën e parë të leksioneve, mënyrë dhe zërat e vlerësimit që ka përcaktuar në syllabus, si dhe objektivat që synon lënda. Kjo praktikë siguron një nivel të lartë të transparencës së vlerësimit për studentët dhe i ndihmon ata që të kuptojnë më mirë objektivat, zërat e vlerësimit dhe aspektet e tjera të ecurisë së lëndës.



Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.


Kriteri 1. Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;

Kriteri 2. Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomatat që jepen në

Kriteri 1: Në hartimin e kurrikulave, stafi i angazhuar ka studiuar dhe analizuar kurrikulat e universiteteve me përvojë të gjatë në këtë fushë, duke i përshtatur ato me kushtet e tregut të punës në Shqipëri.

Kriteri 2: Siç vihet re edhe në syllabuset e çdo lënde dhe kurrikulat në përgjithësi, programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese, si nga ana teknike, (kredite evropiane, kredite amerikane, metoda vlerësimi), ashtu edhe nga ana e përmbajtjes (plani mësimor, literaturë etj.) Studentët e diplomuar në këtë program kanë aplikuar për diploma pas universitare në universitetet më të mira Evropiane dhe anglo-saksone dhe kanë përfituar bursa studimi.



<p>përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3. Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Kriteri 3: Programet e studimit në ciklin e dytë janë hartuar në përputhje të plotë me Kartën e Bolonjës dhe kërkesat e saj. Këto programe janë në përputhje të plotë dhe me objektivat që përcakton legjislacioni dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë.</p>
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2. Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3. Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Kriteri 1: Programi mësimor i programeve të ciklit të dytë, përveç anës teorike dhe angazhimit në çdo lëndë në punë kërkimore, përfshin gjithashtu edhe përgatitjen e tezës, e rëndësishme kjo për zhvillimin individual të studentit në fushën e kërkimit shkencor.</p> <p>Kriteri 2: Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me profilin e KUB dhe strategjinë e tij për zhvillim. I fokusuar kryesisht në fushën e shkencave humane, programet e ciklit të dytë synojnë të plotësojnë dhe të përmbushin misionin institucional.</p> <p>Kriteri 3: Parë edhe nga angazhimi i personelit akademik në pjesëmarrjet në konferencat e organizuara brenda dhe jashtë institucionit, si dhe në orët që përcaktojnë ngarkesën e punës për zëra të ndryshëm, vihet re ndarja e kohës së nevojshme për gjithsecilin për angazhim në kërkimet shkencore.</p> <p>Kriteri 4: Gjatë përzgjedhjes së personelit akademik të angazhuar në programet e ciklit të dytë, KUB i kushton rëndësi të veçantë përputhjes së interesave dhe kompetencave profesionale të tij që të përputhen me programin e studimit. Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Kriteri 1: KUB, në çeljen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, bazohet në nevojat e tregut. Ato janë vijimësi e programeve të ciklit të parë, të çelura me të njëjtën logjikë. Përsa i përket Departamentit të Drejtësisë në KUB, ky i fundit nuk përfshin programe studimi të ciklit të dytë “Master Profesional”.</p> <p>Kriteri 2: Sic u përmend dhe mësipër Departamentit të Drejtësisë në KUB nuk përfshin programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” por programi e ciklit të dytë “Master i shkencave”, që Departamenti i Drejtësisë ofron, synon të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	

<p>Kriteri 1. Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2. Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Kriteri 1: KUB, duke analizuar edhe nevojat e tregut, ka hartuar këto programe në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar. Gjatë 6 viteve të fundit Departamenti ka realizuar dy analiza me aktorë të ndryshëm për të marrë parasysh nevojat e tregut të punës.</p> <p>Kriteri 2: KUB ka kryer një studim të nevojave të tregut të punës në lidhje me programet që ofron, i paraqitur ky në momentin e licencimit pranë MASR, gjithashtu në vitin 2015 ka kryer dhe studimin e fundit të tregut ku bazuar mbi të si dhe aktet ligjore në fuqi ka dorëzuar në ministrin e arsimit dhe kërkesën për riorganizimin e Bachelorit në program të integruara të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë me 300 ECTS dhe 5 vite akademike.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Kriteri 1: Duke mos rënë ndesh me interesat kombëtare, politikat dhe programet e ofruara nga KUB, janë hartuar në përputhje me politikat kombëtare të parashikuara në planin strategjik mbi arsimin e lartë të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</p> <p>Kriteri 2: Programet e studimeve ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare si dhe synojnë promovimin e kulturës dhe të traditës shqiptare te studentët e huaj që vijnë nga 16 vende të ndryshme të botës.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve “Master i shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Kriteri 1: Programi i studimit në shqyrtim “Master i shkencave” në drejtësi realizohet me 120 ECTS, ai zgjat dy vite akademike me nga dy semestra. Secili semestër ka 30 ECTS dhe 30 ECTS e semestrit të katërt i përkasin tezës.</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1. Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p>	<p>Kriteri 1: Informacioni i ofruar për programet e studimit është e detajuar dhe i publikuar në faqen e departamentit. Gjithashtu në orën e parë të mësimin lektorët i bëjnë të ditur këto informacion për të gjithë studentët. Informacioni jepet i plote dhe i detajuar duke e bërë lehtësisht të përdorshëm për të gjithë studentët. Studentët mund të vërejnë edhe ndryshimet që bëhen në syllabuse për çdo vit, pasi në faqen e institucionit mund të aksesohen edhe syllabuset pararendëse.</p>

<p>Kriteri 2. Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Kriteri 2: Sikur u përmend më lart, përveç faqes së internetit (law.beder.edu.al), informacioni u jepet studentëve edhe nga lektorët përkatës. Krahas faqes së internetit studentët aktuale por edhe kandidatët për studentë kanë mundësi të marrin informacion rreth programeve të studimit, moduleve, objektivave të studimit, mundësive të punësimit edhe nga materialet promocionale të përgatitura nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun në bashkëpunim me departamentet. Një tjetër hapësirë për të marrë informacion, janë edhe llogaritë zyrtare të KUB dhe Departamentit të Drejtësisë në rrjetet sociale, si Facebook, Twitter, Intagram, etj.</p>
--	---

Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.

<p>Kriteri 1. Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2. Për realizimin e programeve të studimeve “Master i shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Kriteri 1: Në Rregulloren e programit të studimit “Master i shkencave” në Drejtësi shprehet mënyra e diplomimit të studentit brenda afateve të parashikuara. Pasi studenti t’i ketë shlyer të gjithë lëndët, ka të drejtë që të marrë tezën, dhe pas përfundimit të punimit të tezës, me vendim departamenti i caktohet data e mbrojtjes, ku më pas në varësi të performancës së punës së bërë vlerësohet, njëkohësisht i jepen sugjerime dhe kritika të cilat studenti duhet t’i marrë në konsideratë për t’i ndryshuar brenda afatit të përcaktuar. Për ndryshime të vogla studentit i jepet nje periudhe dy javore. Pasi bëhen ndryshimet e duhura studenti dorëzon kopjet finale të tezave bashkangjitur me tre kopjet e CD-ve si dhe dy fotove. Procedura vijon ne propozimin e departamentit në fakultet për diplomimin e studentit pasi ai i përmbush të gjitha kriteret e diplomimit, dhe nga fakulteti propozimi për diplomim dërgohet në Sekretarinë Mësimore e cila ja dërgon për miratimin final Senatiti .</p> <p>Kriteri 2: Siç vërehet edhe nga kurrikula e këtij programi studimi dhe rregullorja e tij, teza e planifikuar në semestrin e katërt është e barazvlefshme me 30 ECTS.</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Pas informacionit të mbledhur dhe vlerësimit të tij, GVB shqyrtoi programet e studimit që Kolegji Universitar “Bedër” ofron: Studimet në programin “Master i shkencave” në Drejtësi në profilet: a. *E Drejtë Penale*; b. *E Drejtë Ndërkombëtare* organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS), programi studimit me kohë të plotë është 120 kredite. “Master i shkencave” i ofruar nga departamenti i Drejtësisë synon të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve, i cili i pajis studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij. Programet janë hartuar në përputhje me politikat kombëtare të parashikuara në planin strategjik mbi arsimin e lartë të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë kanë për synim kryesor rritjen e numrit të studentëve ndërkombëtarë për të promovuar kulturën dhe traditën shqiptare dhe më gjerë, ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve, synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare, përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor, marrin parasysh nevojat e tregut të punës. Studimet e ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi, institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve. KUB konstaton se në këtë institucion programet e studimit janë në përputhshmëri të plotë me standardet dhe kriteret e kërkuara nga aktet ligjore dhe nën ligjore të Republikës së Shqipërisë. GVB konstaton se programi në fjalë i **përmbush plotësisht** kriteret e kërkuara.

8- Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësive etj.

Institucioni merr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së planit mësimor për çdo program. Në çdo fillim semestri miratohen ngarkesat mësimore, shpërndarja e lëndëve, mbledhja e dokumentacionit përkatës për çdo lëndë, plotësimi i programeve mësimore (syllabuseve) etj. Ky proces, në periudha të ndryshme të vitit, auditohet edhe nga një grup pune i emëruar me urdhër nga rektori. Çështjet në lidhje me organizimin e mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësive shpjegohen në Rregulloren e Studimeve të ciklit të dytë si dhe në rregulloren e këtij programi, bashkëngjitur këtij raport. ⁵⁹

Organizimi i mësimdhënies

Procesi i arsimit përbëhet nga leksionet, projektet dhe puna në studio, punimet në laborator dhe atelie, praktikat, punimet në terren, seminare, punimi i diplomimit dhe punime të tjera të ngjashme, të parashikuara në programin mësimor.

Ngarkesa mësimore

Shpërndarja e ngarkesës mësimore është bërë konform udhëzimeve të marra nga Ministria Arsimit dhe Shkencës, në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë si dhe udhëzimet respektive të MASR. KUB i kushton një rëndësi të veçantë përzgjedhjes së stafit akademik, duke synuar përputhjen e interesave të tyre me programet që ofrohen. Duke plotësuar të gjitha standardet e parashikuara në legjislacionin shqiptar në lidhje me numrin e personelit akademik për çdo departament, KUB ka punësuar edhe personel me kohë të pjesshme, i cili angazhohet në disa fusha të veçanta. Nga ana tjetër, përqindja e programeve të mbuluara nga personeli me kohë të plotë është rritur në mënyrë të ndjeshme këto vitet e fundit akademike.

Cilësia e mësimdhënies

Departamenti, në bazë të kurikulës, i paraqet çdo anëtar të stafit akademik formatin bazë të syllabus-it të përdorur nga institucioni, ku përfshihen të gjitha detajet në lidhje me mbarëvajtjen e zhvillimit të lëndës. Pedagogu propozon brendinë apo ndryshimet e mundshme në syllabus, ku përfshihen në mënyrë të detajuar për secilën lëndë: qëllimi i lëndës, objektivat, bibliografia e detyrueshme, bibliografinë e rekomanduar etj. Pedagogu i çdo lënde e ka të detyrueshme që të përgatitë ‘dosjen e lëndës’ e cila përfshin të gjitha materialet dhe leksionet e shjeguara gjatë semestrit, si një kopje shembull të provimeve të zhvilluara, një kopje të provimit më të mirë dhe më të dobët etj.

Provimet organizohen referuar dispozitave të rregulloreve të institucionit dhe rregullave mbi organizimin e provimeve. ⁶⁰ Departamenti analizon të dhënat e anketimeve të zhvilluara me studentë për përmirësim të kurrikulës dhe të stafit akademik.

⁵⁹ Evidenca nr. 6 - Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë

⁶⁰ Evidenca nr. 48 - Rregulla mbi organizimin e provimeve

Tregues të matshëm:

- Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies

Tabela 17: Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies

Programi i Studimit “Master i shkencave” në Drejtësi profili E Drejtë Penale		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	928
b.	Seminare	32
c.	Ushtrime	-
d.	Laboratore	-
e.	Praktikë lëndore	-
f.	Praktikë profesionale	-
g.	Etj	64
Në total		1024

- Format e kontrollit të njohurive

Tabela 18: Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	10%
Testimet gjatë vitit	30%
Provimi përfundimtar	50%
Etj	-
Në total	100%

Organizimi i veprimtarisë së mësimdhënies dhe vlerësimit të njohurive të studentëve në fakultetet dhe departamentet e Kolegjit Universitar “Bedër” bëhet duke u mbështetur në syllabusin e lëndës. Lektori i lëndës ka të drejtën e ndryshimit të syllabusit dhe komponentëve të vlerësimit. Duke respektuar parimet e lirisë dhe autonomisë së pedagogut, Kolegji Universitar “Bedër” përcakton mënyrat dhe format e kontrollit duke lënë peshën e tyre në dorë të lektorit. Në këtë kuadër, format e kontrollit përcaktohen në brendinë e syllabus-it përkatës për çdo lëndë, të cilat gjenden bashkëngjitur këtij raporti.

Kryesisht, nota përfundimtare e çdo lënde synohet të jetë e përbërë nga disa zëra, siç janë kolegiumi, pjesëmarrja në klasë, detyra apo projekte, provimi final etj, secili prej tyre me një ngarkesë të vendosur më parë. Format e kontrollit dhe formula e vlerësimit të studentëve për çdo lëndë është prezantuar në plan-programin e secilës lëndë. Në fillim të çdo semestri pedagogët u bëjnë të ditur studentëve modelin dhe formulën e zgjedhur për vlerësimin e njohurive të tyre përgjatë semestrit dhe në fund të tij.

Në përgjithësi provimi final zë përqindjen më të madhe të notës përfundimtare. Tezat e provimit formulohen nga titullari i lëndës sipas një formati të përcaktuar nga Institucioni.⁶¹ Për efekt të objektivitetit të vlerësimit, forma e kontrollit të programeve të studimit të fakultetit bëhet përgjithësisht me shkrim.

⁶¹ Evidenca nr. 45 - Format provimi

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Tabela 19: Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	40
Për projekte shkencore në nivel Departamenti	70
Për projekte shkencore në nivel Fakulteti	40
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	35

9- Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

KUB është një institucion që krahas kritereve ligjore të përcaktuara nga MASR ka vendosur dhe kritere të tjera në pranimin e studentëve. Varësisht politikave institucionale si një institucion jofitimprurës, KUB ka pranuar një numër të kufizuar studentësh, në përputhje me infrastrukturën fizike dhe të burimeve njerëzore që zotëron. Përmes kësaj politike, KUB ka synuar angazhimin maksimal të ekipit ndaj studentit, duke respektuar të gjitha kriteret e kërkuara në këtë drejtim.

Përmes faqes së internetit, broshurave, takimeve të drejtpërdrejta, panairëve etj., KUB bën publike ofertën vjetore të programeve që ofron.

Në kuadër të këshillimit të karrierës, përkrah aktiviteteve të mësipërme, KUB organizon edhe ditët e hapura, apo edhe ditët e orientimit për studentët e rinj⁶². Procedurat e pranimit të studentëve për çdo vit akademik, si edhe kuotat për çdo program studimi, së bashku me kriteret e pranimit, i dërgohen Ministrisë përkatëse, si edhe i bën publike përmes faqes së internetit. Varësisht afateve të përcaktuara nga agjencitë shtetërore, KUB mban lidhje të ngushta me Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe përmes lejeve të siguruara prej tyre viziton shkollat e mesme në qytete dhe qendra të ndryshme të vendit. Përmes kësaj praktike, maturanët e këtyre shkollave njihen me ofertën akademike të KUB.

Për pritjen dhe shpjegimin e ofertës akademike, KUB ka ngritur Drejtorinë e Marrdhënieve me Studentët. Me qëllim realizimin e një procesi mësimor sa më rezultativ, KUB i kushton një rëndësi të veçantë raportit numerik personel akademik/student, i cili siguron edukimin cilësor dhe objektivat e institucionit. Raporti në fjalë është 1 (një) personel akademik për 8.03 studentë në rang institucional.

Kushtet për pranim të studentëve dhe procedurat e përzgjedhjes

Pranimi i studentëve të rinj në programet e ciklit të dytë që ofrohen nga KUB, deri në vitin 2015 janë bërë sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, procedurat për pranimin e studentëve të ciklit të parë janë ndryshuar në përputhje me të.

Pranohen për t’u regjistruar në programin e studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave” shtetasit shqiptarë dhe të huaj që plotësojnë këto kushte:

- vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e studimeve të ciklit të parë me gradën Bachelor në Shqipëri ose jashtë shtetit (ekuivalentuar sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës);
- plotësojnë kushtet e tjera të pranimit të përcaktuara në rregulloren e brendshme të KUB;

⁶² Evidenca nr. 41 - Programi i ditëve të orientimit

Numri i pranimeve bazohet në mundësitë reale të fakultetit për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga MASR. Përzgjedhja e kandidatëve në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve bëhet nga Komisioni *ad-hoc* i ngritur me vendim të këshillit të departamentit.

Mënyra e organizimit të programeve mësimore lejon transparencë dhe lehtësi për t'i kuptuar ato, pasi strukturimi i tyre bëhet varësisht kritereve të përcaktuara nga Karta e Bolonjës. Programet janë të detajuara dhe të vlerësuara në kredite evropiane, sipas "Sistemit evropian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve (ECTS)". E gjithë përmbajtja e programeve është e arritshme përmes faqes së internetit si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë angleze. Me qëllim për të garantuar një komunikim sa më të shpejtë midis institucionit dhe studentit, KUB ndjek politikë mbështetëse për studentët, nëpërmjet veprimtarive të orientimit dhe të kujdestarisë.

Sekretaria mësimore, si dhe sekretaria e departamentit, në çdo kat bën afishimet e njoftimeve të ndryshme në tabelat e vendosura, bën njoftime edhe me anë të postës elektronike në adresat personale që kanë studentët të ofruara nga zyra e IT në KUB.

Në momentin e nënshkrimit të kontratës, zyra e IT-së pajis me një adresë institucionale të gjithë studentët e regjistruar. Në lidhje me njoftimet për studentët e regjistruar, apo edhe për ata të rinj që shprehin interes, KUB përdor faqen zyrtare të internetit, si edhe profilet në rrjetet sociale, si mjete të rëndësishëm të komunikimit të jashtëm.

Studentët e regjistruar në KUB informohen në kohë reale përmes sistemit BIS, i cili funksionin në bazë të udhëzuesit të Sistemit Informativ Bedër (BIS) ⁶³, ku në ekranin e gjithësecilit shfaqet njoftimi përkatës. Komunikimi i brendshëm në KUB kryhet nëpërmjet sekretarive të ngritura pranë njësive bazë dhe njësive kryesore. Personeli i institucionit ka një adresë elektronike të brendshme. Zyra e IT-së pajis çdo anëtar të personelit me adresë poste elektronike të formës: Shkronjë e parë e *emrit mbiemër@beder.edu.al*.

Në përmbushje të kërkesave të përcaktuara nga MASR, që në momentin e regjistrimit, KUB plotëson dosjen personale të çdo studenti konform rregullave ligjore. Dosjet në fjalë mbahen në zyrën e sekretarisë mësimore. Një hap pozitiv është bërë përpara i përket pjesëmarrjes së studentëve si të ftuar në mbledhjet e njësive bazë dhe kryesore.⁶⁴ Po ashtu në Senatin Akademik, në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm Cilësisë si dhe në komisionet e përhershme, studentët janë anëtarë me të drejta të plota.


KUB ndjek politikë mbështetëse për të gjithë studentët pa dallim race, ngjyre, kombësie, besimi fetar etj. Për studentët romë dhe ballkano-egjiptianë ofrohen mundësi të barabarta me të tjerët, si edhe në raste të ndryshme, strukturat e ngritura për mundësimin e bursave të studimit, mund të akordojnë të tilla bursa për këto grupe. KUB mbështet të gjithë ata studentë që në fusha të ndryshme kanë treguar aftësi të veçanta dhe kanë fituar çmime. Angazhimi në aktivitete sportive të niveleve të larta mbështetet dhe nxitet institucionalisht. Bursat e dhëna për grupe nivelesh të caktuara, për persona me aftësi të kufizuar, për persona me fatkeqësi familjare, për fëmijët e dëshmorëve të policisë si dhe për disa kategori të tjera, si punonjësit e Ministrisë së Brendshme etj.

Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për të siguruar cilësinë e jetës studentore

Për të siguruar cilësinë e jetës studentore, një rol të rëndësishëm luan Drejtoria e Marrëdhënieve me Studentët. Njësitë në varësi të drejtorisë angazhohen në organizimin e aktiviteteve të ndryshme sociale dhe kulturore. Këto aktivitete shpesh organizohen në kuadër të

⁶³ Evidenca nr. 14 - Udhëzuesi i Sistemit Informativ Bedër (BIS)

⁶⁴ Evidenca nr. 35 - Vendimi i Senatit për përfshirjen e studentëve në mbledhjet e njësive bazë dhe kryesore



klubeve studentore. Për garantimin e sigurisë së studentit, institucioni ka kontraktuar kompani të sigurimit fizik, përfaqësuesit e të cilave ndodhen 24 orë në mjediset e KUB.

Nga ana tjetër, për përkujdesjen shëndetësore, përveç pranisë së mjekut pranë institucionit, KUB ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Spitalin Amerikan, i cili ofron zbritje të tarifave për shërbimet mjekësore të studentëve dhe të personelit.

Në kuadër të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentët është çelur Zyra e të Diplomuarëve si dhe Zyra e Planifikimit të Karrierës, përgjegjësitë e së cilës parashikohen në Rregulloren e Organizimit Administrativ.⁶⁵ KUB nëpërmjet praktikave profesionale gjatë gjithë vitit dhe marrëveshjeve të nënshkruara me kompani të ndryshme, mundëson një tranzicion të lehtë në punësim. Nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Karrierës, personeli akademik, ai ndihmës mësimit-shkencor dhe personeli administrativ angazhohen për zbatimin e politikës së punësimit të studentëve.

Në politikat e KUB parashikohen politika favorizuese për punësimin e të diplomuarëve të vet. Ndër vite janë punësuar mbi 45 të diplomuar pranë institucionit. Në Departamentin e Drejtësisë janë punësuar 3 persona si staf akademik. Institucioni nëpërmjet këtyre zyrave ka statistika të sakta në lidhje me të diplomuarit e saj.

Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat e pranimit të studentëve për çdo vit akademik, si edhe kuotat për çdo program studimi, së bashku me kriteret e pranimit, i dërgohen ministrisë përkatëse të arsimit, si edhe bëhen publike përmes faqes së internetit.⁶⁶ Varësisht afateve të përcaktuara nga agjencitë shtetërore, KUB mban lidhje të ngushta me drejtoritë arsimore rajonale dhe, përmes lejeve të siguruara prej tyre, viziton shkollat e mesme në qytete dhe qendra të ndryshme të vendit. Përmes kësaj praktike, maturantët e këtyre shkollave njihen me ofertën akademike të KUB. Studentët, të cilët zotërojnë diplomë “Bachelor” ose një diplomë ekuivalente me të në një nga fushat e përafërta me programet “Bachelor”, që ofrohen nga Fakulteti i Shkencave Humane, mund të aplikojnë për studime të ciklit të dytë “Master i shkencave” në një programet tona.

- Kushte specifike të pranimit të studentëve


Studentët pranohen pranë Kolegjit Universitar “Bedër” në programet e ciklit të dytë në bazë të kriterëve të mëposhtëme:


1. Mesatarja e studimeve të ciklit të parë, në masën 70%.
2. Intervista nga komiteti shkencor i departamentit përkatës, në masën 30%.
3. Përshtatmëria e programit të studimit pararendës me atë për të cilin aplikon, sipas përcaktimit të bërë në rregulloret specifike të programeve të ciklit të dytë.
4. Plotësimi i kushtit të mbrojtjes së një prej pesë gjuhëve të huaja në nivelin B1, sipas përcaktimit në udhëzimin nr.52, datë 3.12.2015.

Bazuar në pikën 4 të nenit 76 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, si kriter pranimi në një program studimi të

⁶⁵Evidenca nr. 5 - Rregullorja mbi Organizimin Administrativ

⁶⁶ Shih: <https://admission.beder.edu.al/#admission>





ciklit të dytë “Master i shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në nivelin B1.

Programi përcakton dhe ndjek afatet e aplikimit dhe regjistrimit në përputhshmëri të plotë me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për Arsimin.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Tabela 20: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve
“Master i shkencave” në Drejtësi/ Profili *E Drejtë Ndërkombëtare*

Sipas Viteve	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar sipas viteve (b)						Totali i Studenteve të transferuar (b)	Totali (a)+(b)
			Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V	Viti VI		
2013-2014	1	2.66	-	-	-	-	-	-	-	1
2014-2015	7	3.22	-	-	-	-	-	-	-	7
2015-2016	6	2.98	-	-	-	-	-	-	-	6
2016-2017	7	3.57	-	-	-	-	-	-	-	7
2017-2018	8	3.25	-	-	-	-	-	-	-	8
2018-2019	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali	29	3.13	-	-	-	-	-	-	-	29

“Master i shkencave” në Drejtësi/ Profili *E Drejtë Penale*

Sipas Viteve	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar sipas viteve (b)						Totali i Studenteve të transferuar (b)	Totali (a)+(b)
			Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V	Viti VI		
2013-2014	3	3.12	-	-	-	-	-	-	-	3
2014-2015	31	3.21	-	2	-	-	-	-	2	33
2015-2016	6	3.08	-	-	-	-	-	-	-	6
2016-2017	7	2.95	-	-	-	-	-	-	-	7
2017-2018	16	2.54	-	-	-	-	-	-	-	16
2018-2019	10	2.49	-	-	-	-	-	-	-	10
Totali	73	2.89	-	2	-	-	-	-	2	75


- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Kolegji Universitar “Bedër” ofron mundësi shkëmbimi për stafin akademik dhe studentët në bazë të marrëveshjeve me universitete brenda dhe jashtë vendit. Studentët e regjistruar në programin Master i Shkencave në Drejtësi, me profilet: E drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, për shkak të profilizimit dhe legjislacionit të ndryshëm edhe pse janë hapur thirrje për programe shkëmbimi nga Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare me universitet perëndimore nuk kanë shfaqur interes për pjesëmarrje në programe shkëmbimi. Megjithatë, KUB i ka kushtura rëndësi mobilitetit dhe ndër vite ka pasur shkëmbime stafi dhe studentësh. Në këtë kuadër, një grup studentësh nga programet që ofron Departamenti i Drejtësisë kanë marrë pjesë në programe të tilla si JESSUP në Washington DC, ICC Moot Court në Hagë, Hollandë, etj. Pjesëmarrja në këto programe ka qenë e përvitshme, duke u mundësuar studentëve eksperiencë ndërkombëtare me studentë nga vende dhe kultura të ndryshme. Studentët në këto programe janë shoqëruar edhe nga anëtarë të stafit akademik, të cilët paraprakisht kanë asistuar një trajnimet e tyre.

Diferencat e programeve të drejtësisë krahasuar me vendet e tjera kanë bërë që studentët të mos shfaqin interes për programe të mirëfillta shkëmbimi, por kemi nxitur më shumë pjesëmarrjen e studentëve në shkolla verore, konferenca, simpoziume dhe projekte ndërkombëtare.

Studentët e diplomuar në programin “Bachelor” në Drejtësi” apo “Master i shkencave” në Drejtësi pranë departamentit tonë kanë filluar një program të shkurtër mobiliteti apo një cikël të mëtejshëm studimesh në universitet më prestigjioze në BE dhe më gjerë, pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Nr	Universiteti
1	University LUISS Guido Carli, Itali
2	Universidad Complutense Madrid, Spania
3	University of London, Mbretëri e Bashkuar
4	Universiteti Katolik i Lionit, Francë
5	The University of the West of Scotland, Mbretëri e Bashkuar
6	Uniersiteti Teknologjik i Tallinit, Estoni
7	Universiteti Vrije, Hollandë
8	Universiteti Strasburgut, Francë
9	Universiteti Saints Cyril and Methodius, Maqedoni
10	Kolegji Seneca, Kanada
11	EIUC Venice School of Human Rights, Itali
12	Universitetin e Notingamit, Mbretëri e Bashkuar
13	Chicago-Kent College of Law, Shtetet e Bashkuara të Amerikës
14	School of American Law – Greqi
15	Universiteti i Nices, Francë
16	Universiteti i Pensilvanisë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës
17	Universiteti Bolonjes, Itali
18	Universiteti Luksemburgut, Luksemburg
19	Universiteti Loyola Chicago, Shtetet e Bashkuara të Amerikës
20	Model European Union Strasbourg, Francë



21	The University of Viadrina Summer School "The European System of Human Rights Protection"
22	Inter-University Center in Dubrovnik kurs në "Crime Prevention through Criminal Law and Security Studies"
23	International Model United Nations, Kosovë
24	Kyata Winter University for Security Studies
25	Association of Universities of the Adriatic – Ionian areas summer school on 'Migration Issues in the Balkans'

Të dhëna për punësimin e studentëve

Tabela 21: Të dhëna për punësimin e studentëve

Programi i studimit MSc në Drejtësi	Periudha e të dhënave (2013-2018)				
	Numri total i të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)	Numri total i të diplomuarve që kanë filluar post master	Numri total i të diplomuarve që nuk janë të angazhuar
	49	38	8	1	2

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1. Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i shkencave” apo “Master profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2. Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3. Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4. Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master profesional” niveli i gjuhës angleze (si edhe i gjuhëve të tjera të përcaktuara) është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Evropian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Kriteri 1: Parashikuar në Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë si dhe Rregullores përkatëse të programit, studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS.</p> <p>Kriteri 2: Të gjithë pranimet bëhen në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë në RSH, aktet nënligjore në fuqi, Statutin e KUB si dhe aktet ligjore në fuqi të miratuara dhe përcaktuara nga institucioni.</p> <p>Kriteri 3: E verifikueshme dhe nga dosjet përkatëse të çdo studenti pranë Sekretarisë Mësimore, studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni dhe nga ligji mbi Arsimin e Lartë në RSH.</p> <p>Kriteri 4: Siç është parashikuar dhe në Rregulloren e Studimeve dhe provimeve të Ciklit të Dytë, studentët e këtyre programeve të studimit para se të rregjistrohen në këto programe duhet të kenë të mbrojtur një ndër 5 gjuhët e Bashkimit Evropian mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master i shkencave” niveli i gjuhës është B1, sipas Kuadrit Evropian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5: Në përputhje me politikën e përfshira dhe në Planin Strategjik të Institucionit, KUB vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në rritjen e cilësisë së institucionit dhe përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe rekomandon nëse vlerëson të nevojshme, ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.	



<p>Kriteri 1. Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2. Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3. Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Kriteri 1: Studentëve u vihet në dispozicion informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve i cili behet i qartë në kompetencat e programit te disponueshme ne faqen zyrtare të departamentit. Zyra e Planifikimit të Karrierës pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentët organizon trajnime dhe programe të ndryshme për t'u ardhur në ndihmë studentëve në lidhje me ndërfutjen e tyre në tregun e punës. Seminare të ngjashme janë bërë në lidhje me plotësimin e CV-ve profesionale, leksione të hapura “Brown Bag Seminars in Law”, etj.</p> <p>Kriteri 2: Që në momentin e regjistrimit apo të interesimit për të vijuar studimet pranë KUB, studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion. Ndërkohë, për studentët e regjistruar organizohen takime ku u shpjegohet procesi i akreditimit të institucionit dhe të programeve përkatëse Kjo gjë bëhet si nëpërmjet takimeve direkte, po ashtu edhe përmes njoftimeve që bëhen në faqen në internet të institucionit.</p> <p>Kriteri 3: Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës dhe punësimit pas diplomimit nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Zyrës së të Diplomuarëve që operojnë pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentët. Në çdo fillim viti akademik, Departamenti përcakton një përfaqësues pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës, i cili asiston studentët në këtë drejtim, si edhe ruan lidhjen midis zyrës në fjalë dhe njësisë bazë.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarëve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3. Institucion disponon të dhëna për</p>	<p>Kriteri 1: KUB disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarëve në programet e studimeve që kanë përfunduar. Këto të dhëna ndodhen si pranë zyrës së sekretarisë mësimore gjithashtu dhe pranë zyrës së të diplomuarëve.</p> <p>Kriteri 2: Zyra e Sekretarinë Mësimore disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.</p> <p>Kriteri 3: Sekretaria Mësimore disponon të dhëna për</p>






ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.	ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim. ⁶⁷
Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1. Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2. Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Kriteri 1: KUB disponon një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre. Zyra e të Diplomuarëve mban bazën e të dhënave të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre.</p> <p>Kriteri 2: KUB disponon një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj. Zyra e të Diplomuarëve mban bazën e të dhënave për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>
Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve	
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p>	<p>Kriteri 1: Studentët informohen për gjithçka që ka të bëjë me procesin mësimor brenda KUB. Kanalet e komunikimit me ta janë në disa forma. E para ka ta bëjë me komunikimin zyrtar përmes adresës së emailit, e cila i mundësohet atij që në momentin e regjistrimit. E dyta mënyrë komunikimi është faqja e internetit të institucionit dhe programit respektiv, përmes të cilëve mund të shikohen të gjitha njoftimet dhe ndryshimet e bëra gjatë procesit mësimor. E treta, që është një nga elementët më të rëndësishëm të komunikimit midis njësive përfaqësuese të institucionit me studentët, është llogaria e personalizuar e çdo studenti në sistemin BIS (Beder Information System). Përmes këtij sistemi, studentët gjejnë mundësinë për t'u informuar në lidhje me çdo zhvillim, detyrim apo të drejtë të tyre gjatë procesit mësimor. Ata njoftohen për përditësimet e syllabuseve, lëndët që duhet të marrin, lëndët e mbartura nga vitet e mëparshme, notat për çdo provim, mungesat për çdo lëndë, etj.</p> <p>Nga ana tjetër, në lidhje me procesin e akreditimit, ai bëhet i njohur si për studentët, ashtu edhe për anëtarët e stafit akademik dhe administrativ. Njoftimi bëhet në bazë njësish dhe nëpërmjet lajmërimeve në faqen e internetit të KUB, ku është vendosur linku që drejton studentët në faqen e ASCAL. Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p>

⁶⁷ Evidenca nr. 7 – Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore

<p>Kriteri 2. Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3. Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Kriteri 2: Siç u përmend dhe në kriterin e mësipërm, studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit. Linku i ASCAL i vendosur në faqen e internetit të KUB, mundëson ndjekjen transparente të procesit. Në lidhje me vlerësimin e tyre akademik, studentët komunikojnë me pedagogët në mënyrë të vazhdueshme, si dhe me anë të funksionimit të sistemit të automatizimit. Me anë të këtij sistemi, studentët kanë mundësi të ndjekin nga afër çdo vlerësim të bërë ndaj tyre nëpërmjet internetit.</p> <p>Kriteri 3: Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve dhe në çdo rast studentët që nuk janë të bindur për vlerësimin e bërë nga përgjegjësi i modulit/ lëndës kanë të drejtë ta ankimojnë.⁶⁸</p>
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1. Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2. Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Kriteri 1: Në përputhje me rregulloret e brendshme të KUB, çdo grup studentësh ka të përcaktuar nga Departamenti këshilltarin akademik⁶⁹ i cili u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor. Gjithashtu, studentëve nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Karrierës që operon pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentët u ofrohet shërbimi i këshillimit dhe ndjekja e ecurisë së tyre dhe i ndihmon për trajtimin e tyre ;</p> <p>Kriteri 2: Politika e përgjithshme e e institucionit në lidhje me këshillimin e karrierës për studentët, parashikon angazhimin e Zyrës për Këshillimin e Karrierës, e cila është në varësi të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentin. Kjo zyrë ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit ku mund të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë. Këshillimi i karrierës për studentët, është një proces që realizohet përmes bashkëpunimit të zyrës përgjegjëse dhe Departamentit të Drejtësisë. Marrëveshjet e lidhura me aktorë të ndryshëm të tregut dhe përpjekja e vazhdueshme e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe njësisë bazë në institucion, bëjnë të mundur gjetjen e hapësirave për praktikat profesionale dhe programe të ndryshme.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Pas përfundimit të raportit të hartuar, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) diskutoi në mënyrë të hollësishme dhe vërtetoi se sipas Rregullores së Studimeve të Ciklit të Dytë, studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i shkencave” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS. Pranimi në programet “Master i shkencave” dhe ato të integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në fuqi dhe studentët</p>	

⁶⁸ Evidenca nr. 6 – Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë

⁶⁹ Evidenca nr. 18 - Vendimi i këshillit të departamentit mbi caktimin e këshilltarëve akademikë



plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni. Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit. KUB disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar. Zyra e Sekretarinë Mësimore disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. KUB disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar, informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve. GVB njëzëri konstaton se programi në fjalë i **përmbysh plotësisht** kriteret e kërkuara.

POLITIKA E KERKIMIT SHKENCOR.

10- Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien, vlerësime zyrtare të aktivitetit kërkimor individual ose për njësinë.

Politikat e kërkimit shkencor

KUB është një institucion i arsimit të lartë, i orientuar drejt kërkimit shkencor duke inkurajuar të gjithë anëtarët e stafit akademik për të qenë aktivë në fushën kërkimore, duke ofruar mbështetje financiare. Në përfundim të çdo viti akademik, të gjitha publikimet shkencore të botuara nga ana e stafit akademik vlerësohen në bazë të kriterëve të përcaktuara në Udhëzimi mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor⁷⁰, si dhe Rregulloren mbi Projektet Kërkimore-Shkencore.⁷¹

KUB ofron gjithashtu, mbështetje financiare për pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca dhe veprimtari shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Si rregull, çdo anëtar i stafit akademik ka të drejtë të përfitojë një herë në vit mbështetje financiare për pjesëmarrje në këto veprimtari.

Në të njëjtën kohë, organizimi ose bashkëorganizimi i konferencave dhe i veprimtarive shkencore të një niveli ndërkombëtar është një tjetër dimension i rëndësishëm i politikës kërkimore të KUB.

Informacion për ndërlidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien

Duke pasur parasysh lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, në programet e ciklit të dytë, studentët janë nxitur vazhdimisht të ndërmarrin kërkime. Rezultati është botimi i artikujve dhe pjesëmarrja në konferenca të ndryshme, si dhe organizimi në mënyrë të përvitshme Konferencës Ndërkombëtare të Studiusëve të Rinj. Siç parashikohet edhe në ligjin për Arsimin e Lartë, por edhe në rregulloret e brendshme institucionale, departamenti është njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore përkatëse.

Kolegji Universitar “Bedër” merr përsipër krijimin e një mjedisi që favorizon idealin e lirisë akademike dhe autonomisë individuale. Në ushtrimin e lirisë akademike, anëtarët e KUB duhet të mbajnë një qëndrim të ndershëm dhe të përgjegjshëm, për t’i dhënë komunitetit shkencor dhe shoqërisë metodologjinë, rezultatet, përplotësimin dhe ndikimin etik të kërkimeve. Bazuar në misionin e KUB, i cili vlerëson mbështetjen e kërkimit shkencor me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë, Kolegji Universitar “Bedër”, me anë të udhëzimit mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor, mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, si edhe shpërblen efektshmërinë akademike vjetore mbi tregues transparentë të parashikuar në rregulloren përkatëse.

Departamenti mbështetet financiarisht në mënyrë transparente dhe të hapur nga institucioni dhe përgjigjet për financimin e grupeve kërkimore. Departamenti, bazuar në rezultatet e punës së grupeve kërkimore, sugjeron vazhdimësinë ose ndërprerjen e bashkëpunimit me to. Në fund të çdo viti akademik bëhet vlerësimi i rendimentit të ekipit akademik, bazuar në

⁷⁰ Evidenca nr. 12 - Udhëzimi mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor

⁷¹ Evidenca nr. 10 - Rregullorja mbi Projektet Kërkimore-Shkencore

reagimin e marrë në vlerësimin e punës shkencore në bazë të treguesve transparentë të botuar në rregulloret përkatëse.

Me qëllim mbështetjen e kërkimit shkencor, pranë KUB funksionojnë disa njësi, si: qendrat kërkimore zhvillimore, zyra e kërkimit shkencor, zyra kërkuesve të rinj. Së fundmi është ngritur komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin.⁷²

Në mbështetje të bashkëpunimit të këtyre njërive me institucione dhe qendra kërkimore të tjera funksionon Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Varësisht këtij ndërveprimi, përveç projekteve të organizuara brenda KUB, ka pasur edhe një sërë projektesh dhe konferencash të përbashkëta me institucione brenda dhe jashtë vendit.

Institucioni siguron vazhdimësi në fushën e kërkimit shkencor

Plani strategjik i KUB parashikon tre elementë të rëndësishëm për funksionimin e aktivitetit institucional: mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe kontributin në shoqëri. Në këtë këndvështrim, rëndësi e veçantë i kushtohet pranimit të studentëve cilësorë, cilësisë së edukimit, cilësisë së kërkimit shkencor dhe mbështetjes së inovacionit.

Kërkimi shkencor ka qenë në fokus të procesit akademik në KUB, ku gjatë viteve akademike i gjithë personeli ka qenë i angazhuar në punë kërkimore. Publikimet e tij bëhen të ditura në Raportin Vjetor Institucional, i cili dorëzohet në MAS, por edhe në faqen e internetit të institucionit.

KUB ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Në organizimet e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare, KUB ka mbështetur pjesëmarrjen e studiuesve të rinj, veçanërisht të doktorantëve.

Në kuadër të marrëdhënieve që ka ndërtuar me MAS, KUB zbaton politikat shkencore rajonale dhe kombëtare duke i konkretizuar me aktivitete të realizuara dhe të tjera që planifikohen të mbahen në vijim. Gjithashtu, institucioni punon ngushtë me agjencitë kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit. Në këtë drejtim KUB ka nënshkruar kartën për studiuesit evropiane në përputhje me orientimin e AKTI. Personeli akademik është trajnuar nga AKTI në drejtim të zbatimit të projekteve dhe të programit Horizont 2020.

KUB aplikon në mënyrë të vazhdueshme me projekte kërkimore në përgjigje të thirrjeve për aplikime në projekte hulumtuese-shkencore në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Duke parë interesin dhe përfshirjen e vazhdueshme të studentëve në konkurset e tezave të diplomës, projekteve të organizuara si pjesë e programeve mësimore, si dhe pjesëmarrjen aktive në konferenca studentore të organizuara nga KUB por edhe jashtë tij, me vendim të Senatit Akademik ka ngritur "Qendrën për Kërkuesit e Rinj". E themeluar rishtazi, Qendra e Kërkuesve të Rinj shërben si një mundësi për të gjithë pjesëmarrësit për propozimin e iniciativave kërkimore- shkencore. Në këtë kuadër, pas trajnimit të studentëve lidhur me metodat kërkimore dhe hartimin e projekteve, qendra ka organizuar konkursin e parë për propozimet e projekteve kërkimore, kurse projektet fituese do të financohen nga KUB ose do të paraqiten pranë institucioneve donatore.

Siç vërehet edhe në raportet vjetore të njëpasnjëshme, por edhe në faqen e internetit të institucionit, KUB ka mbështetur dhe ka organizuar në mënyrë periodike konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, seminare etj. Organizime të kësaj natyre janë konferencat ndërkombëtare në shkencat humane, konferencat ndërkombëtare në shkencat e edukimit, etj., të cilat në çdo vit kanë ardhur me një tematikë të posaçme. Organizime të ngjashme janë edhe partneritetet e realizuara në shkallë departamenti me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Shembuj të

⁷² Evidenca nr. 10 – Rregullorja mbi projektet kërkimore-shkencore

këtyre janë konferencat e organizuara për dy vite radhazi mbi studimet e medias dhe komunikimit, ato në fushën e drejtësisë në bashkëpunim me universitetin “Aldo Moro” të Barit dhe universitetin e Lubllanës.

Në kuadër të bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe më gjerë, janë organizuar edhe disa seminare, me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm të fushave përkatëse . Pas çdo organizimi kërkimor përgatiten librat e konferencave, të cilat janë pajisur me ISBN nga Biblioteka Kombëtare, që u janë dërguar pjesëmarrësve të shtypura dhemund të gjenden në faqen e internetit të KUB.

Gjithashtu, në varësi të dy fakulteteve, publikohen në mënyrë periodike dy revista shkencore, të dyja këto të pajisura me ISSN. Ato janë Beder Journal of Educational Sciences-BJES (ISSN 2306-0557) dhe Beder Journal of Humanities - BJH (ISSN: 2306-6083).

Institucioni ndjek një politikë të vlerësimit dhe transferimit të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor

Me qëllim ndjekjen dhe vlerësimin e ecurisë së kërkimit shkencor, pranë KUB funksionon zyra e kërkimit shkencor, e cila harton dhe administron politikat që rregullojnë zhvillimin e kërkimeve në KUB dhe mbikëqyr zbatimin e programeve të tij të kërkimit, duke synuar të përmirësojë produktivitetin kërkimor të institucionit dhe të zgjerojë ndikimin e rezultateve akademike të kërkimit në drejtim të rretheve akademike dhe komunitetit. Në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale, KUB e parashikon atë në marrëveshjen kontraktuale që nënshkruan me anëtarin e ekipit akademik. Në nenin 8 të kësaj kontrate, parashikohet e drejta e autorit dhe e pronësisë intelektuale.

Së fundmi është ngritur komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin, i cili ka për detyrë mbikëqyrjen e progresit dhe raporteve përfundimtare të të gjitha granteve dhe projekteve të kërkimit. Kërkimet shkencore siç janë konferencat shkencore ndërkombëtare organizuar nga KUB, janë botuar në librat përkatës të konferencave, të pajisur me ISBN nga Biblioteka Kombëtare.

Tregues të matshëm:
 Të dhëna për kërkimin shkencor

Tabela 22: Të dhëna për kërkimin shkencor

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang Institucioni në vitet e fundit		
1.	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL	60
2.	Numri i projekteve kërkimore të fituara	4
3.	Numri i projekteve të zbatuara	5
4.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL	20
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL	160
6.	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	60
7.	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	20
8.	Numri i Çmimeve Kombëtare	2

Informacion për ndërlidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien

Duke pasur parasysh lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, në programet e Ciklit të Dytë, studentët dhe stafi janë nxitur vazhdimisht të ndërmarrin kërkime. Rezultati është botimi i artikujve, pjesëmarrja në konferenca dhe veprimtari të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, seria e seminareve Brownbag in Law, takimet me studentët etj.

A. PUBLIKIMET E STAFIT AKADEMIK 2013 – DHJETOR 2018
Tabela 23: Publikimet e Stafit Akademik 2013 – Dhjetor 2018


Viti 2013 - dhjetor 2018					
	Emërtimi i revistës shkencore ku janë publikuar botimet	Artikuj shkencorë	Publikime në proceedings	Fusha e publikimit (zgjidh një numër të një nga opsioneve në fund të tabelës)	Botim i shtypur/open access journals (Zgjidh një)
1	Beder Journal of Humanities 1 (2), 10-20	Bruçaj, Skënder; Workplace Spirituality in Higher Education;		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
2	Third International Young Researchers Conference on Law		Cybercrime, a National Security Issue, Nertil Berdufi	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
3	3rd International Conference on Humanities		The case of border conflicts, Arjan Lame	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
4	Third International Young Researchers Conference on Law		Globalizimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadrin e fenomenit të krimit kompjuterik, Arjan Lame	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe	Botim i shtypur/open access journals



				Shkencat Albanologjike	
5	Konferenca e Tretë Shkencore Ndërkombëtare: "Shteti, Shoqëria dhe e Drejta: Bashkëpunimi Rajonal"		Qarqet kufitare dhe bashkëpunimi ndërkufitar në optikën e konventës së Madrid-it Rast studimi Shqipëri-Fyrom, Arjan Lame	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
6	Third International Young Researchers Conference on Law		From UN to EULEX: Challenges to establish Rule of Law, Gentjan Skara	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
7	ICELL 2015, Tiranë, Nëntor, 2015		"Europe between common and civil Law; The new challenges of European coeval legislation (Arti Omeri & I.Faniko)	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
8	Romanian Journal of European Affairs, Vol. 14, No. 4	The Role of the EU as a Peacebuilder in the Western Balkans, Gentjan Skara		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
9	European Academic Research Vol. III, Issue 4	Legal Response against Cybercrime in Albania, Nertil Berdufi		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
10	Revista Shkencore Univers	Annexation of Crimea and "fresh war", Ferdinand Xhaferaj		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
11	Pjesmarrje dhe prezantim i raportit për qeverisjen lokale	Reports on Albanian Local Governement, F. Xhaferaj, B.uku		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
12	Konferenca II Ndërkombëtare Shkencore "on Interdisciplinary Studies" ICIS II-2015		Shpërndarja e funksioneve kryesore të shtetit midis organeve kushtetuese dhe marrëdhëniet që lindin midis këtyre organeve; Një krahasim ndërmjet monarkisë dhe sistemit parlamentar. I. Faniko	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
13	Konferenca kombëtare "103 vjet Shtet Shqiptar e mëpastaj: Roli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Presidentit Woodrow Wilson dhe Diasporës Shqiptare"		Procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë ndërkombëtar në fushën e parandalimit të torturës, E. Karamuco, I. Faniko	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
14	Konferenca kombëtare "103 vjet Shtet Shqiptar e mëpastaj: Roli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Presidentit Woodrow Wilson dhe Diasporës Shqiptare" ISBN: 978-		E drejta kushtetuese ndërmjet parimit të ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ligjshmërisë komunitare, E. Karamuco I. Faniko	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals


Handwritten signatures and initials in blue ink.

	608-4008-00-2				
15	1st International Conference on English Language and Literature, ICELL 2015		Europe between common and civil Law; The new challenges of European coeval legislation, I Faniko, A. Omeri	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
16	10th International Conference of the Albanian Institute of Sociology (AIS), AAB University and other partners		Human rights and Law on administrative procedure in Albania, E. Karamuco, I. Faniko	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
17	10th International Conference of the Albanian Institute of Sociology (AIS), AAB University and other partners		Public Law in the broad frame of the contemporary juristic disciplines, E. Karamuco, I. Faniko	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
18	Konferenca 4-t ndërkombëtare "Social - Economic Regional Cooperation towards the Developed Markets"		The understanding of the form of the state in the existing relation between organizational institutions and the constitutional sovereignty, E. Karamuco, I. Faniko	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
19	Konferenca 4-t ndërkombëtare "Social - Economic Regional Cooperation towards the Developed Markets"		The principle of separation of powers and challenges of its implementation in albanian governance, I. Faniko, E. Karamuco	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
20	Konferenca e 4-t ndërkombëtare UDEK 2015 Language and Literature "In Memory of Sami Frashëri"		Trajtimi i figures se Sami Frasherit ne historiografinë shqiptare, I. Faniko, I. Kaceli	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
21	Konferenca e 4-t ndërkombëtare UDEK 2015 Language and Literature "In Memory of Sami Frashëri"		Separation of the state from religion; A legislative novelty or an inherited tradition, I. Faniko, I. Kaceli	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
22	Konferenca ndërkombëtare, Research And Education – "Challenges Towards The Future" Icræ 2015		The Albanian Commissioner of Right to Information and Data Protect, New legal challenges on protecting human rights, I. Faniko, E. Karamuco	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
23	Konferenca ndërkombëtare, Research And Education – "Challenges Towards The Future" ICRAE 2015		Constituional Law; A Fundamental right at the threshold of globalization, I. Faniko, E. Karamuco	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
24	Revista Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences Vol. 1, Nr. 3, November 2015		Albanian process to EU integration and the free market legal reform, Irvin Faniko	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals







25	Revista Mediterranean Journal of Social Sciences Vol 7 No.1/s1 January 2016	The Albanian country, the institutional and territory organisation in the Illyrian period and during the principality of "Arbëria", Irvin Faniko		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
26	Revista Shqiptare Social Ekonomike Nr. 4 (85), Tetor-Dhjetor 2015	Kushtetuta në Republikën e Wiemarit 1919–1933; Aspektet historike që çuan në lindjen e saj", Irvin Faniko		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
27	IWES 2016 Workshop-i Ndërkombëtar "Perspektiva të zhvillimit të kurrikulave në programet e formimit për mësues dhe roli i arsimit të lartë" i zhvilluar pranë Shkollës së Lartë Hëna e Plotë (Bedër)	Aplikimi i modeleve bashkëkohore në kurrikulat ekzistuese në raport me standartet e Kartës së Bolonjës; Aspektet historiko-juridike". I. Faniko, A. Omeri, S. Hawa		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
28	Revista Shqiptare Social Ekonomike n.3(84), Korrik-Shtator 2015	Bashkejetesa e komuniteteve fetare ne rendin juridik italian dhe ne ate shqiptar; Nje krahasim, I.Faniko		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
29	Revista Academic Journal of Interdisciplinary Studies Vol 4 No 3 November 2015	The principle of legitimacy in Italian judicial system, the possible inspiration for Albania, I.Faniko		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
30	Revista Mediterranean Journal of Social Sciences Vol 6 No.6/s1/s2 November 2015	The historic legal development of Albanian fundamental charter, I.Faniko , A. Omeri		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
31	Reviste: (European Academic Research Vol. III, Issue 6)	Tackling child labour in Kosovo, Nertil Bërdufi		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
32	Reviste: (Diskutime Viti IV, No 17)	Kryerja e veprës penale në gjendje të dehur, Nertil Bërdufi		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
33	Reviste: (Mediterran journal of social sciences, Vol. III, No 6)	Social contracts and the governments legitimacy, Nertil Bërdufi		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals

34	International Conference "Tradition of the Law and the Law in Transition: Social, Political and Normative Processes in a Comparative Perspective" organized by The Faculty of Law of University of Tirana in co-operation with the Konrad-Adenauer-Stiftung, Rule of Law Program South East Europe		Legislative Approximation and Application of EU Law in Albania, G. Skara, B. Hajdini	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
35	Paper presented at the workshop The Individual, The Society and Sustainable Development: From Globalization to Glocalization	Globalization and migration, B Hajdini		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
36	Paper presented in the first International Conference on Law "Legal Framework for States' Cooperation in Managing the Refugee/Migrant Crisis" organised jointly by University College Bedër, the Faculty of Human Sciences, Department of Law in cooperation with Faculty of Law, University of Ljubljana		From Migration toward Refuges Crises: The Western Balkan Countries and European Integration. I G. Skara & F. Xhaferaj	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
37	Journal of Legal Studies, Volume 19, June 2017	Lost in Implementation: EU Law Application in Albanian Legal System, B. Hajdini & G. Skara		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
38	Konferenca e Pestë Shkencore Ndërkombëtare: "Shteti, Shoqëria dhe Ligji: Sfidat e Demokracisë dhe të Mirëqeverisjes"		Roli i Partive Politike në Procesin e Konsolidimit të Demokracisë: Rasti i Shqipërisë, Ermira Shkreta	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
39	Konferenca e Pestë Ndërkombëtare në Shkenca Humane – ICH 2017 "Ekstremizmi në Shek. 21: Roli i Ligjit, Medias, dhe Kulturës"		Korniza Ligjore e Marrëdhënieve Shtet - Fe në Shqipëri, Prof. Dr. Ferdinand Gjana & Ermira Shkreta	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
40	Konferenca Ndërkombëtare në Drejtësi: "Korniza ligjore për bashkëpunimin ndërshtetëror në menaxhimin e krizave të emigracionit dhe refugjatëve"		Korniza Ligjore Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Refugjatëve: Aspekte të së Drejtës Familjare, Ermira Shkreta	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
41	Konferenca Ndërkombëtare në Drejtësi: "Korniza ligjore për bashkëpunimin		National security and the right for asylum, A. Shegani, N. Berdufi	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe	Botim i shtypur/open access journals



	ndërshtetëror në menaxhimin e krizave të emigracionit dhe refugjatëve”			Shkencat Albanologjike	
42	European Scientific Journal (ESJ)	Law Enforcement and Investigation of Cybercrime in Albania, Nertil Berdufi		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
43	Third International Conference on Educational Sciences, 24-25 Prill 2014, Tirana, Albania.		“Albanian Foreign Policy after The Kosovo’s independence”, Ferdinand Gjana, Niuton Mulleti	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
44	International Conference on Humanities and Social Sciences, May 31 -June 01, 2014, Budva, Montenegro		“The Role of Germany in International Security after the Fall of The Berlin Wall”, Ferdinand Gjana	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
45	International Conference On Social Sciences, 19 - 20 Shtator 2014, Bucharet, Romania.		“Education in Multi-religious and Multiethnic Societies”, Ferdinand Gjana	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
46	International Conference on Interfaith Dialogue, May 2018, Tirana, Albania.		“The Interfaith Dialogue in Albania and its Contribution to International Security”, Ferdinand Gjana	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
47	3rd National Conference of the Independent Forum of the Rectors, 2018, Tirana, Albania.		“The Potential of Albania to Attract more Foreign Students”, Ferdinand Gjana, Arti Omer	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
48	Beder Journal of Humanities, ISSUE:3 VOLUME: 1 SPRING 2014, Hena e Plote Beder University Publication.	“Social Conflict as a Consequence of Freedoms Imbalance”, Ferdinand Gjana, Nereid Shehu		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
49	Mediterranean Journal of Social Sciences, Vol. 5, No. 22, September 2014	“NATO’s Adaptation Process in Post-Cold War Era”, Ferdinand Gjana		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
50	European Journal of Social Science and Research (EJSER), Vol. 1, Nr. 2, August 2014	“EU and NATO, Need For A Coherent Partnership”, Ferdinand Gjana		Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals
51	International Conference on Law "Legal Framework for States' Cooperation in Managing the Refugee/Migrant Crisis" organised jointly by		International Protection of Refugees: a Human Rights Perspective, Bledar Uku	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike	Botim i shtypur/open access journals

	University College Bedër, the Faculty of Human Sciences, Department of Law in cooperation with Faculty of Law, University of Ljubljana			
52	Konferenca e Pestë Ndërkombëtare në Shkenca Humane – ICH 2017 “Ekstremizmi në Shek. 21: Roli i Ligjit, Medias, dhe Kulturës”		The importance of the inter- cultural and inter-religious dialogue for the stability in the Western Balkans, B. Uku & F. Xhaferaj	Shkencat Sociale, Shkencat Humane dhe Shkencat Albanologjike Botim i shtypur/open access journals

B. KONFERENCAT KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE, PJESMARRJA NË KOMPETICIONE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE, BROWNBAG SEMINARS IN LAW, DEBATET STUDENTORE SI DHE AKTIVITETE SOCIALE PËR VITET 2013-2018

I. VITI AKADEMIK 2013-2014

A. Konferenca

1) Konferenca e Tretë Ndërkombëtare e Studjuesve të Rinj

Departamenti i Drejtësisë në Kolegjin Universitar “Bedër” në bashkëpunim me Fakultetin Juridik në Universitetin e Tiranës organizuan Konferencën e Tretë Ndërkombëtare të studiuesve të rinj në fushën e drejtësisë. Në konferencë morën pjesë më shumë se 60 studiues dhe pedagogë nga 21 vende të ndryshme të Botës dhe 40 universitete.

Në ceremoninë e hapjes ishin të pranishëm përfaqësues nga bota akademike, drejtues të universiteteve, organizatorë të konferencës si dhe personalitete nga fusha e drejtësisë. Kryetari i konferencës dhe njëkohësisht rektori i Kolegjit Universitar “Bedër” Dr. Ferdinand Gjana, në fjalën e tij përshëndetëse falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe shprehu bindjen se organizimi për herë të tretë i kësaj konference, në Shqipëri, është një mundësi për studiuesit dhe akademikët që vijnë nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, që të shkëmbejnë ide dhe eksperiencën dhe të ofrojnë idetë e tyre në lidhje me problematikat që shtrohen në fushën e të drejtës ndërkombëtare. Ai tha se ky organizim tregon rëndësinë që “Bedër” i kushton kërkimit shkencor.


Ceremoninë e hapjes së konferencës e përshëndeti edhe dekani i Fakultetit Juridik pranë Universitetit të Tiranës Prof. dr. Altin Shegani. Ai vlerësoi bashkëpunimin mes Departamentit të Drejtësisë në Universitetin Hëna e Plotë (Bedër) dhe Fakultetit Juridik, në organizimin e konferencës së dytë në fushën e drejtësisë. Profesor Shegani u ndal në rëndësinë që ka mbledhja e studiuesve të rinj nga një numër të madh vendesh në kuptimin dhe harmonizimin e sistemeve të ndryshme ligjore.

Pjesëmarrësit vazhduan më tej me referimet e temave të përgatitura dhe diskutimet në sesione të veçanta.

2) Konferenca e dytë Studentore në Drejtësi

Klubi “Beder Law Academy” në bashkëpunim me klubin “Human Rights” organizuan konferencën e dytë studentore në “Drejtësi”. Në konferencë morën pjesë 25 studentë nga cikli i parë (bachelor) dhe i dytë (master) i studentëve të drejtësisë të cilët referuan mbi tema që lidhen me problematikat dhe trendet aktuale në fushën e të drejtës dhe të drejtave të njeriut.

Në ceremoninë e hapjes ishin të pranishëm përfaqësues nga stafi akademik i departamentit të drejtësisë si dhe studentë nga departamentet e tjera. Lektorët e Departamentit të Drejtësisë vlerësuan iniciativën e studentëve në organizimin e kësaj konference pasi ajo shërben si shtysë për pjesëmarrje në konferenca të tjera shkencore si dhe zhvillon aftësinë e të kërkuarit






për përgatitjen e kumtesave. Gjatë sesioneve të konferencës u referuan rreth 20 kumtesa nga pjesëmarrësit.

Pjesëmarrja në kompeticione kombëtare dhe ndërkombëtare në simulim gjyqësor

1) Konkursin e Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve në Hagë – ICC Moot Court Competition 2014

Departamenti i Drejtësisë në Kolegjin Universitar “Bedër” përfaqësuan Shqipërinë në konkursin e simulimit gjyqësor të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve në Hagë. Studentët Ermira Bushi, Izmira Kastrati, Geraldo Taraj, Ermal Mema dhe Ervisa Gjinika përbëjnë ekipin garues në këtë konkurs ndërkombëtar. Kjo është hera e parë që Shqipëria përfaqësohet në konkurset ndërkombëtare.

Konkursi i simulimit gjyqësor të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve u zhvillua nga data 19 deri më 23 maj 2014 në Hagë, Hollandë. Ky konkurs mirëpriti universitete nga e gjithë bota, për një shkallë të madhe të debatit, duke stimuluar punimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve. Konkursi konsiston në një program të ngjeshur arsimor dhe social, prej gjashtë ditësh, duke sjellë së bashku studentë me prejardhje dhe kultura të ndryshme në Hagë, për të sfiduar aftësitë e tyre si avokatë të ardhshëm ndërkombëtarë. Raundi përfundimtar pritet të zhvillohet në një sallë gjyqi aktuale me trup gjykues konkret të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve.

Konkursi përfshin bashkëpunimin me gjyqtarë nga gjykata ndërkombëtare, profesorë të së drejtës ndërkombëtare (penale) dhe profesionistë të tjerë ligjorë. Ky rrjet e bën konkursin një stimulim real të seancave që zhvillohen në Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve. Çështjet e konkursit i drejtohen çështjeve themelore të së Drejtës Penale Ndërkombëtare si procedurale ashtu dhe substanciale.

51 ekipe nga 34 vende të ndryshme nga mbarë bota janë regjistruar në edicionin e vitit 2014 në konkursin e stimulimit gjyqësor të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve.

2) Konkursin Philip C. Jessup International Law Moot Court Competition – Jessup në Washington 2014

Një ekip studentësh nga Departamenti i Drejtësisë në Kolegjin Universitar “Bedër” fituan të drejtën për të marrë pjesë në një nga konkurset ndërkombëtare më të suksesshme në fushën e drejtësisë. Ekipi i përbërë nga studentët Anisa Kolgjini, Ermira Skreta, Emsal Ajredini dhe Armando Sina përfaqësuan Shqipërinë në fazën finale të konkursit "Jessup" që u zhvillua në Washington DC. Ndonëse kjo garë zhvillohet prej 55 vjetësh, është hera e parë që Shqipëria përfaqësohet në raundet ndërkombëtare të "Jessup".

Konkursi i simulimit gjyqësor të së Drejtës Ndërkombëtare Filip C. Jessup, i njohur edhe si Jessup është konkursi më i madh dhe më prestigjioz në botë, duke tërhequr pjesëmarrës nga mbi 600 Universitete në më shumë se 90 vende në vitet e fundit. Konkursi është një stimulim i një mosmarrëveshjeje imagjinare ndërmjet shteteve përpara Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Konkursi është emëruar pas Filip Jessup, një ndër ish-gjyqtarë të GjND. Ky konkurs është i organizuar nga Shoqata e Studentëve të së Drejtës Ndërkombëtare.

Vendet përfaqësohen nga një ose më shumë skuadra në raundin ndërkombëtar, Ëhite & Case të konkursit Jessup, në varësi të numrit të ekipeve që kanë hyrë në konkursin kombëtar. Si rezultat, shumica e shteteve organizojnë konkurse kombëtare për të zgjedhur ekipin më të mirë, i cili do të vazhdojë në garën ndërkombëtare në Washington DC. Raundet finale zhvillohen në anglisht.

Një nga arsyet kryesore për prestigjin dhe popullaritetin e Jessup-it është kalibri i studentëve që garojnë në nivel ndërkombëtar. Në kohën që ekipet arrijnë në Washington DC, konkurrentët janë të njohur me parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare, institucionet ndërkombëtare dhe procedurat. Përveç kësaj, studentët kanë një zotërim të jashtëzakonshëm të çështjeve gjyqësore të së drejtës ndërkombëtare, si dhe ngjarjeve aktuale. Konkurrentët pritet të kenë njohuri gati enciklopedike në lidhje me çështjet përkatëse (si të ICTR, ICTY dhe rastet e ICJ), si dhe materiale dytësore nga autorët kryesorë të së drejtës ndërkombëtare.

Ekipet që vazhdojnë në raundin ndërkombëtar në Washington DC konkurrojnë gjatë tre ditëve në debatë paraprake. Ekipet me pikët më të larta në total vazhdojnë në raundet me tridhjetë e dy, gjashtëmbëdhjetë, raundet çerekfinale, gjysmëfinale dhe finale.

Përveç debatit, konkursi shënohet edhe nga aktivitete të tjera sociale të tilla si Announcement Party, ku deklarohen fituesit e raundeve të para, Mbledhja e Studentëve të së Drejtës Ndërkombëtare, Diskutime i Kompromisit (çështjes gjyqësore mbi të cilën zhvillohet konkursi), Dessert and Dance Party. Balloja Go Nation, është një event ku pjesëmarrësit nga të gjitha vendet e botës vijnë me veshjet e tyre kombëtare. Galaja finale dhe debati i kundërt Jessup shënojnë fundin e konkursit.

3) Gjyqi i improvizuar “Beder Law Moot Court”- 21 Maj 2014



Në kuadër të lëndës “Shkrim, arsyetim ligjor dhe teknikë legjislativë” studentët e Departamentit të Drejtësisë edhe këtë viti akademik, organizuan një seancë gjyqësore të improvizuar në fushën e së drejtës penale nën udhëheqjen e pedagoges Ilma Bici. Seanca gjyqësore u realizua në sallën e gjyqit e ngritur për studentët, me një përkushtim dhe seriozitet dinjitoz. Rolet e subjekteve të procedimit penal u përvetësuan duke shpalosur aftësi të larta të arsyetuarit logjik me bazë ligjore.

B. Brownbag Seminars in Law

1) Armer Juka, “Arbitrazhi ndërkombëtar dhe shteti shqiptar” - 28 Shkurt 2014

Departamenti i Drejtësisë pranë Kolegji Universitar “Bedër” organizoi leksionin e hapur me temë ‘Arbitrazhi ndërkombëtar dhe shteti shqiptar’. Studentët e programit “Bachelor” dhe të programit “Master i shkencave” në drejtësi u njohën nga afër me rolin e Avokaturës së Shtetit Shqiptar, të përfaqësuar nga avokati i shtetit, Armer Juka. Gjatë leksionit u fol mbi praktikën e arbitrazhit dhe të instrumenteve kryesore për zhvillimin e tij.

Gjatë leksionit av. Juka u shpreh se hapja e shteti shqiptar karshi investimeve të huaja dhe tregut ndërkombëtar privat është shoqëruar me shumë sfida të karaktereve të ndryshme, në lidhje me respektimin e kontratave të nënshkruara qoftë në pozicionin e kontraktuesit si shtet në fushën e investimeve, ashtu dhe si aksionar në fushën e shërbimeve të ndryshme. Arbitrazhi i investimeve dhe instrumentet juridike përbënë fokusin kryesor të leksionit dhe, nëpërmjet diskutimit të disa rasteve që u ilustruan nga avokati Juka, u hodh dritë mbi strukturën ligjore të



arbitrazhit në Shqipëri dhe gjithashtu u bënë shpjegime terminologjike, duke filluar nga juridiksioni deri te shtrirja e tij, si dhe ushtrimi i tij.

Rasti Burimi Srl dhe Eagle Games SH.A.K - Republika e Shqipërisë (ICSID çështja nr. ARB/11/18) ceku nga afër jo vetëm zhvillimin e një çështjeje arbitrazhi, por edhe zhvillimin e tij në përgjithësi në Shqipëri. Studentët patën mundësinë të bëjnë pyetje, në lidhje me arbitrazhin në përgjithësi, por çështja midis CEZ dhe shtetit shqiptar krijoi debate dhe kjo në qëllimin e përgjithshëm të organizimit të eventit, si edhe për të krijuar një mjedis shkencor sa më pranë studentëve të profilit juridik.

2) *Isuf Shehu, "Avokatia si profesion, problematikat dhe vështirësitë në përmirësimin e sistemit ligjor" - 12 Mars 2014*

Dhoma Shqiptare e Tregtisë dhe Zhvillimit Ndërkombëtar (ACITAD) në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë të Kolegji Universitar "Bedër" organizuan seminarin trajnues me temë "Avokatia si profesion, problematikat dhe vështirësitë në përmirësimin e sistemit ligjor". Seminari u mbajt ditën e mërkurë në orën 12:30, në sallën e Senatit të Universitetit "Bedër".

Referues i kësaj teme ishte avokati Isuf Shehu. Z.Shehu është antar i ACITAD dhe aktualisht mban pozicionin e themeluesit dhe të kryetarit të zyrës së avokatisë "Lame & Shehu". Në këtë seminar ai ndau eksperiencën e tij si avokat me studentët e drejtësisë të Kolegji Universitar "Bedër", gjithashtu edhe problematikat dhe vështirësitë në përmirësimin e sistemit ligjor.


Fillimisht ai bëri një prezantim të tijin, dhe gjithashtu shpjegoi karrierën e tij profesionale se si kishte kaluar nga student i drejtësisë tek një avokat, i cili merrej kryesisht me çështjet e komplikuar. Pastaj foli për avokatinë, për rëndësinë e saj dhe rolin kyç që ajo ka në zhvillimin e rregullt të një procesi gjyqësor, ku theksoi se të jesh një avokat i mirë nuk do të thotë të mbyllësh çështje, të jesh një avokat i mirë do të thotë të përpiqesh t'i sigurosh të gjithë klientëve, një proces të rregullt ligjor.

Ndërsa për problematikat dhe vështirësitë në përmirësimin e sistemit ligjor i përmendi se fakti që legjislacioni shqiptar është kopje i atij italian dhe gjerman, ku shumë procedura jo të hartuara mirë sjellin problematika të shumëllojshme dhe abuzime ndaj sistemit ligjor. Gjithashtu ai shtoi më tej se në një sistem gjyqësor nuk ka një seancë të ndërmjetshme si në atë anglo-sakson, për vlefësimin dhe shqyrtimin se nëse ajo çështje duhet gjykuar ose duhet pushuar, por kjo jepet me vendim përfundimtar. Ky fakt ngadalëson procesin ligjor dhe në shumë raste shkel parimin e drejtësisë.

Ky seminar u zhvillua në sajë të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve përkatëse. Gjithashtu, seminari ishte i hapur, ku studentët zhvilluan një bashkëbisedim me Z.Shehu, duke i drejtuar atij pyetje të ndryshme rreth temës dhe problematikave të legjislacionit Shqiptar.

3) *Xhemal Qefalia, "Roli dhe Funksonimi i Komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare" - 11 Mars 2014*

Deputeti i Partisë Socialiste z. Xhemal Qefalia i ftuar në Kolegji Universitar "Bedër" nga Departamenti i Drejtësisë mbajti një leksion të hapur lidhur rolin dhe funksionimin e Komisionit





parlamentar për Sigurinë Kombëtare. Gjatë leksionit u fol për rolin dhe funksionimin e Komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare si dhe për çështje të tjera të lidhura me sigurinë kombëtare.

4) *Jonian Molla, "Përafrimi i legjislacionit me EU acquis"*

Në kuadër të kursit 'Albanian Law and EU', studentët e departamentit të drejtësisë zhvilluan një leksion të hapur me temë: "Modelling Albanian Legal System in compliance with EU acquis", me z. Jonian Molla, specialist në Komisionin e Sigurisë Kombëtare për çështjet që lidhen me procesin e përafrimit të legjislacionit me EU acquis.

Z. Molla i njohu studentët me procesin e përafrimit të legjislacionit, institucionet përkatëse si dhe me sfidat dhe reformat që do të përballet Shqipëria pas marrjes së statusit kandidat.



C. Aktivitete Sociale

1) Vizitë zyrtare në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë - 02 Prill 2014

Studentët e drejtësisë në Kolegji Universitar “Bedër”, të cilët do të marrin pjesë në konkurset ndërkombëtare “Jessup” në Washington dhe “ICC” në Gjykatën Ndërkombëtare të krimeve në Hagë, u pritën sot në një takim nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese z. Bashkim Dedja dhe nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, z. Xhezair Zaganjori. Në takimin me drejtuesit e lartë të gjykatave studentët u shoqëruan nga Rektori i Kolegji Universitar “Bedër”, z. Ferdinand Gjana.

Ky takim u zhvillua në kuadër të konkurseve ndërkombëtare ku studentët e programit bachelor në drejtësi do të përfaqësojnë Shqipërinë.

Gjatë bashkëbisedimit me studentët, z. Dedja u fokusua tek teknika legjislative dhe i këshilloi studentët profesionalisht nga ana teorike e profesionit. Gjithashtu ai theksoi se pjesëmarrja në këto konkurse me famë botërore ishte pritur me kënaqësi dhe i uroi studentëve suksese dhe një përfaqësim sa më të denjë të vendit tonë.

Ndërsa, z. Zaganjori ndau me studentët eksperiencën gjatë karrierës së tij. Njëkohësisht, ai motivoi studentët për më tepër punë dhe ambicje në profesionin që ata kanë zgjedhur. Ai u ndal gjithashtu në rëndësinë dhe përgjegjësinë që ka përfaqësimi i Shqipërisë në të tilla konkurse ndërkombëtare duke i përgëzuar studentët dhe shprehu mbështetjen e tij të plotë në këtë aspekt.


Ftesa në drejtim të studentëve nga ana e Kryetarëve të këtyre dy gjykatave erdhi menjëherë pas lajmit se Shqipëria, për herë të parë do të përfaqësohet në konkursin “Jessup” në Washington dhe “ICC” në Gjykatën Ndërkombëtare në Hagë nga studentët e Kolegji Universitar “Bedër”.

2) Pjesëmarrje në gjyqin imitues të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës - 9 Maj 2014

Në kuadër të ftesës së bërë nga ana e Shkollës së Magjistraturës e Republikës së Shqipërisë studentët e Departamentit të Drejtësisë në Kolegjin Universitar “Bedër”, ndoqën gjyqin e improvizuar nga magjistratët e Shkollës së Magjistraturës në ambientet e Gjykatës së Lartë. Improvizimi i referohej një çështjeje penale.

D. Debatet studentore

Studentët e Departamentit të drejtësisë zhvillojnë çdo ditë të enjte bashkëbisedime në grupe në formë debati me tema të ndryshme në fushën juridike. Debatet synojnë të trajtojnë problematikat dhe trendet aktuale në fushën e të drejtës të cilat janë objekt shqyrtimi nga instrumentat dhe aktorët ligjorë vendas dhe ndërkombëtarë. Këto seanca aftësojnë studentët të arsyetojnë ligjërisht dhe të praktikojnë të shprehurit në publik



II. VITI AKADEMIK 2014-2015

A. Konferenca

1) Konferenca e Tretë Studentore në Drejtësi – 21 Maj 2015

Departamenti i Drejtësisë në Kolegjin Universitar “Bedër” në bashkëpunim me klubin studentor “Bedër Law Academy” zhvilluan konferencën e 3-të studentore me temë “Sfidat e Drejtësisë Shqiptare në Procesin e Integritimit në Bashkimin Evropian”.

Me pjesëmarrjen e rreth 18 studentëve nga cikli i parë dhe i dytë i studimeve, punimet e realizuara nën udhëheqjen e pedagogëve të departamentit të drejtësisë, trajtonin tema të ndryshme aktuale që përbëjnë sot thelbin e debatit në drejtësinë shqiptare.

Konferenca u zhvillua në 4 sesione të moderuara nga studentë të programit masteri, ku në çdo sesion referuesit paraqitën punimet e tyre që u vlerësuan me certifikata nga juria e përbërë nga pedagogë të universitetit.

Përpos çertifikatave, 5 punimet më të mira u vlerësuan edhe me çmime të tjera.

1. Besarta Prenga, me temën “Sfidat e legjislacionit shqiptar në rrugën e harmonizimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian” ishte fituesja e çmimit të parë prej 150 Euro.

2. Redneks Dushi, me temën “Korrupsioni në Shqipëri: Sfidë e rëndësishme drejt Integritimit Evropian” u vlerësua me çmimin e dytë prej 125 Euro.

3. Fituesja e çmimit të tretë prej 100 Euro ishte studentja, Silvana Belishta me temën: “Sfidat e Drejtësisë Shqiptare në rrugën e Integritimit Evropian”

4. Çmimi i katërt prej 75 Euro iu dha studentit Marinell Bregu me temën “Reforma Gjyqësore: Sfidë e Integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian”

5. Elton Ruda, ishte fitues i çmimit të pestë prej 50 Euro me temën “Përfshirja e të miturve në krime kibernetike”

Risi e kësaj konference këtë vit ishte pjesëmarrja e studentëve të drejtësisë nga universitete të tjera në vendin tonë.

B. Pjesëmarrja në konkurse ndërkombëtare

1) Konkursi Philip C. Jessup International Law Moot Court Competition – Jessup në Washington, Prill 2015

Konkursi Ndërkombëtar Jessup, nën administrimin e ILSA-s bashkon studentë të drejtësisë nga i gjithë globi. Tashmë në vitin e tij të 56-të, Jessup është konkursi ndërkombëtar më i madh në botë për studentët e drejtësisë, me pjesëmarrës nga më shumë se 600 Universitete në mbarë botën. Raundet ndërkombëtare do të mbahen në 5 -11 prill 2015, në Hyatt Regency në Kapitol Hill, Washington, DC.

Për të dytin vit radhazi, Kolegji Universitar “Bedër” formoi një ekip studentësh të kualifikuar të së drejtës ndërkombëtare që do të mundësojnë përfaqësimin e Shqipërisë për të tretën herë në historinë e Jessup.




Konkursi simulon një çështje gjyqësore në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (ICJ), organi kryesor gjyqësor i Kombeve të Bashkuara. Që nga shtatori 2014 ekipi ka studiuar problematikën e çështjes gjyqësore në Jessup, e cili adreson efektin e një ndryshimi rrënjësor të rrethanave të një traktati dypalësh dhe çështjet procedurale dhe qenësore që dalin nga aneksimi i territorit të një kombi nga një tjetër. Ekipi ka hulumtuar dhe ka përgatitur argumentet thelbësore me gojë për të përfaqësuar çdo anë të mosmarrëveshjes imagjinare.

2) *Konkursin e Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve në Hagë – ICC Moot Court Competition, Maj 2015*

Departamenti i Drejtësisë në Kolegjin Universitar “Bedër” do të përfaqësojë vendin tonë për të 2-tën herë në konkursin e simulimit gjyqësor të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve në Hagë.

Studentët Jonida Shtylla, Fatjona Halaj, Helena Dokaj, Amarildo Hoxha, Endri Çela përbëjnë ekipin garues në këtë konkurs ndërkombëtar.

Konkursi i simulimit gjyqësor të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve do të zhvillohet nga data 17 deri më 22 maj 2015 në Hagë, Holandë. Ky konkurs mirëpret universitete nga e gjithë bota, për një shkallë të madhe të debatit, duke simuluar punimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve. Konkursi konsiston në një program të ngjeshur arsimor dhe social, prej gjashtë ditësh, duke sjellë së bashku studentë me prejardhje dhe kultura të ndryshme në Hagë, për të sfiduar aftësitë e tyre si avokatë të ardhshëm ndërkombëtarë. Raundi përfundimtar pritet të zhvillohet në një sallë gjyqi aktuale me trup gjykues konkret të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve.

Konkursi përfshin bashkëpunimin me gjyqtarë nga gjykata ndërkombëtare, profesorë të së drejtës ndërkombëtare (penale) dhe profesionistë të tjerë ligjorë. Ky rrjet e bën konkursin një simulim real të seancave që zhvillohen në Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve. Çështjet e konkursit i drejtohen çështjeve themelore të së Drejtës Penale Ndërkombëtare si procedurale ashtu dhe substanciale.

57 ekipe nga 38 vende të ndryshme të botës janë regjistruar në edicionin e vitit 2015 në konkursin e stimulimit gjyqësor të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve.


3) *Gjyqi Simulues i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – Shqipëri 2015*

“Gjyqi Simulues i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – Shqipëri 2015” është një konkurs i cili u organizua nga Qendra Evropiane në bashkëpunim me Civil Rights Defenders. Ky event mbledh studentë të ligjit, mbrojtësit e ardhshëm të të drejtave të njeriut, duke i grupuar ata në skuadra. Këto skuadra marrin pjesë në gjyqet e simuluar të GJEDNJ-së, përpara një jurie të përbërë nga gjyqtarë ekspert mbi të drejtat e njeriut.

4) *Beder Law Moot Court – 18 maj 2015*

Klubi studentor “Beder Law Academy” në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë në Universitetin “Bedër”, zhvilluan për të katërtin vit radhazi Gjyqin Imitues ku studentët e vitit të parë dhe të dytë improvizuan një proces të rregullt gjyqësor.

Kazusi i marrë në shqyrtim nga studentët trajtonte një aksident rrugor të ndodhur në rrethrotullimin e doganës nga ku kishte mbetur i plagosur një kalimtar i rastit. Pas kësaj ai ishte



dërguar në spital ku dhe kishte marrë ndihmën e parë. Më pas ai denoncon palën tjetër dhe kërkon dëmshpërblimin përkatës.

Prokurorja ishte e qëndrimit se faktori në këtë rast ishte drejtuesja e automjetit e cila nga shpejtësia e lartë nuk kishte mundur ta shmangte përplasjen. Nga ana tjetër pala mbrojtëse e kundërshtonte këtë duke vënë në dukje se ishte pakujdesia e viktimës që kalon rrugën në një vend ku mungonin vijat e bardha.

Ishin dëshmitarët dhe ekspertimi autoteknik që i dhanë dritë kësaj ngjarjeje duke nxjerrë në pah se automjeti në fjalë po ecte komfort tabelave rrugore që diktojnë shpejtësinë në aksin në fjalë dhe se faktori në këtë aksident ishte kalimtari. Si pasojë gjykata vendosi të shpallë të pafajshme drejtuesen e automjetit.

Ky aktivitet i kthyer tashmë në një traditë për studentët e këtij deartamenti, u zhvillua në prani të një numri të konsiderueshëm studentësh dhe pedagogësh.

C. Brownbag Seminars in Law

1) *Idlir Peçi, "Reforma në Drejtësi" – 25 nëntor 2014*

Zv. Ministri i Drejtësisë z. Idlir Peçi ishte i ftuar nga klubi studentor "Beder Law Academy" në një leksion të hapur ku ndau me studentët dhe të pranishmit pikëpamjet rreth temës "Reforma në Drejtësi".

"Reforma në drejtësi është një nga sfidat më të rëndësishme që kërkon përkushtim të vazhdueshëm të të gjithë aktorëve"- tha zv. ministri gjatë prezantimit të ecurisë së deritanishme të kësaj reforme dhe të institucioneve që janë pjesë e saj.


Ndër të tjera, z. Peçi u shpreh se për reformimin e strukturave në drejtësi nuk është i domosdoshëm ndryshimi i individëve, por ndryshimi i sistemit në tërësi, duke filluar që nga edukimi juridik, i cili është baza e mbarëvajtjes së marrëdhënieve juridiko-shoqërore dhe duke vazhduar më tej me ndryshimet institucionale. Në të njëjtën kohë, z. Peçi vlerësoi Shkollën e Magjistraturës si një nga institucionet model në vendin tonë duke përmendur cilësinë që garanton ku së fundmi i është shtuar edhe kërkimi shkencor.



Aktiviteti vazhdoi më tej me pyetje të shumta nga të pranishmit ku nuk u la pa përmendur as reforma në sistemin e burgjeve në Shqipëri për të vijuar me eksperiencat e shumta profesionale që zv. ministri ndau me studentët.

2) *Mesila Doda, 'Iniciativa e përbashkët gjinore dhe ligjore për mbrojtjen e të drejtave të grave' – 16 dhjetor 2014*

Znj. Mesila Doda, deputete në Kuvendin e Shqipërisë dhe kryetare e "Aleanca e Grave Deputete", ishte e ftuar nga klubi studentor "Beder Law Academy" në një leksion të hapur ku ndau me studentët dhe të pranishmit pikëpamjet rreth temës "Iniciativa e përbashkët gjinore dhe ligjore për mbrojtjen e të drejtave të grave".

Znj. Mesila Doda bëri një prezantim të veprimtarisë së Aleancës duke theksuar se kjo aleancë ka arritur një bashkëpunim të gjerë mes të gjitha grave deputete përtej dallimeve.



partiake. Këto bashkëpunime konsistojnë në çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të grave, rritjen e rolit të gruas në politikë dhe respektimin e kuotës gjinore në listat e kandidatëve. “Gratë duhet të bashkohen me njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë mund të realizohet fuqizimi i tyre”- tha Znj. Doda duke përmendur në këtë mënyrë arritjet që ka patur ky organizim në Kuvendin e Shqipërisë por edhe në vende të tjera shqipfolëse si Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi.

Ndër të tjera, Znj. Doda u shpreh për ligjin për lustracionin si dhe për hapjen e dosjeve. Në lidhje me këtë të fundit, ajo theksoi se jemi shumë vonë në hapjen e dosjeve por gjithsesi ky është një hap i domosdoshëm që duhet ndërmarrë sa më shpejt nga politika shqiptare. Gjatë bashkëbisedimit, Znj. Doda vlerësoi disa propozime të studentëve në lidhje me analizimin e fuqisë ekonomike të gruas duke trajtuar mënyrën sesi gjykatat kanë bërë ndarjen e pasurisë në familje. Përveç kësaj, ajo u kërkoi studentëve të hartojnë një projekt në lidhje me këtë në mënyrë që ajo ta propozojë në parlament.

3) *Ilir Qafa, ‘Roli dhe Funksionimi i Shërbimit të Provës’ – 05 shkurt 2015*

Z. Ilir Qafa, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës ishte i ftuar nga klubi studentor “Bedër Law Academy” në një leksion të hapur ku ndau me studentët dhe të pranishmit pikëpamjet rreth “Rolit dhe Funksionimit të Shërbimit të Provës”.

“Ky institucion ka filluar të prodhojë efekte pozitive, të cilat lidhen në mënyrë të pashmangshme me rehabilitimin e personave në konflikt me ligjin, me uljen e recidivizmit apo zvogëlimin e shpenzimeve ekonomike që shoqërojnë vuajtjen e dënimit pranë institucioneve të edukimit dhe vuajtjes së dënimeve penale” – u shpreh z. Qafa pasi bëri një rezymë të shkurtër të veprimtarisë së institucionit që ai drejton.


Bashkëbisedimi me studentët vashdoi më tej në formën e pyetje – përgjigjeve, ku z. Ilir Qafa analizoi qartë çdo fushë në të cilën studentët treguan interes. Përmendim këtu: dispozitat ligjore të kodit penal të Republikës së Shqipërisë, hapësira ku mund të veprojnë Shërbimi i Provës, etj.

4) *Milena Harito, “Reformat në administratën publike, parakusht për anëtarësimin në Bashkimin Evropian” – 08 prill 2015*

Znj Milena Harito, Ministre për Inovacionin dhe Administratën Publike, ishte e ftuar në kuadër të ciklit “Brownbag Seminars” e cila mbajti një leksion të hapur me studentët e Departamentit të Drejtësisë rreth temës: “Reformat në administratën publike, parakusht për anëtarësimin në Bashkimin Evropian”.

Bashkëbisedimi me studentët u zhvillua në disa faza, fillimisht Znj. Harito njohu të pranishmit me kompetencat, strukturën si dhe institucionet në varësi të ministrisë në fjalë. Më pas ajo bëri një përshkrim të shkurtër të reformave konkrete që janë ndërmarrë në administratën publike në shërbim të procesit të anëtarësimit në BE.

Aktiviteti vazhdoi më tej me pyetje të shumta nga studentët të cilët shprehën interes në fusha të tilla si: zëvendësimi i stafit të administratës sipas qeverive përkatëse, vizionin e



ministrisë për të ardhmen, mundësitë që krijon kjo ministri për tregun e punës dhe konkretisht për profesionistët e rinj si dhe ndikimi i procesit të anëtarësimit në mirëfunksionimin e kësaj ministrie.

Gjatë vizitës në Universitetin Bedër, znj Milena Harito u shoqërua nga rektori i institucionit Dr. Ferdinand Gjana i cili ndër të tjera e njohu znj. ministre me muzeun e Medias dhe të Komunikimit.

5) *Fatmir Xhafaj, "Rëndësia e reformës në fushën e drejtësisë" – 21 maj 2015*

Kryetari i Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, njëkohësisht kryetar për reformën në Drejtësi z. Fatmir Xhafaj, diskutoi me studentët e Bedër rëndësinë e reformës në fushën e drejtësisë.

I ftuar në ceremoninë e hapjes së Konferencës e 3-të studentore në Drejtësisë të Organizuar nga Departamenti i Drejtësisë, z. Xhafaj u ndal në ecurinë e deritanishme të punës që ka kryer komisioni i reformës.

6) *Jan Braathu, "Western Balkan: Current Problems and road Ahead" – 25 maj 2015*

Ambasadori i Norvegjisë për Kosovën dhe Shqipërinë, Z. Jan Braathu ishte i ftuar në një leksionin të hapur me temë "Western Balkan, Current Problems and road Ahead".

Gjatë bashkëbisedimit me studentët Z. Braathu u ndal në problemet kryesore me të cilat haset Ballkani Perëndimor në rrugën drejt integritit në Bashkimin Evropian, duke trajtuar elementin politik, ekonomik e atë social. Ndër të tjera, ai theksoi mungesën e bashkëpunimit rajonal si një nga pengesat më të mëdha në fushën e zhvillimit të rajonit.

Aktiviteti vazhdoi më tej me pyetje të shumta nga studentët dhe të pranishmit në lidhje me aspekte të ndryshme të situatës aktuale në Ballkan.



Në përfundim të fjalës së tij Z. Braathu u takua me grupin e studentëve që morën pjesë në Konkursin Ndërkombëtar "Jessup" në Washington, të cilët e falenderuan Z. Braathu për mbështetjen që Ambasada e Norvegjisë për Kosovën dhe Shqipërinë ofroi për përfaqësimin e Shqipërisë në këtë konkurs.

7) *Florian Kalaja, "Gjykimit në mungesë në procesin civil" – 12 qershor 2015*

Florian Kalaja, Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ishte i ftuari i radhës në "Brownbag Seminars", cikël seminaresh të organizuara nga klubi studentor "Bedër Law Academy".

Gjatë bashkëbisedimit me studentët e Departamentit të Drejtësisë, Z. Kalaja ndau me ta pikëpamjet e tij rreth "Gjykimit në mungesë në procesin civil" e cila ishte dhe tema e këtij aktiviteti.

Pasi bëri një prezantim të përgjithshëm të librit të tij me të njëjtin titull, duke trajtuar problematikat kryesore që hasen në procedurat gjyqësore civile në lidhje me gjykimin në mungesë, ai theksoi se në dispozitat aktuale në lidhje me gjykimin në mungesë në procesin civil vihen re disa shkelje të parimeve kushtetuese si dhe të parimeve të përgjithshme.



II. VITI AKADEMIK 2015 - 2016

A. Konferenca

1) *Workshop – 14 prill 2016*

Departamenti i Drejtësisë në Kolegjin Universitar “Bedër”, në bashkëpunim me Universitetin e Barit, Aldo Moro, zhvilluan sot panelin e diskutimit me temë: “*The Individual, The Society and Sustainable Development: From Globalization to Glocalization*” (Individi, Shoqëria dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm: Nga Globalizmi në Glocalizëm).

Përgjegjësi i Departamentit të Drejtësisë, njëkohësisht moderatori i panelit të sotëm, Dr. Ferdinand Xhaferaj, pasi i uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe i njohu ata me rëndësinë e zhvillimit të kësaj teme, shprehu bindjen dhe besimin se ky është takimi i parë i një rruge të gjatë e të frytshme bashkëpunimi ndërmjet dy universiteteve në fushat e eksperiencave akademike, studentore si dhe të kërkimit shkencor.

Menjëherë pas fjalës së tij ishte radha e Profesor Sebastiano Tafaro, i cili gjatë referimit të tij u shpreh se bota universitare duhet të japë orientim se si duhet të jetë modeli i shtetit në kushtet e reja politiko-ekonomike. Gjithashtu ai u ndal në rolin e të rinjve dhe ndikimi i tyre në krijimin e perspektivës për një demokraci të qëndrueshme.

Ndërsa ish-ministri i Drejtësisë, njëkohësisht ekspert politik, z. Enkelejd Alibeaj, theksoi se sistemi i drejtësisë duhet të japë llogari për mënyrën e ushtrimit të funksionit dhe balancimit e ndarjes së pushteteve pasi i vetmi sovran në një shoqëri demokratike, është populli.

Aktiviteti vazhdoi më tej me referimet e panelistëve të tjerë të pranishëm. Po ashtu nuk munguan as pyetjet e shumta nga studentët dhe pedagogët e departamenteve të tjera të cilët i dhanë një formë interaktiviteti panelit të sotëm.


2) *Konferenca e katërt Studentore në Drejtësi – 11 maj 2016*

Klubi studentor “Bedër Law Academy” organizoi për të katërtën herë radhazi Konferencën studentore me teme “Law and Society”.

Punimet e kësaj konferencë u përshëndetën nga Kryetarja e Grupit Parlamentar për Shëndetësinë dhe Çështjet Sociale, znj. Albana Vokshi. Në fjalën e saj, znj. Vokshi vlerësoi iniciativën e të rinjve në organizimin e një eventi të tillë shkencor në rang studentor. Sipas saj, me qëllim ruajtjen e balancave në shoqëri është i domosdoshëm jo vetëm hartimi i ligjeve të mira por edhe zbatimi i tyre nga individë të përgjegjshëm.

Konferenca mbledhi studentë nga disa universitete të ndryshme në vendin tonë, të tillë si: Luigj Gurakuqi Shkodër, Universiteti i Tiranës, Universiteti Evropian i Tiranës etj. 27 kërkues të rinj, parqitën temat e tyre përballë një jurie të përbërë nga pedagogë dhe specialistët të fushës në Bedër. U vlerësua me çmimin e parë, studenti Albi Çela, ndërsa çmimi i dytë shkoi për studenten Sonila Rrahmani, ndërsa tre çmimet e treta u fituan përkatësisht nga studentët: Ilmi Leka, Ornela Bego dhe Bora Kola.

Ky është forumi i parë studentor në Shqipëri, ku studentët prezantojnë dhe diskutojnë mbi zhvillimet, trendet dhe shqetësimet aktuale, sfida praktike të hasura dhe zgjidhje të adoptuara në ligj dhe shoqëri. Risi e kësaj konference edhe këtë vit ishte pjesëmarrja e studentëve të drejtësisë nga universitete të tjera në vendin tonë. Bashkangjitur në shtojcën 8 gjeni programin e konferencës.



B. Pjesëmarrja në konkurse ndërkombëtare dhe kombëtare

1) Konkursi Philip C. Jessup International Law Moot Court Competition – Jessup në Washington, 27 Mars – 2 Prill 2016

Studentët e Departamentit të Drejtësisë në Kolegjin Universitar “Bedër”, përfaqësuan Shqipërinë për të tretën herë radhazi në konkursin ndërkombëtar *Jessup* në Washington, i cili konsiston në simulimin e një mosmarrëveshjeje hipotetike ndërmjet shteteve. E gjitha kjo para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, organ gjyqësor i Kombeve të Bashkuara.

Në raundin ndërkombëtar që u mbajt në datat 27 mars – 2 prill në SHBA, këtë vit morën pjesë 132 skuadra nga 80 shtete të ndryshme të botës, ndër ta edhe ekipi i studentëve të Bedër i cili përbëhej nga: Albi Çela, Ermelinda Gjeci dhe Rajmonda Zhuta si dhe nga pedagogët: Gentjan Skara dhe Eni Kokalari.

Grupi i studentëve të lartpërmendur u përballën në fazën finale të kompeticionit me Hebreë University of Jerusalem, National University of Singapore, L.U.I.S.S. Guido Carli, American University of Sharjah ku dhe arritën rezultate të suksesshme.

2) Konkursi i Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve në Hagë – ICC Moot Court Competition, 22 – 27 Maj 2016

Departamenti i Drejtësisë në Kolegjin Universitar “Bedër” përfaqësoi Shqipërinë për të 3-tën herë radhazi në konkursin e simulimit gjyqësor të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve në Hagë. Këtë vit ekipi garues përbëhet nga studentët Elton Ruda, Ornela Bego, Dajana Manahasa dhe Elvis Gjeci.


Ky konkurs u zhvillua nga data 22 deri më 27 maj 2016 në Hagë, Holandë, në të cilin garuan universitete nga mbarë bota, për një shkallë të madhe të debatit, duke simuluar punimet përkatëse në Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve. Konkursi konsiston në një program të ngjeshur arsimor dhe social, duke sjellë së bashku studentë me prejardhje dhe kultura të ndryshme në Hagë, për të sfiduar aftësitë e tyre si avokatë të ardhshëm ndërkombëtarë. Ashtu si çdo vit tjetër, raundi përfundimtar pritet të zhvillohet në një sallë gjyqi aktuale me trup gjykues konkret të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve në Hagë.

Çështjet e konkursit i drejtohen çështjeve themelore të së Drejtës Penale Ndërkombëtare si procedurale ashtu dhe substanciale.

3) Gjyqi Simulues i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – Shqipëri 2016

“Gjyqi Simulues i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – Shqipëri 2016” është një konkurs i cili u organizua nga Qendra Evropiane në bashkëpunim me Civil Rights Defenders. Ky event mbledh studentë të ligjit, mbrojtësit e ardhshëm të të drejtave të njeriut, duke i grupuar ata në skuadra. Këto skuadra marrin pjesë në gjyqet e simuluar të GJEDNJ-së, përpara një jurie të përbërë nga gjyqtarë ekspert mbi të drejtat e njeriut.

Gjashtë universitete të drejtësisë në vend, të përzgjedhura në bazë të një rregullorje dhe kriterëve të mirëpërcaktuara u “përballën” me njëri-tjetrin. Kolegji Universitar “Bedër” u përfaqësua nga studentët Ermira Bushi, Ermira Shkreta, Izmira Kastrati, Marinela Bregu, Ornela






Hida dhe Roxher Ibrahim. Studentët pjesëmarrës në këtë konkurs patën mundësinë të venë në praktikë dhe të thellojnë më tej njohuritë e tyre në fushën e të drejtave të njeriut, veçanërisht të atyre të drejtave, që garantohen nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe u njohën më mirë të funksionimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Eventi krijon mundësinë e krijimit të rrjeteve mes juristëve të rinj të fakulteteve të drejtësisë publike dhe private në Shqipëri. Praktika, bashkëpunimi, edukimi, specializimi dhe krijimi i “network-ëve” është një ndër disa nga objektivat afatgjata, që konkursi kërkon të arrijë.

4) *Bedër Law Moot Court – 17 maj 2016*

Klubi studentor “Beder Law Academy” pranë Departamentit të Drejtësisë në Kolegjin Universitar “Bedër”, zhvilloi për të 5-tin vit radhazi gjyqin e improvizuar me studentët e programit bachelor.

Kazusi i këtij viti kishte të bënte me veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë “Prodhimi dhe Shitja e Narkotikëve” e kryer në bashkëpunim. Gjatë seancës gjyqësore të improvizuar nga studentët, organi i akuzës bëri parashtrimet përkatëse duke evidentuar provat shkresore si dhe thirrjen e dëshmitarëve të cilët qartësuan më tej rrethanat e ngjarjes. Ndërkohë pala mbrojtëse ngriti pretendimet për pafajësi të të pandehurve duke u mbështetur po ashtu në prova shkresore si dhe në ekspertiza mjekësore. Në përfundim, gjykata pranoi kërkesën e prokurorisë për dy nga të pandehurit sipas nenit përkatës si dhe shpalli të pafajshëm të pandehurin e mitur.

Ky aktivitet i kthyer tashmë në një traditë për studentët e këtij departamenti, u zhvillua në prani të një numri të konsiderueshëm studentësh dhe pedagogësh.

C. **Brownbag Seminars in Law**


1) *Shaban Nexhi, “E drejta e Informimit” – 19 nëntor 2015*

Drejtori i Qendrës së Përpunimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Z. Shaban Nexhi, ishte i ftuari i radhës në kuadër të ciklit “Brownbag Seminars”.

Gjatë një leksioni të hapur me studentët e Departamentit të Drejtësisë rreth temës: “E drejta e Informimit”. Z. Nexhi foli rreth ligjit përkatës si dhe ndau me studentët histori nga eksperiencia e tij personale.

Trajtimi i temës u zhvillua në disa faza, fillimisht i ftuari njohu të pranishmit me veprimtarinë e institucionit që aktualisht drejton si dhe me bashkëpunimin që ky institucion ka me institucione të tjerë kombëtare dhe ndërkombëtare. Për të vijuar më tej me një përshkrim të detajuar të së drejtës së informimit duke trajtuar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe legjisllacionin vendas.

Aktiviteti vazhdoi më tej me pyetje të shumta nga studentët të cilët shprehën interes për mënyrën e funksionimit të Qendrës së Përpunimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, ecurisë së deritanishme si dhe aspekteve të shumta që lidhen me të.



2) *Bedri Hasani, "Lufta kundër lëndëve narkotike" – 05 nëntor 2015*

Shefi i sektorit të kontrollit në terren dhe marrëdhënies me të tretët Z. Bedri Hasani, ishte i ftuar nga Departamenti i Drejtësisë në kuadër të seminareve "Brownbag", në një bashkëbisedim me studentët rreth luftës kundër narkotikëve.

Në një pasqyrim shpjegues për përdorimin e këtyre lëndëve, Z. Hasani theksoi së vitet e fundit është shënuar një rritje në shkallën 35% të përdorimit të tyre. Kryesisht, të rinjtë e fillojnë përorimin e drogave, për shkak të kureshtjes, për tu bërë pjesë e shoqërisë, për të minimizuar dhimbjen fizike apo psikologjike, për shkak të kushteve të vështira ekonomike etj.

Për të vijuar më tej me raste nga eksperiencat e tij ku përdorimi i drogave tek të rinjtë, i kanë larguar ato nga jeta dhe veprimtaria e përditshme shoqërore.

Si drejtues i programit të USAID-it për luftën kundër lëndëve narkotike në shkollat e mesme, ai theksoi se institucionet e edukimit, duhet të rrisin kompetencat sociale dhe akademike me aftësitë e mëposhtme: i) mbështetje akademike dhe prirje studimi; ii) komunikim; iii) vetë-efikasitet dhe siguri dhe iv) aftësi rezistuese ndaj drogave etj.

Aktiviteti vazhdoi më tej me pyetje të ndryshme nga studentët rreth aspekteve të shumta të kësaj teme.



III. VITI AKADEMIK 2016-2017

A. Konferenca

- 1) *Konferenca Ndërkombëtare në Drejtësi "Korniza ligjore për bashkëpunimin ndërshtetëror në menaxhimin e krizave të emigracionit dhe refugjatëve" – 02.06.2017*

Departamenti i Drejtësisë në Kolegjin Universitar "Bedër", në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Lubllanës, Slloveni, organizuan Konferencën e Parë Ndërkombëtare me temë: "Korniza ligjore për bashkëpunimin ndërshtetëror në menaxhimin e krizave të emigracionit dhe refugjatëve".

Në ceremoninë e hapjes së konferencës ishin të pranishëm zv. Ambasadorja e Republikës së Sllovenisë në Shqipëri, Ms. Masa Šiftari, Prof. Dr. Vasilka Sancin, zv. Dekanja e Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Ljubllanës, rektori i Institucionit Prof. Dr. Ferdinand Gjana, përgjegjësi i Departamentit të Drejtësisë në "Bedër", Dr. Ferdinand Xhaferaj, akademikë të ardhur nga vende të ndryshme të Ballkanit, të ftuar specialë e studentë të shumtë.

Pas fjalës hapëse të kryetarit të konferencës Dr. Xhaferaj, i cili pasi falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në aktivitet dhe palën bashkëpunuese për të vënë në jetë këtë platformë të diskutimit të krizave aktuale në botë që kanë të bëjnë me emigracionin dhe refugjatët i'a la fjalën zv. Ambasadores Šiftari, e cila u shpreh entuziaste për bashkëpunimin e ngushtë jo vetëm në nivel shtetëror por tashmë edhe në nivel akademik ndërinstitucional ndërmjet Sllovenisë dhe Shqipërisë.

Më tej ishte radha e rektorit të Institucionit Prof. Dr. Gjana, i cili pasi ndau me të pranishmit rëndësinë e menaxhimit të krizave të tilla në ditët e sotme, theksoi se e ardhmja e përbashkët duhet të ndërtohet nga kontributi i të gjithëve ne, prandaj gjetja e zgjidhjeve të mundshme për bashkëpunimin ndërshtetëror në menaxhimin e krizave të emigracionit dhe refugjatëve, është mision që duhet konkretizuar sa më parë.

Ndërsa zv. dekania e Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Ljubllanës, Prof. Dr. Vasilka Sancin, njëkohësisht edhe folësjja kryesore e konferencës, gjatë referimit ndau me të pranishmit një sërë problematikash të hasura në menaxhimin e krizave të emigracionit dhe refugjatëve.

Pas përfundimit të ceremonisë së hapjes punimet e konferencës vazhduan më tej në disa sesione të ndryshme paralele ku referuesit pjesëmarrës ndanë me të pranishmit një sërë aspektesh që lidhen jo vetëm me aktualitetin e krizës së emigrantëve, por edhe me zgjidhjet e implementueshme në çdo rast.

Ndër temat e shumta që u trajtuan nga të ftuarit përmendim: "Siguria kombëtare dhe e drejta për azil", "Siguria ndërkombëtare e refugjatëve e parë në kontekstin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut", "Implementimet legale në zgjidhjen e krizave të refugjatëve dhe sfidat për menaxhim", "Parashikimi i emigrimit në ligjet ndërkombëtare" etj.



B. Pjesëmarrja në konkurse ndërkombëtare dhe kombëtare

1) *Konkursi Philip C. Jessup International Law Moot Court Competition – Jessup në Washington Prill 2017*

Shqipëria përfaqësohet për të katërtën herë radhazi në kompeticionin ndërkombëtar "JESSUP" në Washington DC.

Studentët e Departamentit të Drejtësisë në Kolegjin Universitar "Bedër" përfaqësuan edhe këtë vit Shqipërinë në kompeticionin ndërkombëtar "JESSUP Moot Court Competition", konkurs ky i cili zhvillohet çdo vit në Washington të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Pasi kaloi me sukses fazën e parë në Hungari, ekipi i studentëve të drejtësisë u përball në fazën finale në datat 9 – 15 prill të këtij viti me "Universitetin e Kyotos", Japoni, Universitetin e "La Sagesse", Liban, Universitetin "Oetvos Lorand", Hungari si dhe "Ural State University", Rusi.

"Sisters of the sun" mblodhi edhe këtë vit rreth 700 universitete nga 95 vende të botës në fazën e parë të konkursit. Ekipi i studentëve të Bedër, pas performancave mjaft të mira krahasuar këto edhe me vitet e kaluara arriti të renditej në vendin e 107 nga 127 universitete të kualifikuara në fazën finale të kompeticionit.

Departamenti i Drejtësisë falenderon studentët: Anjest Agushi, Albi Çela, Ermelinda Gjeci, dhe Ornela Bego dhe trajnerët Eni Kokalari dhe Gentjan Skara, të cilët na përfaqësuan denjësisht me paraqitjen e tyre, rezultat i cili është fryt i besimit tek fryma e skuadrës dhe punës së përshtur.

Skuadra e "Bedër" është e vetmja që përfaqësohet në këtë kompeticion prestigjioz nga Shqipëria duke bërë paraqitje mjaft të vlerësuara edhe në 3 vitet e kaluara si dhe duke ngritur traditën e gjyqeve Moot Court në Shqipëri.

2) *Konkursi i Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve në Hagë – ICC Moot Court Competition, Maj 2017*

Për të katërtën herë radhazi studentët e Departamentit të Drejtësisë në "Bedër", marrin pjesë në kompeticionin më të rëndësishëm për të Drejtën Ndërkombëtare Penale "ICC Moot Court Competition", kompeticion ky i cili organizohet nga Universiteti i Leiden, Gjykata Ndërkombëtare Penale dhe "The Grotius Centre for International Legal Studies" në Holandë.

Kjo garë konsiston në një program 6 ditor edukativ dhe social i cili mbledh sëbashku studentë nga kultura të ndryshme të botës, të cilët konkurojnë midis tyre rreth çështjeve të caktuara më parë nga kjo gjykatë.

Ekipi i studentëve të "Bedër" i përbërë nga: Klara Haxhiu, Redneks Dushi, Dudi Ilias, Elvis Gjeci si dhe koordinatori i grupit Dr. Nertil Bërdufi, morën pjesë në këtë edicion së bashku me rreth 65 ekipe të tjera nga 50 shtete të ndryshme të botës, ku prezantuan memorialet e tyre rreth: "Situation relating to Valaria".






3) *Gjyqi Simulues i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – Shqipëri 2017 – Dhjetor 2016*

“Gjyqi Simulues i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – Shqipëri 2017” është një konkurs i cili u organizua nga Qendra Evropiane në bashkëpunim me Civil Rights Defenders. Ky event mbledh studentë të ligjit, mbrojtësit e ardhshëm të të drejtave të njeriut, duke i grupuar ata në skuadra. Këto skuadra marrin pjesë në gjyqet e simuluar të GJEDNJ-së, përpara një jurie të përbërë nga gjyqtarë ekspert mbi të drejtat e njeriut.

Gjashtë universitete të drejtësisë në vend, të përzgjedhura në bazë të një rregullorje dhe kriterëve të mirëpërcaktuara u “përballën” me njëri-tjetrin. Kolegji Universitar “Bedër” u përfaqësua nga studentët Monika Kanaci, Olivia Belishaku, Fatjon Laqi, Anxhela Buzi, Daril Elmasllari dhe Klara Haxhiu. Studentët pjesëmarrës në këtë konkurs patën mundësinë të venë në praktikë dhe të thellojnë më tej njohuritë e tyre në fushën e të drejtave të njeriut, veçanërisht të atyre të drejtave, që garantohen nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe u njohën më mirë të funksionimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ).

Eventi krijon mundësinë e krijimit të rrjeteve mes juristëve të rinj të fakulteteve të drejtësisë publike dhe private në Shqipëri. Praktika, bashkëpunimi, edukimi, specializimi dhe krijimi i “netëork-ëve” është një ndër disa nga objektivat afatgjata, që konkursi kërkon të arrijë.

4) *Public Pleading of JESSUP Moot Court Competition – 04 prill 2017*

Studentët e Departamentit të Drejtësisë, pjesëmarrës në Kompeticionin Ndërkombëtar JESSUP Moot Court Competition, organizuan “Public Pleading” në kuadër të fazës përgatitore të raundeve ndërkombëtare në Washington DC.

Aktiviteti konsistoi në një inskenim të çështjes me të cilën grupi i studentëve të drejtësisë do të përfaqësojnë Shqipërinë në këtë edicion të kompeticionit.

Të gjendur përballë 3 gjyqtarëve, studentët parashtruan argumentat e përgatitura rreth “Case Concerning the Sisters of the Sun” që përfshin tema nga e drejta e ujërave ndërkombëtare, e drejta mbi refugjatët, trashëgiminë kulturore etj.

C. Brownbag Seminars in Law

1) *Oerd Bylykbashi, “Reforma Zgjedhore në Shqipëri” – 04 nentor 2016*

Bashkëkryetari i Komisionit Parlamentar për reformën zgjedhore, z. Oerd Bylykbashi, ishte i pranishëm në një bashkëbisedim me studentët e Departamentit të Drejtësisë në kuadër të Reformës Zgjedhore.

I ftuar nga Klubi studentor “Beder Law Academy” fillimisht, z. Bylykbashi bëri një analizë teknike të përgjithshme të sistemeve të ndryshme zgjedhore duke përmendur avantazhet dhe disavantazhet e tyre si në kuptimin doktrinar ashtu edhe në aspektin praktik. Aspekt në të cilin ai trajtoi disa raste konkrete në mënyrë që studentët të ishin më të qartë në ndikimin që ka zbatimi i sistemeve zgjedhore përkatëse në kontekstin politik të vendit tonë.

“Në mendimin tim, reforma zgjedhore në Shqipëri është akoma më e rëndësishme se reforma në drejtësi, duke marrë parasysh situatën politike në të cilën ndodhemi” -tha z. Bylykbashi gjatë prezantimit të ecurisë së deritanishme të kësaj reforme.

Ai u shpreh se për reformën zgjedhore nevojitet një vullnet i fortë nga të gjitha palët politike që të arrihet një reformë efektive dhe për pasojë të shmangen problemet që kanë shoqëruar proceset zgjedhore gjatë gjithë periudhës së tranzicionit.

Ndër të tjera, z. Bylykbashi bëri edhe një prezantim të sfidave dhe problemeve që ka hasur në punën e tij si bashkëkryetar i Komisionit Parlamentar për reformën zgjedhore. Aktiviteti vazhdoi më tej me pyetjet e studentëve ku nuk u la pa u përmendur edhe çështja e korrupsionit e cila ka ndikuar shumë në procesin e zgjedhjeve.

2) *Klevis Balliu, “Brexit dhe e Ardhmja e Bashkimit Evropian” – 27 janar 2017*

“Brexit dhe e Ardhmja e Bashkimit Evropian” ishte tema kryesore e bashkëbisedimit ndërmjet Këshilltarit të Presidentit të Republikës për çështje diplomatike, dhe studentëve të Departamentit të Drejtësisë në Kolegjin Universitar “Bedër”.

I ftuar nga klubi studentor “Bedër Law Academy” në kuadër të ciklit të seminareve “Brownbag” Z. Balliu, gjatë referimit të tij u ndal tek shkaqet kryesore që sollën daljen e Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian. Sipas tij, qytetarët votuan pro daljes nga Bashkimi Evropian duke u mbështetur më shumë në arsye nacionaliste sesa politike apo ekonomike. Më tej ai shpjegoi ndikimin e theksuar negativ që shkaktoi dalja nga Bashkimi Evropian kundrejt ekonomisë dhe politikave të Britanisë së Madhe.

Gjatë bashkëbisedimit, duke iu përgjigjur edhe interesit të studentëve, z. Balliu bëri edhe një analizë të çështjeve aktuale në rajon. Një tjetër pikë e rëndësishme e takimit ishin marrëdhëniet Kosovë-Serbi dhe rëndësia e negociatave mes këtyre dy shteteve.


Aktiviteti vazhdoi më tej me pyetje të shumta nga të pranishmit.


3) *Saimir Vishaj, “Reforma në Drejtësi dhe Çështjet e Avokaturës” – 01 shkurt 2017*

“Reforma në Drejtësi dhe Çështjet e Avokaturës” ishte tema kryesore e bashkëbisedimit ndërmjet Kryetarit të Shoqatës së Avokatëve Penalistë, dhe studentëve të Departamentit të Drejtësisë në Kolegjin Universitar Bedër.

I ftuar nga klubi studentor “Bedër Law Academy” në kuadër të ciklit të seminareve “Brownbag” z. Saimir Vishaj, gjatë referimit të tij u ndal tek shkaqet kryesore që sollën reformën në drejtësi si dhe perspektiva e saj në të ardhmen.

Sipas tij, reforma ishte një hap i domosdoshëm por ajo që pritet të ndryshojë dhe duhet të ndryshojë te sistemi i drejtësisë është mendësia e tyre.



Gjatë bashkëbisedimit, duke iu përgjigjur edhe interesit të studentëve, z. Vishaj bëri edhe një analizë të sistemit të drejtësisë penale si dhe domosdoshmërisë së ndryshimeve të Kodit Penal dhe atij të Procedurës Penale.

4) *“Reforma në Drejtësi dhe ndikimet e saj” – 20 Prill 2017*

Në kuadër të lëndës "Tema specifike në Drejtësi" dhe aktualitetit juridiko - politik të vendit, studentët e vitit të parë "Master i shkencave" - E drejtë penale, zhvilluan seminarin me temë "Reforma në Drejtësi dhe ndikimet e saj".

Gjatë këtij seminari, studentët referuan mbi tematika sa specifike po aq edhe aktuale në lidhje me reformën, duke bërë një analizim kritik të saj.

Në aktivitet ishin të pranishëm rektori i institucionit Prof. Dr. Ferdinand Gjana, përgjegjësi i Departamentit të Drejtësisë, Dr. Ferdinand Xhaferaj, pedagogë, gazetarë, studentë dhe të ftuar, ku të gjithë në mënyrë interaktive u bënë pjesë e referimit të studentëve.

5) *“Kanali i Korfuzit dhe impakti i tij në të drejtën ndërkombëtare” – 11 Maj 2017*

Klubi studentor "Bedër Law Academy" në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë, nisin seancat e bashkëbisedimit mbi çështjet më të rëndësishme të gjykuara ndonjëherë nga Gykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (International Court of Justice).

Qëllimi i kësaj nisme nga studentët është që të kuptojnë rolin e Gygatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare. Në këtë kontekst, çështja e parë që u diskutua nga studentët ishte ajo e "Kanalit të Korfuzit" dhe impaktit që kjo pati në zhvillimin e të drejtës ndërkombëtare. Relatori i çështjes ishte Albi Çela, student i vitit të parë në programin Master i Shkencave në Drejtësi, profili e drejtë Ndërkombëtare.

Kjo nismë pritet që të vazhdojë dhe në javët në vijim ku studentë të tjerë të Departamentit të Drejtësisë do të prezantojnë çështje të tjera të Gygatës Ndërkombëtare të Drejtësisë por jo vetëm, pasi në fokus do të jetë dhe Gykata Evropiane e Drejtësisë dhe ajo e të Drejtave të Njeriut.

6) *“Eksperienca në gjyqet simuluese nderkombëtare” – 29 Maj 2017*

Edhe këtë vit, Departamenti i Drejtësisë pranë Kolegjit Universitar "Bedër", u përfaqësua denjësisht në kompeticionet ndërkombëtare International Criminal Court Moot Court Competition 2017 të mbajtur në Hagë dhe JESSUP Moot Court Competition 2017, konkurs ky i cili zhvillohet çdo vit në Washington të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Qëllimi i këtij eventit është ndarja e eksperiencës së përfituar nga studentet, Dudi Ilias dhe Anjest Agushi, në këto dy kompeticione mjaft prestigjioze.

IV. VITI AKADEMIK 2017 - 2018

A. Pjesëmarrja në konkurse ndërkombëtare dhe kombëtare

1) *Jessup Public Pleading - 26 Mar 2018*

Studentët e Departamentit të Drejtësisë, pjesëmarrës në Kompeticionin Ndërkombëtar "Philip C. JESSUP International Law Moot Court Competition", organizuan "Public Pleading" në kuadër të fazës përgatitore të raundeve ndërkombëtare në Washington DC.

Aktiviteti konsistoi në një inskenim të çështjes me të cilën grupi i studentëve të drejtësisë të përbërë nga: Albi Çela, Anjest Agushi, Ornela Bego, Thoma Kristo dhe Ermelinda Gjeci përfaqësuan Shqipërinë në këtë edicion të kompeticionit.

Të gjendur përballë gjyqtarëve të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, studentët parashtruan argumentat e përgatitura rreth "Case Concerning the Egart and the Ibra" që përfshin tema nga vlefshmëria e një vendimi arbitrazhi ndërshtetëror, sovraniteti, cënimi i ujërave territoriale, regjimi i carmatosjes bërthamore, përdorimi i forcës, e drejta humanitare ndërkombëtare etj.

Me këtë aktivitet u synua jo vetëm ndërgjegjësimi i studentëve të tjerë të departamentit të drejtësisë rreth kompeticionit në fjalë, por edhe angazhimi i tyre në projekte të tjera të ngjashme.


2) *Konkursi Philip C. Jessup International Law Moot Court Competition – Jessup në Washington - 1 Prill – 7 Prill 2018*

Shqipëria përfaqësohet për të katërtën herë radhazi në kompeticionin ndërkombëtar "JESSUP" në Washington DC. Studentët e Departamentit të Drejtësisë në Kolegjin Universitar "Bedër" përfaqësuan edhe këtë vit Shqipërinë në kompeticionin ndërkombëtar "JESSUP Moot Court Competition", konkurs ky i cili zhvillohet çdo vit në Washington të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Edhe këtë vit kompeticioni mbledhi rreth 700 universitete nga 95 vende të botës në fazën e parë të konkursit. Ekipi i studentëve të Bedër, pas performancave mjaft të mira krahasuar këto edhe me vitet e kaluara arriti të renditej në vendin e 107 nga 127 universitete të kualifikuara në fazën finale të kompeticionit.

Departamenti i Drejtësisë falenderon studentët: Anjest Agushi, Albi Çela, Ermelinda Gjeci, Ornela Bego, Thoma Kristo dhe trajnerët Daniel Klingenberg dhe Gentjan Skara, të cilët na përfaqësuan denjësisht me paraqitjen e tyre, rezultat i cili është fryt i besimit tek fryma e skuadrës dhe punës së pareshtur.

Skuadra e "Bedër" është e vetmja që përfaqësohet në këtë kompeticion prestigjioz nga Shqipëria duke bërë paraqitje mjaft të vlerësuara edhe në 3 vitet e kaluara si dhe duke ngritur traditën e gjyqeve Moot Court në Shqipëri.



3) *Gjyqin Simulues të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut - 14 dhjetor 2017*

Studentët e Departamentit të Drejtësisë fituan të drejtën e pjesëmarrjes për vitin e tretë rradhazi në konkursin “Gjyq Stimulues i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut”, të organizuar nga Qendra Evropiane dhe Civil Rights Defenders në Shqipëri.

Jeton Kalemi, Fjoralba Markja, Erisa Datja, Bruno Tetova, Ridvan Balliu dhe Migena Xhaferaj, nën udhëheqjen e lektores Ermira Bushi, ishin studentët e kualifikuar për në fazën gjysmë-finale, si 6 më të mirët pas konkurimit me universitetet e tjera në rang vendi.

Ky aktivitet kishte për qëllim simulimin e një procedure të ngjashme me atë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, si dhe përmirësimin e aftësive praktike të studentëve për të mbrojtur përpara një trupi gjykues një çështje të caktuar.

Faza gjysmë-finale u zhvillua më datë 16 dhjetor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

4) *Gjyqi Simulues kombëtar organizuar në kuadër të lëndës “Comparative Legal system” – 9 shkurt 2018*

Në kuadër të lëndës “Sisteme Ligjore të Krahasuara”, studentët e vitit të tretë bachelor të Departamentit të Drejtësisë, organizuan një gjyq simulues me qëllim zbatimin në praktikë të leksioneve që marrin në klasë dhe përshtatjen e tyre me situatat e botës reale.


Gjykimi nga një gjyqtar dhe gjykimi i jurisë, është një nga dallimet kryesore të Civil Law dhe Common Law, prandaj është e rëndësishme të kuptohen dallimet midis tyre në mënyrë që të kuptohet më qartë dhe mënyra se si funksionojnë këto dy sisteme ligjore. Gjyqi simulues përmbante pjesën më të madhe të elementeve të një gjykimi real, duke përfshirë trajtimin e dëshmitarëve dhe dëshmimeve, si dhe dhënien e argumenteve përpara një jurie, e cila do të japë verdiktin përfundimtar.

Nëpërmjet këtij projekti studentët patën mundësi të shikojnë në praktikë, mënyrën se si të argumentohet në rastet përpara një jurie dhe të kuptojnë mënyrën se si funksionon gjykimi me juri. Gjyqi simulues u organizua me mbështetjen e studentëve nga Departamenti i Shkencave Islame, Departamenti i Gjuhës dhe Letërisë Angleze, Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit, studentët e të cilëve ishin anëtarë të jurisë gjyquese.

Në fund të gjyqit simulues, anëtarët e jurisë pas një diskutimi të gjatë dhanë edhe verdiktin përfundimtar mbi rastin e trajtuar.

5) *Gjyqi simulues organizuar nga Ambasada Amerikane*

Ambasada Amerikane në muajin maj 2018 organizoi një gjyq simulues. Studentë nga universitete të ndryshme u trajnuan për rreth një javë nga specialist i programit Fulbright në Shqipëri Gjyqtari Czuleger nga Gjykata e Lartë në Los Anxhelos dhe Fullbright Fellow Daniel Klingeberg, PhD of Arizona State University.



6) *EU Institutions Simulations – organised by European Movement Albania*

Studentët e vitit të dytë, Thoma Kristo dhe Erisa Datja morrën pjesë në “European Union Institutions Simulation Tirana 2018”, e organizuar nga European Movement Albania me mbështetjen e Komisionit Evropian dhe European Movement International.

B. Brownbag Seminars in Law

1) *Lavdrim Lita. “Impakti i reformave në drejtësi” - 24 Nëntor 2017*

Në kuadër të ciklit “Brownbag Seminars”, z. Lavdrim Lita, përfaqësues i shoqërisë civile, ishte i ftuar nga klubi studentor “Bedër Law Academy” në një leksion të hapur ku ndau me studentët dhe të pranishmit pikëpamjet rreth temës “Impakti i reformave në drejtësi”.

2) *Daniel Klingenberg, “Language, Culture and History in the Rule of Law” - 11 Janar 2018*

Në kuadër të vazhdimet të cikleve “Brownbag Seminars”, i ftuar nga klubi studentor “Bedër Law Students Association” ishte z. Daniel Klingenberg, i cili ndau me studentët e drejtësisë eksperiencat e tij gjatë kërkimit shkencor për ndikimin e gjuhës, kulturës dhe historisë në forcimin e shtetit ligjor.

Në bashkëbisedimin me studentët Kolegjit Universitar “Bedër” Z. Klingenberg parashtrori disa nga elementët që e dallojnë popullin shqiptar nga popujt e tjerë nëpër botë, si dhe problematikat që hasen në forcimin e shtetit ligjor. Ndërkohë që shfaqti një simpati të veçantë për historinë dhe mitet që tregojnë formimin e popullit tonë.

“Shqiptarët duhet të dinë se askush përveç tyre nuk mund ta dojë më shumë Shqipërinë, ata duhet ta ndërtojnë vetë vendin e tyre”, shtoi ai.

Në fund të takimit studentët shprehën mendimet e tyre në lidhje me temën, si dhe nuk munguan pyetjet për kërkimin shkencor të Z. Klingenberg.

3) *Gledis Gjipali, “Procesi i integritimit Evropian në Shqipëri dhe Rajon: Roli i shoqërisë civile” - 18 Janar 2018*

I ftuari i radhës nga klubi studentor “Bedër Law Students Association” në kuadër të ciklit “Brownbag Seminars” ishte Drejtori Ekzekutiv i European Movement Albania Z. Gledis Gjipali. Në një bashkëbisedim me studentët e drejtësisë, Z. Gjipali parashtrori disa nga elementët juridikë që e pengojnë Shqipëri që të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian.

“Ne kemi ecur përpara, pavarësisht uljeve dhe ngritjeve që kemi pasur, arritja për t’u bërë gati për integrimin është një proces që bëhet avash”, - shtoi ndër të tjera Z. Gledis Gjipali. Gjithashtu theksoi se angazhimi dhe kërkimi i së drejtës nga qytetarët shqiptarë është shumë i rëndësishëm për përparimin e vendit tonë.

Duke u nisur edhe nga interesi i studentëve të drejtësisë, drejtori i EMA-s, shpjegoi edhe elementët me të cilat organizata e tij ndihmonte në procesin e integritimit në BE duke promovuar vlerat demokratike gjatë procesit të hartimit të politikave. Nërkohë që prezantoi përpara

studentëve edhe faqen zyrtare të organizatës, e cila përmbante artikuj të ndryshëm juridik dhe jo vetëm, nga ku studentët mund të sigurojnë informacione në fushat që iu interesojnë.

Në fund të takimit studentët ndanë mendimet e tyre dhe parashtruan pyetje në lidhje me procesin e integritetit.

4) *Shfaqja e filmit "All Rise" në ambientet e universitetit për të gjithë studentët e departamentit të drejtësisë - 20 janar 2018*

Filmi "All Rise" flet për eksperimentin e ekipeve të ndryshme në kompeticionin më prestigjios në të drejtën ndërkombëtare "Philip C. Jessup International Law Moot Court Competition – Jessup" që organizohet në Washington DC. Pas shfaqjes së filmit studentët patën mundësi që të njiheshin më shumë rreth kompeticionit duke diskutuar me studentët pjesëmarrës.

5) *Ana Kovacevic, "The role of NDI in Albania" - 25 Janar 2018*

Në vijim të takimeve Brownbag Seminars, e ftuar ishte Znj. Ana Kovacevic, Drejtuese e NDI Albania - National Democratic Institute. Gjatë takimit me studentet e drejtësisë, Znj. Kovacevic prezantoi organizatën për t'u fokusuar më pas në një diskutim të hapur me studentët dhe pjesëmarrjen e tyre në politikëbërje dhe vendimmarrje. Temat kryesore që u prekën ishin angazhimi i grave dhe vajzave në politikë, rritja e rolit të rinjve në politike si dhe rrugët alternative për rritjen e këtij roli. Takimi ishte një frymëzim për studentët e drejtësisë për të dhënë kontributin e tyre në zhvillimin e mëtejshëm të demokracisë në vend.

6) *Oerd Bylykbashi, "Reforma Zgjedhore" - 20 Mars 2018*

Në vijim të takimeve Brownbag Seminars, i ftuar ishte z. Oerd Bylykbashi. Gjatë takimit me studentet e drejtësisë, ai bëri një prezantim të reformës zgjedhore dhe elementeve të diskutueshëm të këtij procesi. Pas prezantimit u zhvillua një diskutim me studentët në lidhje me reformën zgjedhore, por edhe për pjesëmarrjen e tyre në politikëbërje dhe vendimmarrje.

7) *Stephen Czuleger, "Etika Gjyqësore - Shmangia e dështimeve" - 22 Maj 2018*

Anëtari i Gjykatës së Lartë të Los Anxhelosit, Stephen Czuleger, ishte i ftuari radhës në një seminar me studentët e drejtësisë në "Bedër", për të bashkëbiseduar me ta rreth temës: "Etika Gjyqësore - Shmangia e dështimeve".

Gjatë prezantimit, gjyqtari Czuleger i njohu studentët e drejtësisë me parashikimet e legjislacionit amerikan në kuadër të rregullave të etikës që duhen zbatuar nga gjyqtari gjatë ushtrimit të detyrës së tij. Ai u fokusua veçanërisht në çështje të etikës, paanshmërisë dhe profesionalizmit të figurës së gjyqtarit.

Gjyqtari Czuleger trajtoi edhe çështjen e korrupsionit në sistemin gjyqësor. Ai vlerësoi faktin se, pavarësisht ekzistencës së këtij fenomeni, shqiptarët janë të vendosur për të ndryshuar gjendjen aktuale dhe tregues për këtë është procesi i vetingut. Duke vlerësuar progresin e deritanishëm në luftën kundër korrupsionit, Czuleger u shpreh optimist për të ardhmen dhe nxiti të rinjtë të angazhohen në këtë proces.

Në përfundim të seminarit u zhvillua një diskutim me studentët në lidhje me sfidat që përballen sistemi i drejtësisë në Shqipëri dhe alternativat për përmirësimin e tij. Gjyqtari Czuleger inkurajoi të gjithë studentët të bëhen pjesë aktive e këtyre ndryshimeve dhe të zbatojnë rregullat e etikës profesionale me qëllim përmirësimin e performancës së sistemit të drejtësisë dhe rritjen e besimit të publikut.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1. Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2. Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Kriteri 1: Siç vërtetohet dhe nga Raportet Vjetore dorëzuar pranë MASR, në Raportin e Aktiviteteve dhe faqen zyrtare të institucionit personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse. Kjo mund të vërehet edhe në tabelën e mësipërme, e cila pasqyron publikimet stafit akademik.</p> <p>Kriteri 2: Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari dhe organizimeve të konferencave të ndryshme shkencore dhe workshopeve jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës dhe në zhvillimin e sektorëve të shërbimit.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1. Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2. Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Kriteri 1: Siç vërtetohet dhe nga dosjet e stafit akademik pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certifikatë për njohje të avancuar të saj.</p> <p>Kriteri 2: Siç vërtetohet dhe nga dosjet e stafit akademik pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit kërkimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2. Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij kërkimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Kriteri 1: Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit kërkimor-shkencor si trajnime të brendshme, workshope, një pjesë e të cilave mund të gjenden në faqen e NJSBC.⁷³</p> <p>Kriteri 2: KUB u ofron personelit akademik dhe atij kërkimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit duke e mbështur ata edhe financiarisht gjatë këtyre programeve. Zyra e Kërkimit Shkencor si dhe Zyra Marrëdhënieve Ndërkombëtare mbështetin personelin gjatë procedurave që duhen ndjekur.</p>
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	

⁷³ Evidenca nr. 32 – Lista e trajnimeve të stafit akademik dhe administrativ

<p>Kriteri 1. Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2. Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3. Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Kriteri 1: Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2: Bazuar në misionin e KUB, i cili vlerëson mbështetjen e kërkimit shkencor me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë. KUB, me anë të Rregullores mbi Nxitjen e Publikimit dhe Kërkimit Shkencor, mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, si dhe shpërblen performancën akademike vjetore mbi indikatorë transparentë të parashikuar në rregulloren përkatëse në bazë të dhënave për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Kriteri 3: Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi. Këto depozitohen pranë Zyrës së Kërkimit Shkencor të KUB.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Pas përfundimit të raportit të hartuar, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) rishikoi të gjitha publikimet dhe aktivitetet, konstatoi se siç vërtetohet dhe nga Raportet Vjetore të dorëzuara pranë MASR dhe në Raportin e Aktiviteteve, personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse. Personeli akademik nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari dhe organizimeve të konferencave të ndryshme shkencore dhe workshopeve jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës dhe në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit. KUB ofron programe mësimdhënieje në gjuhën angleze, me një personel akademik të kualifikuar dhe angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij. Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi. KUB, me anë të rregullores mbi Promovimin e Publikimit dhe Kërkimit Shkencor, mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, si dhe shpërblen performancën akademike vjetore mbi indikatorë transparentë të parashikuar në rregulloren përkatëse në bazë të dhënave për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi. GVB konstaton se programi në fjalë i përbush plotësisht kriteret e kërkuara.</p>	



11- Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Që nga themelimi i KUB, një ndër objektivat e saj ka qenë promovimi ndërkombëtar, si dhe vendosja e marrëdhënieve të ngushta me institucionet e arsimit të lartë në rajon dhe më gjerë. Për të realizuar këtë qëllim në vitin 2011 u themelua Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. KUB ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për realizimin e misionit dhe të qëllimit të tij. KUB ndjek një politikë favorizuese me institucionet e huaja arsimore, me të cilat ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për gatishmërinë e personelit akademik dhe të studentëve, organizimin e përbashkët të konferencave dhe projekteve, si edhe trajnimet profesionale dhe praktikat studentore. Aktualisht institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me rreth 99 institucione, mes të cilave universitete, bashki, institucione publike dhe private. Strategjia për bashkëpunimet e mundshme pasqyrohet në strategjinë afatgjatë të zhvillimit të Institucionit. KUB bashkëpunon me institucione të tjera për ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve. Këto shërbime variojnë në bazë të nevojave, si ato shëndetësore, strehimi në konvikte, profesionale etj. Në kuadër të plotësimit të nevojave të veta në funksionim të programeve të studimeve, KUB ka nënshkruar disa marrëveshje me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit . Një rëndësi të veçantë kanë edhe marrëveshjet e nënshkruara me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, për realizimin e praktikave të ndryshme profesionale.

Marrëdhëniet me tregun e punës dhe biznesin





Që nga themelimi i KUB, i është vënë rëndësi zbatimit të dijeve të përfuara gjatë procesit të mësimdhënies, që do t'u mundësojë studentëve të krijojnë lidhje me kërkesat e tregut vendas të punës, duke filluar nga studimet e tyre universitare. Në këtë drejtim, rëndësi e veçantë i është dhënë organizimit të praktikave për studentët në institucione të ndryshme publike, si dhe në kompani private si brenda dhe jashtë Shqipërisë, kryesisht gjatë sezonit të verës.

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Tabela 24: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Aktivitete shkencore individuale dhe në rang Programi studimi në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në vitet e fundit		
1	Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare	4
2	Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj ose orë mësimore)	20
3	Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	4
4	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL	5
5	Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	6
6	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	115
7	Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	7

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

Tabela 25: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese


Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese	
Institucionet bashkëpunuese:	Lloji i bashkëpunimit
Universiteti Pammukale	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Yildiz Teknik	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Suleyman Şah	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Fatih	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Epoka	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Ondokuz Mayiz	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Gediz	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Ndërkombëtar Burch	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Ordu	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Ataturk	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti i Prizrenit	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Hitit	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Kolegji Amerikan Islamik	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Nigerian Turk Nile	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Diponegro	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Kolegji Amerikano - Verior	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Vistula	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Qafqaz	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Widyatama	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore

Universiteti Selangor	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Mansoura	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti i Gjirokastrës “Eqerem Çabej”	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti i Tiranës	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Izmir Katip	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Ishik	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Agora	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Danubius	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Ndërkombëtar i Detit të Zi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Zhytomyr Ivan Franko	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Mehmet AKIF	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti i Pensilvanisë Kaliforni	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Mohammed V Agdal Rabat	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Eastern Mediterranean	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti i Romës “Tor Vergata”	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti i Ljubljanes	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti i Kalabrisë	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Teknik i Lindjes së Mesme	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti i Barit	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Abant Izzet Baysal	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Benedictine	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti Mother Theresa	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu”	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Shkolla e Magjistraturës e Shqipërisë	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore

Zhejiang University of Science and Technology	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Zhejiang Normal University	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore
Ministria e Punëve të Brendshme, Republika e Shqipërisë	Trajnime për stafin, Praktika studentore, Projekte të përbashkëta në fushën e drejtësisë
Bashkia Elbasan	Trajnime për stafin, Praktika studentore, Projekte të përbashkëta në fushën e drejtësisë
Bashkia Gjirokastrë	Trajnime për stafin, Praktika studentore, Projekte të përbashkëta në fushën e drejtësisë
Bashkia Kukës	Trajnime për stafin, Praktika studentore, Projekte të përbashkëta në fushën e drejtësisë
Bashkia Devoll	Trajnime për stafin, Praktika studentore, Projekte të përbashkëta në fushën e drejtësisë
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Trajnime për stafin, Praktika studentore, Projekte të përbashkëta në fushën e drejtësisë
Kuvendi i Republikës së Shqipërisë	Trajnime për stafin, Praktika studentore, Projekte të përbashkëta në fushën e drejtësisë
Bashkia Tiranës	Trajnime për stafin, Praktika studentore, Projekte të përbashkëta në fushën e drejtësisë
Bashkia Kavajë	Trajnime për stafin, Praktika studentore, Projekte të përbashkëta në fushën e drejtësisë
Bashkia Korçë	Trajnime për stafin, Praktika studentore, Projekte të përbashkëta në fushën e drejtësisë
Organizatrat Profesionale:	
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Trajnime për stafin, Praktika studentore, Projekte të përbashkëta në fushën e drejtësisë
Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Trajnime për stafin, Praktika studentore, Projekte të përbashkëta në fushën e drejtësisë
Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier	Trajnime për stafin, Praktika studentore, Projekte të përbashkëta në fushën e drejtësisë
Shoqata e penalistëve shqiptarë	Trajnime për stafin, Praktika studentore, Projekte të përbashkëta në fushën e drejtësisë
Shërbimi i Provës	Trajnime për stafin, Praktika studentore, Projekte të përbashkëta në fushën e drejtësisë
Komuniteti i biznesit, tregu i punës:	
Univers – ALB sh.a.(Spitali Amerikan)	Marrëveshje Bashkëpunimi për kartën vital
ACITAD	Marrëveshje Bashkëpunimi për Trajnime, Praktika Studentore, Projekte, Bursa Studentore
Studio Pëmbarrimore BEST 2000	Marrëveshje Bashkëpunimi për Trajnime, Praktika Studentore, Projekte, Bursa Studentore
Studio Ligjore “Qinami”	Marrëveshje Bashkëpunimi për Trajnime, Praktika Studentore, Projekte, Bursa Studentore

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1. Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2. Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Kriteri 1: Aktualisht, Departamenti i Drejtësisë nuk ofron program studimi “Master profesional”, por “Master i shkencave”. Megjithatë, institucioni i kushton një rëndësi të veçantë bashkëpunimit me institucione të tjera për mundësim të praktikave dhe trajnimeve të ndryshme, si mundësi për sigurimin e vendëve të punës pas diplomimit.</p> <p>Kriteri 2: Edhe pse ky program studimi nuk përmban si lëndë praktikat profesionale dhe është i orientuar drejt kërkimit shkencor, siç vërtetohet nga marrëveshjet institucionale të bashkëpunimit, për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i shkencave”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1. Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2. Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Kriteri 1: Për mbikëqyrjen dhe zhvillimin e programit, departamenti bashkëpunon intensivisht me të gjitha njësitë brenda institucionit, të tilla si, Zyra e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Marrëdhënieve me Studentin, Biblioteka, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, etj. Gjithashtu një rëndësi e veçantë i kushtohet edhe bashkëpunimit me Rektoratin, i cili përcakton një grup “ad-hoc” për vlerësim të jashtëm të procesit administrativ të Departamentit. Nga ana tjetër, rëndësi e veçantë i kushtohet komunikimit të brendshëm me personelin efektiv dhe atë me kohë të pjesshme. Sekretaria e departamentit bën njoftime periodike në lidhje me mbarëvajtjen e programit të studimit, si dhe rikujton të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik në momente të caktuara.</p> <p>Kriteri 2: Kompetencat dhe ndarja e detyrave të personeli është i parashikuar në Rregulloren e Organizimit Administrativ, e cila mundëson marrjen e përgjegjësisë përkatëse dhe analizën e vazhdueshme të punës së tyre dhe garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi. Detyrat e çdo anëtarit të stafit akademik dhe administrativ parashikohen gjithashtu edhe në përshkrimin e punës për çdo pozicion. Kjo gjë ndihmon edhe në mbarëvajtjen e procesit, por edhe në ndarjen më të mirë të punës midis anëtarëve të stafit.</p>





Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Kriteri 1. Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

Kriteri 2. Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 3. Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtjshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4. Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Kriteri 1: Për realizimin e objektivave të programeve të studimeve, institucioni dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe me aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Me institucionet arsimore të huaja që ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndjek një politikë favorizuese për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe të studentëve të huaj, për organizimin e përbashkët të konferencave ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkëta kërkimore dhe për trajnime profesionale e praktika studentore.

Kriteri 2: KUB i kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale. Prandaj, gjatë verës studentët nxiten dhe iu ofrohet mundësia të ndjekin praktika mësimore në formë stazhi.



Kriteri 3: KUB duke u bazuar në Deklaratën e Bolonjës, nevojat e tregut në vend, rajon dhe më gjerë, nxit frymën e formimit të vazhdueshëm. Në këtë kuadër, KUB ofron një varg metodash dhe modulesh që synojnë zhvillimin e mëtjshëm individual dhe mosshkëputjen nga mjedisi arsimor.

Formimi i vazhdueshëm është një çështje së cilës i jepet përparësi edhe në planin strategjik institucional si dhe mbështetet nga NJSBC. Disa nga trajnimet e organizuara mund të gjenden në faqen e NJSBC.

Kriteri 4: Aktualisht, KUB nuk e ka konsideruar si të domosdoshme marrjen e shërbimeve nga palët e treta, për realizimin e programeve të studimit, duke i plotësuar këto nevoja me resurset e veta.

Konkluzionet e vlerësimit:

Pas përfundimit të raportit të hartuar, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) diskutoi në mënyrë të hollësishme përputhshmërinë me kërkesat e përfshira në kriteret e përcaktuara dhe konstatoi se institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij duke miratuar atë me konsensus. Nga ana tjetër u arrit në përfundimin se KUB ndjek politika të qarta për informimin e personelit në lidhje me detyrime, të drejtat dhe përgjegjësisë që të kanë ata në realizimin me sukses të programit të studimit. Kjo tregon se KUB garanton kolegjalitetin në funksionimin e organizmave të brendshëm si dhe marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit. GVB konstaton se programi në fjalë i **përbush plotësisht kriteret** e kërkuara.


ANALIZA SWOT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

(Grupi shprehet për plotësimin/mosplotësimin/plotësimin e pjesëshëm të rekomandimeve)

Gjatë periudhës pas procesit të parë të akreditimit, Departamenti i Drejtësisë, është angazhuar me seriozitet për adresimin dhe përmbushjen e rekomandimeve të lëna në lidhje me programin e studimit “Master i shkencave” në Drejtësi.

Siç vihet re edhe nga përgjigjja e detajuar në lidhje me përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit, institucioni ka përmbushur plotësisht rekomandimin në lidhje me nivelin e kërkuar për kualifikimin e brendshëm dhe të jashtëm akademik, numrin e titujve dhe botimet bashkohore në institucionet. Në këto vite është bërë përpjekje e vazhdueshme dhe krijuar ura bashkëpunimi, për të rritur eksperiencën e stafit të brendshëm dhe të jashtëm akademik dhe krijuar një departament dhe një program mësimor të qëndrueshëm dhe të besueshëm.

Gjatë kësaj periudhe, stafi akademik është trajnuar si brenda institucionit në garantimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Gjithashtu, varësisht fushës së studimit, stafi akademik ka kryer specializime në universitete perëndimore. Gjithashtu janë ndërmarrë hapat konkretë që biblioteka të ketë tituj dhe botime bashkohore gjithashtu këto të aksesueshme edhe në bibliotekën online Ebscohost. Institucioni në lidhje me rekomandimin 3 ka marrë të gjitha masat e nevojshme, duke shfrytëzuar edhe marrëveshjet ndërinstitucionale me British Council për t’u siguruar që studentët e ciklit të dytë të kenë njohuri të kënaqshme të gjuhës angleze si në fazën paraprake të pranueshmërisë në programin e studimit, ashtu edhe në përfundim të studimeve. Mbrojtja e gjuhës angleze është kusht për diplomimin e studentëve të këtij niveli dhe aktualisht me ndryshimet ligjore është kusht për t’u pranuar në këtë cikël studimesh.

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVB SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. **Pranim të studentëve bazuar në kriteret e cilësisë.** Zbatimi në përgjithësi i kriterëve të cilësisë si pesha e mesatares në pranim gjatë përzgjedhjes së studentëve mundëson zhvillimin në nivele optimale të mësimdhënies.


2. **Departamenti i Drejtësisë, pjesë e KUB i cili është institucion arsimor jofitimprurës.** KUB gëzon statusin e një institucioni jofitimprurës, gjë kjo që mundëson ofrimin e një arsimit cilësor me tarifa të ulta.

3. **Zhvillimi i mësimin dhe në gjuhën Angleze për lëndët me karakter ndërkombëtar dhe të Bashkimit Europian.** Zhvillimi i mësimdhënies edhe në gjuhën Angleze u mundëson studentëve shqyrtimin e problematikave të fushës nga këndvështrime të ndryshme dhe bashkëkohore duke ju mundësuar akses në literaturën bashkohore europiane dhe ndërkombëtare.

4. **Staf dinamik akademik dhe me eksperiencë ndërkombëtare.** Moshë e re e stafit dhe eksperiencë e tyre ndërkombëtare mundësojnë sjelljen e dinamizmit dhe risive në Departament.

5. **Koordinim i teorisë me praktikën.** Ndërthurja e teorisë me praktikën profesionale në lëndë të veçante, kjo në saj të angazhimit të stafit me kohë të pjesëshme që vijnë nga profesione të ndryshme.

6. **Kërkime Shkencore.** Inkurajimi dhe mbështetja e stafit akademik për publikime shkencore, pjesëmarrje në konferenca dhe projekte të ndryshme shkencore. Gjithashtu departamenti i Drejtësisë inkurajon dhe mbështet studentët në pjesëmarrjet në konferenca ose projekte të ndryshme akademike ose sociale.



7. Sistemi i automatizimit. Administrimi online i të dhënave nga njësitë kryesore dhe bazë rrit cilësinë e shërbimeve ndaj studentëve, si dhe transparencën ndaj tyre dhe stafit.

8. Bashkëpunimi me institucione arsimore dhe biznes brenda dhe jashtë vendit. Marrëdhëniet midis departamentit dhe tregut të punës (zyra avokatie, gjykata, studio ligjore etj.) Bashkëpunim me studio ligjore brenda dhe jashtë vendit për organizimin e internshipeve.

9. Aplikimi i programeve ekstra-kurrikulare. Stimulimi i studentëve për t'u angazhuar në aktivitete shkencore ekstra-kurrikulare, formimi i klubeve studentore nga studentëve dhe angazhimi i tyre në aktivitete të ndryshme.

10. Praktika profesionale për studentët, e integruar gjatë studimeve në institucione brenda dhe jashtë Shqipërisë.

11. Bibliotekë tradicionale dhe online me literaturë të pasur në gjuhën shqipe dhe të huaj. Biblioteka e KUB rezulton të jetë e pajisur me rreth 36.000 tituj, një burim i rëndësishëm për studimet shkencore të stafit akademik dhe një literaturë e pasur për të gjithë studentët. Gjithashtu biblioteka e KUB mundëson komunikimin dhe në Book Academic Collection. Biblioteka ofron sigurimin e materialeve edhe në rrugë elektronike. Kjo mundësohet nga abonimi që është bërë në bibliotekën online Ebsco Host ku studentët kanë akses në 45 000 libra dhe 5000 revista. Biblioteka online ju shërben studentëve në punën e tyre kërkimore shkencore.

12. Pjesëmarrja e studentëve në garimet kombëtare dhe ndërkombëtare Pjesëmarrja në simulime gjyqesore në rang kombëtar dhe ndërkombëtar. I vetmi institucion i arsimit të lartë në Shqipëri pjesëmarrës në Jessup (Washington DC) dhe Hagë.

13. Niveli i lartë i punësimit. Punësimi i të diplomuarve në programin "Master i Shkencave" në "Drejtësi" është në nivel të lartë.

b. Pika të dobëta:

1. Ndryshimi i shpeshtë i rregulloreve si pasojë e ndryshimeve të akteve ligjore dhe nënligjore nga ana e MASR.

2. Duhet rritur bashkëpunimi ndërmjet personelit efektiv (full-time) dhe atij me kontratë (part-time) nëpërmjet takimeve periodike për të shkëmbyer informacione me qëllim përditësimin në fushat respektive të tyre.

3. Mungesa e ambienteve të gjelbërta për studentët. Pavarësisht kushteve të kënaqshme që ofron godina institucionale, bie në sy mungesa e ambienteve gjelbërta dhe sportive për studentët kjo për shkak dhe të vonësave në ndërtimin e kampusit të KUB.

4. Mospërfshirja sa duhet e deritanishme e institucionit në nismat e BE-së dhe donatorë të tjerë. Pavarësisht se Institucioni ka qenë pjesëmarrës në disa projekte dhe nisma ndërkombëtare, momentalisht nuk është pjesë e nismave të BE-së për dhënie e fondeve në projekte të ndryshme shkencore edhe pse ka aplikuar.

c. Mundësitë:

1. Tërheqja e studentëve të huaj nëpërmjet kurrikulave të përshtatshme për ta.

2. Mësimdhënia në gjuhën angleze i krijon mundësi studentëve të vazhdojnë studimet e mëtejshme në vende të tjera perëndimore.

3. Mundësia e tërheqjes së stafit akademik të huaj si shkak i zhvillimit të lëndëve në gjuhën angleze.

4. Nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe midis KUB me universitete të tjera perëndimore dhe rajonale.



5. Implementimi i lëvizjes së lirë të stafit dhe të studentëve përmes marrëveshjeve të arritura me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë Shqipërisë.

6. Angazhimi në kompeticionet ndërkombëtare.






d. Pengesat:

1. Mangësia e hapësirës shqiptare të fushës për tekste cilësore dhe bashkëkohore akademike në gjuhën shqip
2. Numri i madh i universiteteve publike dhe private që kanë departamente të drejtësisë, kufizon mundësinë e përzgjedhjes së studentëve.
3. Papunësia e lartë mes të diplomuarëve në fushën e drejtësisë ul interesin e studentëve për të zgjedhur degën e drejtësisë.
4. Paqartësia e kuadrit ligjor lidhur me programin e drejtësisë.



LISTA E EVIDENCAVE MBËSHTETËSE PËR PROGRAMIN E STUDIMIT “MASTER I SHKENCAVE” NË DREJTËSI NË PROFILET: E DREJTË PENALE dhe E DREJTË NDËRKOMBËTARE

- Evidenca nr. 1:** Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për licencimin e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër)
- Evidenca nr. 2:** Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”
- Evidenca nr. 3:** Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”
- Evidenca nr. 4:** Rregullorja mbi Organizimin Akademik
- Evidenca nr. 5:** Rregullorja mbi Organizimin Administrativ
- Evidenca nr. 6:** Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë
- Evidenca nr. 7:** Rregullore e Zyrës së Sekretarisë Mësimore
- Evidenca nr. 8:** Rregullorja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- Evidenca nr. 9:** Rregullorja e Anketave dhe Vlerësimeve
- Evidenca nr. 10:** Rregullorja mbi Projektet Kërkimore-Shkencore
- Evidenca nr. 11:** Udhëzimi mbi Procesin e Zhvillimit të Kurrikulës
- Evidenca nr. 12:** Udhëzimi mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor
- Evidenca nr. 13:** Udhëzimi mbi Funksonimin e Bibliotekës
- Evidenca nr. 14:** Udhëzuesi i Sistemit Informativ Bedër (BIS)
- Evidenca nr. 15:** Urdhër nr. 223, datë 4.06.2013 “Për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit”
- Evidenca nr. 16:** Vendimi nr. 101, datë 10/11/2017 “Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë Kolegji Universitar “Bedër”
- Evidenca nr. 17:** Procedura e punësimit të stafit
- Evidenca nr. 18:** Vendimi i Këshillit të Departamentit mbi Caktimin e Këshilltarëve Akademikë
- Evidenca nr. 19:** Organigrama e Institucionit
- Evidenca nr. 20:** Rregullorja e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit (KPGSCIPS)
- Evidenca nr. 21:** Plani i Trajnimeve 2018-2019
- Evidenca nr. 22:** Plani Strategjik 2018-2023 i Kolegjit Universitar “Bedër”
- Evidenca nr. 23:** Rregullorja për Punësimin, Promovimin dhe Vlerësimin e Performancës së Stafit
- Evidenca nr. 24:** Vendimi i Senatit Akademik mbi Ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm
- Evidenca nr. 25:** Modeli i Kontratës së Punës për Stafin Akademik
- Evidenca nr. 26:** Anketa Vlerësuese e studentit për lëndën dhe pedagogun
- Evidenca nr. 27:** Formulari i Vlerësimit për Stafin Akademik
- Evidenca nr. 28:** Përshkrimi i punës (Shembull)
- Evidenca nr. 29:** Rregullorja e programit të studimit “Master i shkencave” në Drejtësi me profile: E drejtë penale dhe E drejtë ndërkombëtare
- Evidenca nr. 30:** Projekti aktual i kampusit
- Evidenca nr. 31:** Listë e praktikave profesionale
- Evidenca nr. 32:** Lista e trajnimeve të stafit akademik dhe administrativ
- Evidenca nr. 33:** Kontrata e qirasë së godinës
- Evidenca nr. 34:** Modeli i Raportit Vjetor dorëzuar në Rektorat nga Departamenti

Evidenca nr. 35: Vendimi i Senatit për përfshirjen e studentëve në mbledhjet e njësive bazë dhe kryesore

Evidenca nr. 36: Praktikë e Auditimit të Brendshëm

Evidenca nr. 37: Raporti i Vlerësimit të Jashtëm kërkuar nga IAL

Evidenca nr. 38: Model diplome dhe suplementi

Evidenca nr. 39: Lista e plotë e syllabuseve të programit “Master i shkencave” në Drejtësi me profil: *E Drejtë Penale* dhe *E Drejtë Ndërkombëtare*

Evidenca nr. 40: CV- e personelit akademik

Evidenca nr. 41: Programi i ditëve të orientimit

Evidenca nr. 42: Guida e studentit

Evidenca nr. 43: Guida e stafit

Evidenca nr. 44: ISO Certifikatë 9001:2008

Evidenca nr. 45: Format provimi


Evidenca nr. 46: Planimetria e godinës aktuale

Evidenca nr. 47: Ambientet e KUB

Evidenca nr. 48: Rregulla mbi Organizimin e Provimeve

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm

- 1 .Dr. Nertil Bërdufi - Kryetar
2. Dr. Ferdinand Xhaferaj – Anëtar
3. Dr. Bojana Hajdini - Anëtare
4. Msc. Ermira Shkreta - Sekretare
5. Ermelinda Gjeci – Përfaqësuese e studentëve





admissions@beder.edu.al